

ZEJD IBN HADI EL-MEDKHALI

SHPJEGIM I LIBRIT

*”Tri parimet
fundamentale”*



Tre parimet fundamentale

nga shejhu bujar, Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali
troid.org

Hyrje

Ky libër, i quajtur el-Usuluth-Thelathe është nga librat më të mirë në lëmin e akides [kredos] për kërkuesin e diturisë që është në shkallë fillestari apo në shkallë të ndërmjetme. Kjo do të thotë se çdonjëri nga mesi i nxënësve të diturisë ka nevojë për të kur kemi të bëjmë me shpjegimin e akides korrekte dhe çfarëdo qoftë që e kundërshton atë. Më saktë, secili nga muslimanët që bie në kategorinë e të obliguarve ka nevojë për të. Pra, kjo është ndërtuar ashtu që të mësohet përmendsh dhe të kuptohet domethënia e saj, dhe po ashtu është e përshtatshme që kjo të mësohet nga profesorët dhe dijetarët, e të mos e përmendim se çështja e akides që shtjellohet këtu është e natyrës prezantuese, përse i përket njohurisë mbi akiden Islame, e cila duhet të studiohet para çdo libri tjetër.

Biografi e shkurtë e shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H]

Ai është el-Allame, el-Muxhedid, Muhamed Ibn Abdul-Uehab Ibn Sulejman el-Wuhejbi et-Temimi. Ky dijetar është lindur në qytetin el-Ujejne në vitin 1115H.

Ai u edukua nën kujdesin e një familjeje bujare. I ati i tij ishte dijetar i madh nga mesi i dijetarëve të mirënjohur të Nexhdit dhe gjykatësve të el-Ujejnes. Ndërsa gjyshi i tij, Sulejmani, ishte dijetar i Nexhdit në kohën e tij, dhe ishte nga mesi i atyre që njiheshin shumë mirë për njohuri të fikhut [jurisprudencës] dhe fetva.

Ai e mësoi përmendsh Kur'anin Fisnik para se të mbërrinte moshën dhjetë vjeçare dhe mori pjesë në shumë shkenca, përfshirë këtu tefsir, hadith, akide, fikh dhe këshillim [ue'dh]. Ai udhëtoi për kërkimin e diturisë në pjesët më të largëta të Nexhdit dhe në Meke. Ai mësoi me dijetarët e atyshëm, e më pas udhëtoi për në Medine ku po ashtu mësoi me dijetarë.

Kështu që shejhu – rahimehullah – u pajis me një të kuptuar të mprehtë nga Allahu, dhe atij i ishte dhënë aftësia e mbamendjes dhe e të qenit i durueshëm gjatë leximit dhe realizimit. Kur i ati i tij vdiq, ai haptazi bëri të ditur da'uen selefije, urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja, dhe sulmimin e bidatçinjëve nga adhuruesit e varreve. Vërtet, sunduesit nga Aali-Saud [rahimehumullah] i ofruan atij përkrahje të pa rezervë, e forcuan trimërinë e tij dhe përhapën lajmin e tij. Ai ka shumë punime të dobishme, prej

tyre: Kitabut-Teuhid, Usulul-Iman, Usuluth-Thelathe, Muhteser Zadul-Me'ad, Muhteserul-Insaf, Keshfush-Shubuhah dhe shumë të tjera.

Ai vdiq kah fundi i vitit 1206H – rahimehullahu te'ala – në moshën nëntëdhjetë e një vjeçare. Këto vite ai i shpenzoi në lëmit e diturisë, xhihad dhe da'ue [thirrje për tek Allahu], kështu që Allahu e kaploftë me mëshirën e tij të bollshme, dhe e shpërbleftë fisnikërisht; meqë Ai është që dëgjon çdo gjë, Ai përgjigjet [lutjeve]. Lavdi i takon Allahut, Zotit të botrave. Paqja dhe përshëndetjet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, dhe mbi familjen dhe të gjithë Shoqëruesit e tij.

Biografi e shkurtë e shejh Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali

Ai është dijetari bujar, Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali. Ai është lindur në qytetin er-Rukubeh në vitin 1357H. Ai u edukua aty dhe po ashtu filloi studimet në këtë qytet. Më pas, ai vijoi mësimin në shkollën es-Samiteh es-Selefije. Në vitin 1368H, ai kontaktoi me shejh Hafidh në Bejsh dhe mësoi me të së bashku me nxënësit emigrantë. Kur instituti i diturisë u hap në Samiteh, ai vazhdoi shkollimin dhe u diplomua aty në vitin 1379-1380H. Gjithashtu ai u rexhistrua në fakultetin e Sheriatit dhe u diplomua më 1383-1384H.

Ai filloi të japë mësim në institutin e diturisë në Samiteh, derisa doli në pension më 01.07.1417H. Ai themeloi Mektebu-Selefijen bamirëse të parë në qytetin Samiteh 1416H, e cila shpërndau mbi katër mijë libra, duke i lënë nën kujdesin e nxënësve të diturisë, të cilët i morën ato në çdo vend. Ndejat e tija nuk janë të lira nga nxënësit e diturisë që kërkojnë dituri prej tij apo njerëz që vijnë për të marrë fetva. Ai ka qenë majft aktiv në thirrjen për tek Allahu në qytetin Xhazan. Dhe, gjatë ditëve të Haxhit, ai vazhdimisht jep mësim dhe falënderimi i takon Allahut që librat e shkurtëra dhe voluminoze ende studiohen me të.

Është edhe një njeri tjetër nga qyteti Xhazan, i cili posedon dituri, fetua dhe merr pjesë në thirrje për tek Allahu, ky është shejh Ahmed Ibn Jahja en-Nexhmi, Allahu ia shtoftë jetëgjatësinë. Ai ka shumë punime dhe nga ato që i janë botuar janë:

1. el-Hejat fi Dhillil-Akidetir-Reslamijeh
2. el-Exhuibetus-Sedideh el-El-Es'iletir-Rashideh [1-8 vëllime]
3. Sherhul-Kasidetil-Ha'ijeh, nga shejhu i tij, el-Hafidh Ibn Ahmed el-Hekemi [rahimehullahu]
4. el-Efnanun-Nedijeh Sherhus-Subulis li Fikhis-Sunenil-Meruijeh
5. el-Menhexhul-Kauim fit-Te'sij bir-Resulil-Kerim
6. Mexhmu'etur-Resail
7. Kuruf fi Nu'utis-Selef
8. el-Irhab ue Atharihi el-El-Efrad uel-Umem

9. el-Medhumatul-Hisan ued-Diuenil-Melih [1-2 vëllime]
10. el-Xhuhdul-Mebdhul fi Tenueril-Akl bi Sherh Mendhumeh Uesiletil-Husul ila Muhimmatil-Usul [1-3 vëllime]
11. Wuxhub Seteril-Uexhh uel-Kefej

Ai ka edhe shumë punime të tjera dhe asnjëherë nuk e ka ndërprerë kontributin dhe thirrjen në Menhexhin Selefije. Allahu e bekoftë atë për përpjekjen e tij dhe ia shtoftë jetëgjatësinë.¹

1. Referoju librit, 'esh-Shejh Hafidh el-Hekemi' të Ahmed Ibn Ali Alush el-Madkhali.

Mësimi i parë

Lavdi i takon Allahut, dhe paqja e përshëndetjet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. Më tej: Ky libër, i quajtur el-Usuluth-Thelathe është nga librat më të mirë në lëmin e akides [kredos] për kërkuesin e diturisë që është në shkallë fillestari apo në shkallë të ndërmjetme. Kjo do të thotë se çdonjëri nga mesi i nxënësve të diturisë ka nevojë për të kur kemi të bëjmë me shpjegimin e akides korrekte dhe çfarëdo qoftë që e kundërshton atë. Më saktë, secili nga muslimanët që bie në kategorinë e të obliguarve ka nevojë për të. Pra, kjo është ndërtuar ashtu që të mësohet përmendsh dhe të kuptohet domethënia e saj, dhe po ashtu është e përshtatshme që kjo të mësohet nga profesorët dhe dijetarët, e të mos e përmendim se çështja e akides që shtjellohet këtu është e natyrës prezantuese, përse i përket diturisë mbi akiden Islame, e cila duhet të studiohet para çdo libri tjetër. Më pas, duhet të vazhdohet me Kauaidul-Erbe'e, Keshfush-Shubuhut dhe Kitabut-Teuhid². Dhe pas këtyre, duhet përvetësohen el-Akidetul-Uesitije, pastaj el-Hemeuijeh, pastaj et-Tedmurije³, pastaj et-Tehauije⁴. Gjithashtu, pas kësaj vijnë librat e Sunetit të cilat përmbajnë sunen [tradita peygamberike] e që janë shkruar posaçërisht për këtë çështje. Kështu që ai i cili jeton gjatë dhe është në kërkim të diturisë, do t'i gjejë këto libra përpara vetes në të ardhmen me fuqinë dhe mundësinë e Allahut, nëse kështu do Allahu.

Teksti dhe sqarimi

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit."

Domethënia e Besmeles

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Pra, deklarata e autorit 'Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.' Ai filloi me bismelen [të thënit bismilah] dhe hamdelen [falënderimin e Allahut]. Kjo është nga mirësjellja dhe nga të kuptuarit e shkrimtarëve të shkaqeve për përmbushjen e nevojave. Në hadithin e konfirmuar nga Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndron, "Çdo çështje e rëndësishme që nuk nisët me 'bismilah,' është e privuar nga e mira."⁵ Kjo do të thotë se ajo ka bekime të pakta.

2. Të tre këto libra janë shkruar nga shejhul-Islam, el-Muxhedid, Muhamed Ibn Abdul-Uehab.

3. Të tre këto libra janë shkruar nga shejhul-Islam Ibn Tejmije.

4. Ky libër është shkruar nga Imam Ebu Xhafer et-Tehaui.

5. Transmetuar nga el-Hafidh Ibn Haxher në el-Fet'h [1/13] dhe nga es-Sujuti në ed-Durrul-Menthur [1/31-35] dhe ai tha lidhur me të, 'Hasen.' Ndërsa Neueui tha, 'Shokët tanë kanë thënë se, sipas kësaj, çdo çështje duhet të nisët me Emrin e Allahut të Lartësuar, dhe gjithashtu, Allahu duhet të falënderohet për çdo çështje të rëndësishme. Kjo është ajo që e thekson hadithi i mirënjohur.' Referoju Sherh Sahih Muslim [13/186]

Kështu që nëse thoni 'bismilah' apo nëse thoni 'el-hamdulillah,' dhe e nisni çdo çështje me këtë, atëherë ju do ta përshkoni rrugën e dijetarëve në karakteristikë pune, e cila zbatohet kurdo qoftë që ndonjëri prej tyre donte të shkruante ndonjë libër, letër apo ligjëratë dhe të ngjashme më këto. Personi duhet të fillojë me përmendjen e Allahut dhe duhet të dërgojë paqe dhe përshëndetje mbi të Dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ue selam], dhe pas kësaj, ai duhet ta nisë punën e menduar. Dhe pikërisht këtë kurs e ndoqi shejh Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah – kur ai shkroi këtë libër. Kjo ngase kur ju thoni 'bismilahir-rahmani-rahim,' kjo do të thotë se, 'Unë e nisi këtë punë timen apo këtë shkrim timin duke kërkuar bekime me Emrin e perëndisë [el-Ilah] i cili është i denjë për adhurim. Ai është i vetëm pa ndonjë ortak, dhe askush krahas tij s'mund të përshkruhet me cilësi të larta e të përsosura. Dhe nga mesi i tyre është Cilësia e mëshirës së përgjithshme [rahmeh-ammeh] dhe mëshira e veçantë [rahmeh-khaseh]. Cilësia e përgjithshme e mëshirës është ajo e cila tregohet nga thënia e Allahut të Lartësuar, 'er-Rahim.' Më pas autori nisi qëllimin e menduar dhe filloi më urdhër."

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Dije [se]..."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Urdhëri 'Dije [se]...' do të thotë thirrje për vëmendje dhe e bën dëgjuesin dhe lexuesin të vëmendshëm ndaj asaj me të cilën do të ndeshet pas fjalës 'Dije [se].' Kjo ngase kjo do ta bëjë atë që ta mbajë në mend fjalimin dhe atë që do të ndeshet me të apo atë që do të thuhet. Vërtet, ai që përqendrohet dhe rri i zgjuar dhe ndërthur urdhrin e tij dhe dëgjon me vëmendje, ai do të mbajë në mend çfarëdo qoftë që thuhet nga udhëzimi, rregullat e detajuara, sqarimi i hallallit [të lejuarës] dhe haramit [të ndaluarës], dëgjimi i këshillës

dhe orës mësimore. Më pas ai e çon deri në fund thirrjen për vëmendje duke u lutur për çdo lexues dhe çdo dëgjues. Dhe kjo është nga mënyrat e dijetarëve, të cilët i japin rëndësi çështjes Islame dhe muslimanëve, dhe e dëshirojnë mirësinë për atë që e kërkon mirësinë."

Kupto se lutja është prej adeteve të dijetarëve

Vazhdoi shejhu-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Allahu ju mëshiroftë."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "O lexues, O dëgjues që përfiton," pastaj e nisi punën e menduar. Ai nisi të sqarojë se prej detyrimeve të çdo muslimani, qoftë femër apo mashkull, është se ata duhet t'i dinë katër çështjet në vijim.

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Është e detyrueshme për ne që t'i dimë katër çështje."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Së pari, ai i qaset kësaj në mënyrë të përgjithshme me qëllim që ta përgatisë lexuesin dhe dëgjuesin për detajet e këtyre katër çështjeve dhe për çfarëdoqoftë që njerëzit kanë nevojë për t'i kuptuar ato. Më pas, ai i qaset kësaj në mënyrë të veçantë, që kërkuesit e diturisë dhe të tjerët pos tyre t'i njohin ato.

Çështja e parë – Dituria

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Së pari: dituria."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn el-Madkhali – hafidhahullah, "Dituria e menduar këtu është dituria Sheriatike. Është ajo që ka ardhur në Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam] dhe që dijetarët, nga mesi i njerëzve të akides Selefite⁶ dhe metodologjisë [menhexhit] të shëndoshë, e kanë shpjeguar atë në çdo çështje nga çështjet e diturisë. Kjo është një deklaratë e përgjithshme, ndërsa shpjegimi i detajuar do të vijë më vonë. Kjo është sikur të kishte pyetur pyetësi, 'Çfarë është domethënia e menduar e diturisë së detyrueshme?' Kjo ngase ka dituri që është e detyrueshme, që askush s'mund të arsyetohet nëse nuk e di atë. Dhe prej saj është dituria që është fard kifaje [detyrim kolektiv], dhe ajo që është fard 'ajn [detyrim individual]. Pra, e para nga këto katër çështje është dituria e cila është e detyrueshme për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër."

Dituria mbi Allahun

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Dhe kjo është dituria mbi Allahun."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Dijetarët e kanë shpjeguar këtë të jetë dituria mbi Allahun. Kjo do të thotë se është e detyrueshme për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, që ta njohin Zotin e tyre me anë të qenësisë së Tij, Emrave të Tij, Veprave të Tij dhe që

"Asgjë s'është sikur Ai. Ai është që dëgjon çdo gjë, sheh çdo gjë." [Shura: 11]

Pra, robi duhet ta di se Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar është Krijuesi i tij [khalik], Furnizuesi [razik] dhe kontrolluesi i çështjeve të tij. Më saktë, Ai kontrollon tërë universin. Ai është i denjë për këtë, sepse Ai adhurohet i vetëm pa ndonjë ortak. Dhe çdo akt adhurimi që i drejtohet tjetërkujt pos Tij, është akt adhurimi i anuluar.

6. Selefije është atribuim ndaj Selefus-Salih, dhe ata janë Shoqëruesit e të Dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam] dhe ata që i ndoqën ata dhe të gjithë ata që përshkojnë metodologjinë e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Dhe robi duhet të besojë se Ai ka Emra të Bukur dhe Cilësi Fisnike, të cilat kanë ardhur në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam]. Vërtet, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm na ka urdhëruar që të përdorim mënyrë afrimi [uesileh] në lutjet tona dhe nënshtrim ndaj Tij, kështu që Ai tha,

"Allahu ka Emrat më të Bukur, andaj luteni Atë me këta Emra dhe lini ata që devijojnë në lidhje me Emrat e Tij. Ata kanë për t'u shpërblyer për atë që bëjnë."
[A'raf: 180]

Pra, kushdo që njëmend e njeh Allahun e Fuqishëm dhe të Madhërisëm dhe e vlerëson atë si duhet, pastaj i kryen detyrat e tij dhe e zbaton detyrimin e tij, qëndron larg prej ndalimeve dhe e beson të lejuarën të jetë e lejuar dhe të ndaluarën të jetë e ndaluar, dhe me tërë këtë ai shpreson në mëshirën e Allahut dhe ka frikë nga dënimi i Tij për gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij, atëherë, ai është besimtar i vërtetë. Ai do të falet dhe do të pranojë shpërblim të madh nga Zoti i tij."

Dituria mbi peygamberin

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Dhe dituria mbi peygamberin e Tij."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Nga detyrimet për të cilat askush s'mund të arsyetohet nëse nuk i di, është dituria mbi peygamberin [salallahu alejhi ue selam] dhe dituria mbi atë me çka erdhi peygamberi [salallahu alejhi ue selam]. S'është e mjaftueshme për muslimanin, qoftë mashkull apo femër, që secili prej tyre të thotë, 'Unë e njoh të dërguarin e Allahut, dhe ai është Muhamed Ibn Abdullah.' Kjo s'mjafton. Personi duhet ta di se ai është dërguar prej Allahut. Allahu i ka shpallur Libër atij dhe e urdhëroi që ta shpjegojë atë dhe e urdhëroi që ta thërrasë Umetin për t'u mbajtur fort në këtë Libër dhe në atë me çka erdhi ai [salallahu alejhi ue selam] nga Suneti i tij fisnik. Për këtë shkak, dituria mbi peygamberin [salallahu alejhi ue selam] mund të numërohet përbrenda çështjeve në vijim:

Dituria mbi peygamberin kufizohet në katër çështje:

1. Ta njohim atë si person. Pra, ai është Muhamed Ibn Abdullah Ibn Abdul-Mutalib Ibn Hashim.
2. Ta duam atë më shumë sesa që e duam vetveten, pasurinë tonë, babanë tonë dhe fëmiun tonë.
3. Ta duam atë me çka erdhi peygamberi [salallahu alejhi ue selam], përgjithësisht dhe specifikisht.
4. Të veprojmë sipas kësaj duke shpresuar mëshirën e Allahut dhe duke pasur frikë nga denimi i Tij.

Kushtet për dëshminë se Muhamedi është i dërguar i Allahut

Vërtet, dijetarët kanë përmendur se vërtetimi dhe bindja ndaj dëshmisë se Muhamedi është i dërguar i Allahut përfshin katër kushte: [i] Të bindurit ndaj tij në çdo gjë që ai urdhëron; [ii] Të besuarit në çdo gjë për çka na ka informuar ai. Meqë ai nuk flet nga dëshirat e tija dhe s'thotë asgjë veçse ajo të jetë shpallje; [iii] Të qëndruarit larg nga çdo gjë që peygamberi [salallahu alejhi ue selam] ka ndaluar nga thëniet e pavërteta, veprat dhe besimet; [iv] Allahu s'bën të adhurohet, përveç se me atë që gjindet në Sheriatin e të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam]. Kështu që dyert janë mbyllur, përveç derës së të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam]. Ai është të cilin Allahu e ka bërë të dërguarin e Fundit dhe Ai i obligoi të dy botrat që t'i binden atij përkundër llojit të ndryshëm të tyre, Arabë apo jo-Arabë. Më saktë, ky urdhër vlen për Xhinët dhe njerëzimin, për shkak të thënies së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë." [Dharijat: 56]

Porosia universale e Muhamedit

Vërtet, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i ka shpallur peygamberit të Tij [salallahu alejhi ue selam], dhe Ai e urdhëroi që t'ia përcjell atë Umetit. Porosia e tij ishte e përgjithshme, ajo s'ishte e veçantë për Arabët, dhe ishte porosi e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse. Në fakt, ata mbi sipërfaqen e planetit, të cilëve u është dërguar i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] ishin Arabët dhe jo-Arabët, meshkujt dhe femrat, i liri dhe robi, i largëti dhe i afërta. Më saktë, ai u qe dërguar Xhinëve dhe njerëzimit, siç ka thënë Allahu i lartësuar,

"Thuaj, 'O njerëz, unë jam i dërguar i Allahut te të gjithë ju.'" [A'raf: 158]

Fjala 'njerëz' [nas] përfshin të gjithë njerëzimin. Dhe, Allahu e konfirmon këtë domethënie në thënien e tij,

"Ne s'të kemi dërguar ty veçse si mjaftueshmëri për njerëzimin, si bartës të përgëzimeve dhe si paralajmërues." [Sebe: 28]

Fjala "mjaftueshmëri" [kaffeh] ka domethënie të përgjithshme. Kështu që askush nga mesi Umetit nuk përjashtohet nga porosia e peygamberit [salallahu alejhi ue selam].

Pra, peygamberi [salallahu alejhi ue selam] konfirmoi këtë përgjithësi dhe këtë gjithëpërfshirje me thënien, "Pasha Allahun! Nuk ka asnjë nga mesi i Çifutëve dhe i të Krishterëve që vdesë pa besuar në atë me çka kam ardhur unë, vetëm se do të jetë nga banorët e Zjarrit."7 Thirrja e Çifutëve dhe e të Krishterëve nga ata që pohojnë se Allahu mund të adhurohet me Librin paraprak si një kriter pas shpalljes së Kur'anit dhe pas atij të cilit Allahu ia shpalli Kur'anin, është pohim i rrejshëm dhe ai që e thotë këtë gënjen. Kjo ngase Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e ka bërë këtë Kur'an që të konfirmojë të gjitha librat tjera dhe e bëri peygamberin [salallahu alejhi ue selam] të dërguarin dhe peygamberin e fundit. Dhe s'është e lejueshme për askë që ta adhurojë Allahun, përveç se me atë që është përfshirë në Sheriatin e peygamberit [salallahu alejhi ue selam] i cili nuk flet nga dëshira e tij."

7. Transmetuar nga Muslim [nr.240], Ibn Mendeh në Kitabul-Iman [nr.401]. Kjo është vërtetuar nga Imam el-Albani në Silsiletul Ahadith Sahiheh [nr. 157]

Njohja e fesë Islame me dëshmitë e saja

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Dhe njohja e fesë Islame me dëshmitë e saja."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Kjo është një temë e gjerë, sepse feja Islame përfshin përbrenda vetes të gjitha detyrimet, qofshin ato të lidhura me thënie, vepra, të jashtme apo të brendshme. Pra, feja Islame është gjithëpërfshirëse, ajo përfshin çdo gjë që Allahu ka urdhëruar për botën e Xhinëve nga detyrat dhe ndalimet dhe tjera pos këtyre nga detyrimet Sheriatike për të cilat Allahu krijoi botën e njerëzimit dhe të Xhinëve. Për këtë shkak, Allahu ka thënë në lidhje me të Drejtën e Tij,

"Vërtet, Feja e pranueshme te Allahu është Islami." [Aali-Imran: 19]

Krijuesi e kufizoi në Islam atë çka bota mund të merr si fe të veten, e që kjo do të thotë: të gjitha mësimet e Islamit me të cilat ka ardhur i dërguari i Allahut. Dhe Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm na ka bërë me dije se kushdo që dëshiron të adhurojë Allahun me fe tjetër përveç fesë Islame, adhurimi i tij është i pasaktë ndërsa thënia e tij refuzohet. Allahu ka thënë,

"Kushdo që kërkon fe tjetër përveç Islamit, ajo kursesi s'do t'i pranohet atij dhe në jetën e përtejme, ai do të jetë në mesin e dështakëve." [Aali-Imran: 85]

Përgënjeshttrim i pohimeve se Kur'ani është shpallur vetëm për Arabët

Humbësit nga Çifutët dhe të Krishterët dhe të tjerë përveç tyre janë të pasaktë në pohimin e tyre se ata janë urdhëruar në Teurat dhe Bibël, dhe pohojnë se ky Kur'an u është shpallur vetëm Arabëve. Kështu ata pohojnë se Islami është i veçantë vetëm për ta [Arabët] dhe ai nuk përfshin tjerët pos tyre, dhe kjo s'është e vërtetë. Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e ka treguar pavërtetësinë e kësaj në disa ajete duke përmendur përgjithësinë dhe karakterin gjithëpërfshirës të porosisë me të cilën erdhi peygamberi [salallahu alejhi ue selam]. Edhe vetë peygamberi [salallahu alejhi ue selam] e ka hedhur poshtë si të rrejshëm këtë pohim në thënien e tij, "Edhe sikur të ishte këtu vëllai im, Musai, ai s'do të kishte zgjidhje veçse të më pasonte mua."⁸

Çështja e dytë: Veprimi sipas diturisë personale

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Së dyti, që të veprohet sipas saj."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Pra, çështja e dytë është që të veprohet sipas saj. Kjo do të thotë të veprohet bazuar në dituri. Dhe kjo është prej çështjeve të rëndësishme, sepse vepra është fryt i diturisë. Kushdo që nuk vepron sipas diturisë së tij, ai është mëkatar që i nënshtrohet rrezikut më të madh dhe me veprimin e tij tërheq një kërcënim të ashpër. Për këtë shkak, dijetarët tanë –

rahimehullah – kanë thënë, "Kushdo që priset nëpërmjet dijetarëve tanë, tek ai gjendet një prej cilësive të Çifutëve. Dhe kushdo që priset nëpërmjet adhuruesve tanë, tek ai gjendet një prej cilësive të të Krishterëve."⁹

Rreziku nga të qenit në ngjasim me Çifutët dhe të Krishterët

Kjo e sqaron atë se Allahu u ka shpallur dituri të dobishme Çifutëve. Ishte Teurati i cili përmbante udhëzime dhe dritë. Kështu që ata devijuan dhe ndryshuan derisa më nuk deshën që të veprojnë sipas tekstit të Teuratit, ashtu siç Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ia kishte shpallur atë Musait [alejhisselam]. Pra, ata devijuan dhe me këtë e merituan hidhërimin e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Allahu u hidhërua prej tyre ngase ata e dinin, dhe megjithatë nuk vepruan. Kushdo nga Umeti i Muhamedit [salallahu alejhi ue selam] që di diçka nga Libri dhe Suneti, mirëpo nuk vepron në përputhje me të, atëherë ai iu ka gjasuar atyre mbi të cilët është hidhërimi i Allahut. Në hadith qëndron, "Kushdo që është në ngjasim me një popull, ai është nga mesi i tyre."¹⁰ Kjo do të thotë se ai e meriton përfundimin e njëjtë sikur ata. Dhe çdo denim shpaguhet sipas krimit dhe sipas shkeljes ndaj vetvetes.

8. Hasen: Kjo është pjesë e një hadithi që transmetohet nga Imam Ahmed në Musnedin e tij [3/387] dhe ed-Darimi [nr.50, 435]. Imam el-Albani ka thënë, "Ky është hadith hasen. Isnadi i tij përmban transmetues të besueshëm, përveç Muxhelidit, e ky është Ibn Se'id. Pra, është i dobët. Mirëpo, hadithi është hasen ngase ka rrugë alternative siç e kam treguar në el-Mishkat [nr. 177]. Më pas kontrollova disa prej tyre në el-Irua [nr.1589]." Po ashtu transmetohet nga Ibn Abdul-Berr në Xhami Bejanul-Ilm [nr. 1495, 1497] referoju el-Irua [nr. 1598] ku Imam el-Albani thotë në lidhje me të: Hasen. Dhe referoju el-Mishkat [nr. 177].

9. Është përmendur nga Ibn Tejmije nga Sufjan Ibn Unejne dhe të tjerë pos tij në Iktida'us-Siratul-Mustekim [1/67].

10. Sahi: Transmetuar nga Ebu Daud [nr. 4031] dhe et-Temhid [6/80] të Ibn Abdul-Berr. Është vërtetuar nga Imam el-Albani në el-Mishkatul-Mesabih [nr. 4347] dhe në el-Iruaul-Ghalil [nr. 1269], dhe ka thënë se është Sahi.

Prandaj, detyrimi i vetëm për muslimanin është që të çojë në vend diturinë me vepra. Pra, kurdo që ai ta kuptojë ndonjë çështje prej çështjeve të Fesë Islame, ai vepron sipas saj për të përfituar një shpërblim të bollshëm. Kështu që ai i zbaton detyrat dhe përmbush detyrimet dhe qëndron larg prej ndalimeve, dhe e tërë kjo është vepër e shkaktuar nga dituria që ai ka. Dituria është çelësi dhe dera për tek çdo e mirë, dhe kushdo që ndalon dituri, ka ndaluar tërë të mirën ngase Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm dërgoi të dërguarit me dituri dhe i zbriti Librat me dituri. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë, "Vërtet, dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Ata nuk lënë pas vetes as dinarë, e as dirhem; ata lënë në trashëgim vetëm dituri. Kështu që kushdo që e merr atë, ai ka marrë një hise me tepri."¹¹

Vlera e diturisë dhe e dijetarëve

Dituria që sjell vepra të mira si fryt, s'mund të arrihet nga njeriu, qoftë mashkull apo femër, përveç duke u përpjekur fort për ta arritur atë. Kështu që dituria fitohet në përputhje me mundin e dhënë. Për sa i përket neglizhencës dhe bindjes ndaj shpirtit në dëshirat e tij, argëtim dhe shkujdesje, atëherë kjo është shkak nga mesi i shkaqeve të rënies në atë që është e ndaluar. Pra, shpirti urdhëron në të keqen dhe Allahu e ka përshkruar atë si të tillë. Ata që përshkojnë shtegun për tek dituria fisnike janë ata që kanë zgjedhur rrugën më fisnike dhe veprën më të mirë dhe me të delirë për shkak të shkëlqesisë dhe mbështetjes së Allahut. Meqenëse s'është e mundur për ndokënd që të bëjë vepër më të mirë, përveç kur ajo është e paraprirë me dituri, ndërsa qëllimi prapa saj është përfitimi i diturisë së trashëguar Sheriatike nga Libri dhe Suneti. Prej fatit të mirë të këtij Umeti është se i kanë gjetur ata që ua tërheqin vërejtjen në këtë, i preokupojnë me të dhe e bashkojnë mundin e tyre me të Umetit, ose duke mësuar, ose duke udhëzuar në të mirën dhe duke i nxitur ata në këtë epërsi. Pra, ekziston një fisnikëri e madhe e ndërlydhur me këtë që parapriu, dhe mjafton në lidhje me këtë që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar e ka favorizuar diturinë dhe dijetarët.

11. Kjo është pjesë e hadithit të Kethir Ibn Kajs. Ai tha, 'Unë isha me Ebud-Derdan në xhaminë e Damaskut ndërsa një njeri erdhi dhe tha, 'O Ebud-Derda! Unë kam ardhur tek ti nga Medineja, qyteti i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], për një hadith. Më ka mbërritur [lajmi] se ti e ke transmetuar atë nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam].' Ai tha, 'Pra ti nuk paske ardhur që të bësh tregti?' Ai tha, 'Jo.' Ai tha, 'Dhe s'ke ardhur për tjetër pos kësaj?' Ai tha, 'Jo.' Ai tha, 'Atëherë, e kam dëgjuar të dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ue selam] duke thënë, 'Kushdo që ndjek rrugë për të kërkuar dituri, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhennet. Engjëjt do t'i ulin krahët me kënaqësi për kërkuesin e diturisë. Dhe gjithçka që është në qiej dhe tokë kërkon falje për kërkuesin e diturisë, madje edhe peshku në det. Epërsia e dijetarit ndaj adhuruesit është sikur epërsia e hënës ndaj yjeve. Vërtet, dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Ata nuk lënë pas vetes as dinarë, e as dirhem. Ata lënë në trashëgim vetëm dituri. Kështu që kushdo që e merr atë, ai ka marrë një hise me tepri.' Transmetuar nga Ebu Daud [nr. 3641], et-Tirmidhi [nr.2822] dhe Ibn Maxheh [nr.223]. Është vërtetuar nga el-Albani në Sahi Ibn Maxheh [nr. 182]. Po ashtu është transmetuar nga ed-Darimi [nr. 342]. Referoju Sherhus-Sunneh [nr. 173-179].

"Vërtet, ata që më së shumti i frikësohen Allahun nga robërit e Tij janë dijetarët."

[Fatir: 28]

"Allahu i ka ngritur në shkallë ata që besojnë prej jush dhe ata që posedojnë dituri."

[Muxhadile: 11]

Dhe Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar iu referohet dijetarëve si *musabir* [që posedojnë të pamë], ndërsa personit të paditur i referohet si *e'ma* [i verbër]. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm tha,

"Atëherë, a është i njëjtë ai që e di atë që të është shpallur ty nga Zoti yt, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit që kuptojnë janë të vëmendshëm." [Ra'd: 19]

Shiko, pra, në dallimet e qarta dhe evidente mes dijetarit që sheh dhe të paditurit që bredh pa qëllim nëpër këtë botë. Kur ai bën ndonjë vepër, ai nuk bën dallim mes pikëpamjes së saktë dhe asaj që është gabim, e as mes të vërtetës dhe të sajuarës. Pra, kjo s'është tjetër veçse rezultat i injorancës, gjë që shton në distancën mes tij dhe tubimeve të diturisë e hallkave të dijetarëve.

Nga ajo që është ardhur në inkurajimin e diturisë, e cila sjell vepra të mira si fryt është thënia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], "Kushdo që ndjek rrugë për të kërkuar dituri, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhennet."¹² Ky është një premtim bujar, të cilin Allahu e ka veçuar për ata që ndjekin shtigjet e diturisë, ata që kërkojnë dituri të dobishme e cila prodhon vepra të mira si fryte. Qëllimi i tyre pas kësaj është kënaqësia e Allahut dhe parajsja e Tij në vendbanimin e Tij të lumturisë. Dhe ata e kanë frikë hidhërimin e Allahut dhe dënimin e tij të ashpër. Kështu që besimtari përherë mbetet mes gjendjes së frikës dhe shpresës.

Pra, ai kryen vepër bazuar në dituri, meqë kjo është fryti i saj. Kur robi di diçka dhe vepron sipas saj, ai më pas duhet ta plotësojë veprën e tij duke i thirrur të tjerët në të, ashtu që t'u bëhet e njohur edhe atyre dhe të veprojnë në përputhje me të sipas mundësive që kanë. Kështu që qëllimi i përpjekjes së tij janë ata që janë afër dhe larg, por ata që janë afër kanë përparësi në da'uen [thirrjen] e tij.

"Dhe paralajmëro farefisn tënd." [Shu'ara: 214].

12. Kontrollimi për këtë hadith tashmë ka paraprirë

Çështja e tretë: Thirrja për në dituri

Vazhdoi shejhul-Islam Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Së treti, të thirren të tjerët në të."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Çështje e tretë është da'ueja [thirrja] për në dituri dhe vepër. Dhe prej njerëzve më të mirë janë ata që dinë dhe veprojnë sipas diturisë së tyre dhe i thërrasin njerëzit në dituri dhe vepër, siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm,

"Dhe kush është më i mirë se ai që thërret për tek Allahu dhe bën vepra të mira e thotë: unë jam prej muslimanëve." [Fussilet: 33]

Kjo do të thotë se, ai thërret për tek Allahu, vepron sipas Sheriatit të Allahut dhe i nënshtrohet dhe dorëzohet Urdhrit të Allahut në bindje."

Çështja e katërt: Të qenit i durueshëm ndaj fatkeqësive që vijnë krahas da'ues

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, "Së katërti, të qenit i durueshëm në lidhje me fatkeqësitë që ndodhin për shkak të kësaj."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madhkali – hafidhahullah, "Nuk ka thirrës që thërret njerëzit në atë çka kanë thirrur të dërguarit, përveç se do të ndeshet me fatkeqësi, mu ashtu siç pejgamberët përjetuan fatkeqësi nga populli i tyre. Pra, ai duhet të jetë i durueshëm. Domethënë ai duhet të mbahet për durimin, të cilit i referohet si cilësia më e mirë e Ehlul-Imanit [njerëzve të besimit]. Dhe kjo është taktika më e mirë për të shtyrë përpara thirrësin për tek Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar, qoftë kjo da'ue ndaj atyre që janë afër thirrësit apo da'ue ndaj të tjerëve pos këtyre. Nuk ka ikje prej [domosdoshmërisë së] të qenit i durueshëm.

Së pari, ai s'duhet të hyjë në shtegun e da'ues, përveç me durim. Së dyti, kur ai thërret njerëzit dhe vëren diçka që i bën ata ta refuzojnë da'uen e tij, ai duhet të vendosë që ta bëjë këtë duke shpresuar shpërblimin nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm dhe në përkrahje prej Tij, siç ishte rruga e pejgamberëve dhe të dërguarve kurdoqoftë që Allahu i ka dërguar për t'i thirrur popujt e tyre në Teuhid [njësi] të Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, bindje ndaj tij, dhe ndjekjen e të dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam]."

Tefsiri i suretu-Asr

Vazhdoi shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1203H] – rahimehullah, "Dhe dëshmi është thënia e Allahut të Lartësuar, me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit,

"Pasha kohën, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe e këshillojnë njëri-tjetrin me të vërtetën dhe për durim." [Asr: 1-3]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Pra, autori – rahimehullah – përdori thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"... dhe këshilluan njëri-tjetrin për të vërtetën dhe për durim,"13

si dëshmi për këtë çështje.

Allahu betohet në kohën [el-asr], se i gjithë njerëzimi është në humbje, përveç atyre që mund të përshkruhen me katër cilësi. Cilësia e parë është imani [besimi], dhe kjo është që të kesh vepër zemre dhe besim të fortë [tesdikul-xhazim] në çdo gjë që e obligon

Imani nga feja Islame. Cilësia e dytë është që të bëhen vepra të mira me gjymtyrë. Dhe ajo që mendohet këtu janë veprat e jashtme si namazi, agjërimi, zekati [lëmosha], haxhi [pelegrinazhi], xhihadi, kërkimi për dituri, urdhërimi i së mirës dhe ndalimi i së keqes, thirrja për tek Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm dhe të tjera pos këtyre nga veprat që njerëzit e besimit nuk kanë pushuar së bëri me gjymtyrët e tyre.

Cilësia e tretë është këshillimi me të vërtetën, dhe kjo cilësi s'mund të përmbushet nga ndokush, përveç pasi ai të ketë njohur të vërtetën. Pra, çështja kthehet prapa në dituri; nëse kjo është e pranishme, atëherë kjo është shkak për udhëzimin e atij që thërret ata, ashtu që ata të jenë të udhëzuar me udhëzimin e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Njohja e së vërtetës është parakusht për këshillimin me të vërtetën. Kjo ngase s'është e mundur për ju që të këshilloni njerëzit me të vërtetën, përveç pasi të keni përvetësuar atë, e kjo është detyrim. Këshillimi i njerëzve me të vërtetën ka shkallë të ndryshme, në pajtim me shkallët e tyre në njohjen e së vërtetës. Pra, kjo është këshillim me të vërtetën në kuptimin e përgjithshëm, ndërsa ajo këshillim në kuptimin e hollësishëm. Kjo është ajo që përshihet në thënien e Allahut,

"Dhe luginat rrjedhin sipas përmasave të tyre." [Ra'd: 17]

Çdo gjë ndodh në pajtim me gjendjen e saj dhe në pajtim me mundësinë e saj. E vërteta për të cilën është detyrim që të këshillohemi është Teuhidi i Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Është Teuhidi në Rububijetin [Zotërimin] e Tij, Uluhijetin [Hyjninë] dhe Esmaves-Sifat [Emrat dhe Cilësitë] e Tij. Më pas vijnë detyrat me të cilat Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i ka ngarkuar robërit, së bashku me llojet e tyre të ndryshme, dhe më e rëndësishmja prej tyre pas shahadetejn [dy dëshmime] është namazi. Pastaj, kjo duhet të përforcohet me zekat [lëmoshë], dhe gjithashtu me shtyllat tjera të Islamit, imanin dhe *ihсанin*.

13. Tha imam Ibnul-Kajim [v.751H] – rahimehullah – në lidhje me suretul-Asr, "Ky është qëllimi i persosorisë; meqë persosuri është që njeriu të jetë i persosur përbrenda vetvetes, si rrjedhim duke i persosur ata rreth tij. Persosuria e tij arrihet duke e korigjuar diturinë e tij dhe fuqinë që ndërlihet me vepra, saktësinë e diturisë së tij mbi Imanin, dhe saktësinë e diturisë së tij mbi veprat e mira. Përmirësimi që ai ua bën të tjerëve, përfitmi i diturisë për vete, të qenit durimtar në këtë dhe këshillimi me të vërtetën është për shkak të diturisë dhe veprës. Me pak fjalë, kjo kaptinë kombinon të gjitha kaptinat e Kur'anit në total. Dhe falënderimi i takon Allahut që e bëri të mjaftueshëm Librin e Tij mbi të tjerat, që është shërim për çdo sëmundje dhe një udhëzim për tek çdo e mirë." Referoju Miftah Darus-Se'adeh [1/99]

Kategoria e katërt është durimi së bashku me kategoritë e tij të ndryshme, [i] Të qenit i durueshëm në bindje ndaj Allahut. Pra, ai kryen vepra me shpresë se do të shpërblehet dhe ka frikë së do të dështojë në lidhje me këtë; [ii] Të qenit i durueshëm me mosbindjen ndaj Allahut. Pra, ai qëndron larg kësaj kur kjo përbën rrezik në jetën e kësaj bote, në *berzekh* [ndërkohë], dhe jetën e përtejme. Dhe popujt e kaluar – për të cilët Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm na ka informuar në ajetet e qarta të Kur'anit – nuk qenë

shkatërruar, përveç për shkak të mosbindjes. Prej tyre janë edhe ata të cilët i ka fundosur Allahu, dhe prej tyre janë edhe ata të cilët Allahu i goditi me vetëtimë, dhe prej tyre janë edhe ata të cilët Allahu i mori me një britmë të fortë, dhe prej tyre janë ata të cilët Allahu i zhyti brenda në tokë, dhe prej tyre janë ata të cilët u deformuan¹⁴. E tërë kjo ka qenë për shkak të një gjëje, e kjo është mosbindja ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Kjo ngase bindja ndaj Allahut është e detyrueshme, andaj Ai s'bën të kundërshtohet. Mosbindja ndaj Allahut është një akt i paligjshëm dhe djallëzor, dhe kjo e detyron Hidhërimin e Tij, Urrejjen, Pakënaqësinë dhe dënimin e rëndë. Prandaj, prej llojeve të durimit është durimi në lidhje me mosbindjen ndaj Allahut dhe që të mos i afrohem kësaj. Kështu që nëse ai bie në të, atëherë duhet të shpejtojë për tek Allahu me pendim dhe që sinqerisht të kërkojë falje. Ai duhet të jetë servil përpara Allahut. Ai duhet ta përcjell veprën e tij të keqe me një të mirë, siç thotë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm,

"Vërtet, veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija." [Hud: 114]

Ngjashëm, i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] ka thënë, "Përcjelle veprën e keqe me një të mirë, meqë ajo e shlyen të mëparshmen."¹⁵

Lloji i tretë i durimit është durimi me vendimin e Allahut dhe paracaktimin e Tij dhe ligjet e Tij lidhur me robërit e Tij. S'ka asgjë në univers që lëviz, as diçka që ndodh, e as ndonjë çështje nga mesi i çështjeve, përveç se Allahu e ka dekretuar atë. Nuk ka ikje nga durimi, që do të thotë durim me fatkeqësitë që godasin vetveten tonë, apo të birin, apo pasurinë, apo të ngjashmet me këto nga Suneti i vazhdueshëm i Allahut në këtë univers. Prandaj, ju do të gjeni se krijimi goditet me lloje të ndryshme të fatkeqësive: njëri goditet me varfëri, tjetri me sëmundje, tjetri me shqetësim dhe mërzi, tjetri me frikë ndërsa tjetri me çështje që e turpërojnë atë.

14. Këtu, shejhu – hafidhahullah – tregon në thënien e Allahut të Lartësuar, "Dhe ne e dënuam secilin prej tyre për mëkatet që bënin. Prej tyre ishin disa të cilëve ua dërguam një erë të fuqishme me breshëri gurësh, dhe prej tyre ishin disa të cilët qenë marrë nga një erë e tmerrshme, dhe prej tyre ishin disa që Ne e bëmë tokën t'i përbijë ata, dhe prej tyre ishin disa të cilët Ne i fundosëm. Allahu nuk u bëri padrejtësi atyre, por ata i bënë padrejtësi vetvetes." [Ankebut: 40]

15. Hasen: transmetuar nga Ahmed [5/153-158, 177, 236], et-Tirmidhi [nr. 1987], ed-Darimi [nr. 2791], el-Hakim në el-Mustredrek [nr. 178] dhe Hiljetul-Eulija [4/378]. Është shpallur Hasen nga imam el-Albani në el-Mishkat-Mesabih [nr. 5083].

Pra, agjë nga kjo s'do t'i bëjë dobi atij, përveç nëse është i durueshëm dhe këmbëngulës, duke kërkuar me këtë Fytyrën e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm, dhe duke dëshiruar shpërblimin e durimtarit, të cilit Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i ka kumtuar lajmin e mirë në thënien e Tij,

"Dhe lajmi i mirë është për ata që janë të durueshëm." [Bekare: 155]

Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë,

"Vërtet, ata që janë të durueshëm do të kenë shpërblim pa njehsim." [Zumer: 10]

Pra, për shkak të çështjes madhështore të durimit, Allahu e këshilloi pejgamberin e Tij [salallahu alejhi ue selam], duke thënë,

"Ji i durueshëm; dhe çfarë do të bëjë ty të jesh i durueshëm, përveç Allahut." [Nahl: 127]

Gjithashtu, njerëzit e intelektit qenë urdhëruar dhe ndaluar në thënien e Allahut,

"Ata që bashkojnë atë për të cilën Allahu ka urdhëruar të jetë e bashkuar, kanë frikë Zotit e tyre, dhe tmerrohen nga llogaria e lemerishme." [Ra'd: 21]

Deri aty ku tha,

"Dhe ata që janë të durueshëm, duke kërkuar Fytyrën e Zotit të tyre me këtë." [Ra'd: 22]

Pra, s'ka ikje nga durimi; durimi përmes së cilit kërkohet Fytyra e Allahut dhe vendbanimi i jetës së përtejme. Dhe qëllimi i durimit s'është që të thuhet, "Filani është i durueshëm dhe i qëndrueshëm," dhe çfarëdo qoftë që i gjason kësaj prej atyre që vetëm dëshirojnë të shihen nga njerëzit. Më saktë, përmes durimit duhet të kërkohet Fytyra e Allahut, meqë kjo është prej akteve të mira e të dëlira të adhurimit, të cilat janë të detyrueshme për njerëzit e Islamit, imanit dhe *ihsanit*."

Mësimi i dytë

Pasqyrë e shkurtë nga mësimi paraprak

Falënderimi i takon Allahut dhe paqja qoftë mbi të dërguarin e Allahut. Paraprakisht ne mbuluam atë që përmendi autori – rahimehullah – nga çështjet, të cilat janë të detyrueshme për çdo musliman që t'i di, qoftë mashkull apo femër. Ai përmendi çështjen e parë: që është dituria, e cila përbën diturinë mbi Allahun në lidhje me Qenësinë [dhat] e Tij dhe Emrat dhe Cilësitë e Tij. Kjo po ashtu përfshin dashurinë ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar dhe dashurinë ndaj të dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam] dhe çfarëdo që ai solli nga Allahu shprehur në urdhra ndalimet dhe detyrimet Sheriatike për Umetin. E tërë kjo është dituri që është shpallur nga Allahur i Bekuar dhe i Lartësuar ashtu që të veprohet sipas saj. Pra, e tërë bota e njerëzimit dhe Xhinëve hyjnë

nën këtë detyrim. Po ashtu në këtë kategori hyn dhe dituria mbi pejgamberin [salallahu alejhi ue selam]. Është prej Sheriatit që të dihet se kush është ai dhe me çka erdhi, si dhe kujt i është adresuar thirrja [da'ueti] i tij.

Pra, ai është i dërguari i Allahut në të vërtetën. Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar e dërgoi atë si mëshirë për gjithë njerëzimin. Dhe Allahu i dërgoi atij Librin e Tij të qartë, kështu që ai të mund të thërrasë të dy botrat [njerëzimin dhe xhinët] në adhurimin e Allahut të vetëm dhe ta braktisin adhurimin e ndonjë gjëje tjetër pos Tij. Pra, është e detyrueshme për njerëzimin që ta dojë atë me një dashuri më të madhe se dashuria që kanë për vetveten, apo për etërit e tyre, apo për bijt e tyre apo për gjithë njerëzimin,¹⁶ ngase Allahu e ka zgjedhur atë, e ka obliguar atë dhe e ka bërë që të shquhet mbi të gjitha krijesat tjera dhe për shkak se Allahu e siguroi krijimin prej njerëzimit dhe xhinëve nëpërmjet tij nga errësira e injorancës dhe shkatërrimi i paudhësisë për në dritën e diturisë dhe iman [besim] dhe dituri mbi Allahun dhe çfarëdo që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar do.

Njohja e fesë së Allahut së bashku me dëshmitë e saja po ashtu bën pjesë në dituri. Pra feja e Allahut është feja me të cilën Allahu i këshilloi të gjithë të dërguarit dhe pejgamberët, ashtu që ata ta bartin atë tek popujt e tokës që nga nisja e historisë së popujve. Kjo nisi me popullin e parë që i ishte dërguar lajmëtar, dhe ai ishte Nuhu [alejhis-selam]. Allahu e urdhëroi atë që të thërrasë në Islam dhe bazë e tij ishte që të adhurohet Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm me Teuhid [njëshmëri] të Rububijetit [Zotërimit] të Tij, Uluhijetit [Hyjnisë] së Tij dhe Esmat-ues-Sifat [Emrat dhe Cilësitë] e Tij dhe të gjitha Veprave [ef'al] të Tij. Kështu që të dërguarit, pejgamberët dhe ata që thërritën me da'uen e tyre pasuan në thirrjen në Islam dhe në thirrjen për të vepruar sipas tij dhe që të braktiset çdo gjë tjetër veç kësaj, gjersa Porositë përfunduan me Porosinë e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. E ai është thirrësi më i madh dhe më i urtë në Islam.

16. Këtu, shejhu – rahimehullah – aludon në hadithin që transmetohet nga Enes [radiallahu anhu] i cili tha se i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] ka thënë, “Asnjëri prej jush nuk ka besuar realisht gjersa unë të bëhem më i dashur për të se i biri i tij, ati i tij dhe i tërë njerëzimi.” Transmetuar nga el-Buhari [1/21], Muslim [1/67], Ibn Maxheh [1/26] dhe en-Nesa'i [6/534].

Dhe Sheriati i tij përmban udhëzim, dritë dhe mëshirë dhe Allahu i Madhëruar dhe i Lartësuar e ka bërë Islamin shtegun e vetëm që çon tek Ai dhe e ka bërë Rugën e Drejtë. Pra, kushdo që përshkon këtë shteg të Drejtë do ta mbërrijë kënaqësinë e Allahut dhe parajsën e Tij në vendbanimin e fisnikërisë dhe ai do të jetë i shpëtuar nga denimi, ndëshkimi dhe tortura poshtëruese e Allahut.

Pra, kur ne i kthehemi domethënies së Islamit, e kuptojmë me siguri se feja e vërtetë është ajo në të cilën thirri çdo i dërguar i Allahut dhe çdo pejgamber i Allahut dhe çdo

dijetar i drejtë. Ata thirrën me da'ue të peygamberëve dhe të të dërguarve, e cila është istislam [nënshtim] ndaj Allahut me Teuhid dhe që t'i binden Atij dhe t'i dorëzohen Atij dhe të heqin dorë prej Shirkut dhe të jenë të lirë nga ai dhe njerëzit e tij. Pra ky është çelësi për tek porosia e çdo të dërguari që është dërguar dhe çdo peygamberi që është dërguar po ashtu. Kur'ani fisnik është dëshmia më e mirë për këtë menhëxh [metodologji], i cili është ndjekur suksesivisht nga të dërguarit dhe peygamberët e Allahut dhe në të cilën kanë ecur dijetarët e drejtë në çdo kohë që prej nisjes së historisë së kësaj jete.

Ne po ashtu ndeshëm edhe çështjen e dytë, që është të vepruarit sipas diturisë dhe ne përmendëm se vepra është fryt i diturisë, ngase dituria e dobishme e cila përftohet nga Libri i Allahut dhe Suneti i peygamberit [sallallahu alejhi ue selam] sjell vepra të mira. Kështu që të dyja këto kanë sukses së bashku me njëra-tjetrën, dhe njëra s'do t'ju maftojë pa tjetrën; pra duhet të ketë dituri dhe vepër. Kur ta ndani njëren prej tjetrës, ashtu që të kihet dituri por që kjo të mos zbatohet me vepra, atëherë ky është shtegu i atyre mbi të cilët është hidhërimi i Allahut [el-magdub alejhim], dhe shpëtimi kërkohet prej Allahut. Kurse kur të kryhen veprat në mungesë të diturisë, ky është shtegu i të humburve [ed-dalin]. Mirëpo, kur dituria të gjindet krahas veprës, ky është shtegu i atyre të cilët Allahu i ka favorizuar [el-mun'em alejhim] nga peygamberët, besnikët, dëshmorët dhe të drejtët.¹⁷ Ata janë të cilët Allahu i ka përmendur në thënien e Tij,

“Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të dërguarit të Tij, ata do të jenë me ata që Allahu i ka favorizuar nga peygamberët, besnikët, dëshmorët dhe të drejtët. Dhe sa shoqëruet të shkëlqyeshëm që janë këta! Kjo është prej epërsisë së Allahut dhe Allahu mjafton si i Gjithdijshëm.” [en-Nisa: 69-70]

17. Tha Imam el-Muxhedid, shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab [v.1206H] – rahimehullah, “Ata mbi të cilët është hidhërimi i Allahut [el-magdub alejhim] janë ata që nuk kanë vepruar sipas diturisë së tyre. Kurse të humburit [ed-dalin] janë ata që kanë kryer vepra pa dituri. E para është cilësi e Çifutëve ndërsa e dyta është cilësi e të Krishterëve. Kështu që shumë njerëz e shohin tefsirin [shpjegimin] se Çifutët janë ata mbi të cilët është hidhërimi i Allahut dhe se të Krishterët janë të humburit, e njerëzit – për shkak të opinionit të gabuar që kanë – mendojnë së këto ajete janë të kufizuara vetëm në këta. Mirëpo, njeriu duhet të pohojë se Zoti i tij është Ai që Dekreton, dhe për këtë shkak ai kërkon me këtë lutje. Dhe njeriu duhet të kërkojë mbrojtje nga rruga/mënyra e njerëzve të këtyre cilësive.” Referoju Mu'allifatush-Shejhil-Islam Muhamed ibn Abdul-Uehab [5/18].

Prej plotësimit të të vepruarit sipas diturisë është thirrja në të. Meqë, dituria s'mund të përhapet, as nuk mund të kuptohet sipas kontekstit të duhur, e as që mund t'i sjellë dobi Umetit, përveç nëse gjendet ndokush për të bërë d'ue në këtë dituri dhe vepër. Dikush duhet të bëjë da'ue për në dituri dhe vepër. Kështu që njerëzit më të dëlirë dhe më fisnikë janë ata që i japin rëndësi da'ues për në dituri dhe vepër. Arsyeja për këtë fisnikëri dhe dëlirësi është fakti se ata janë trashëgimtarë të peygamberëve dhe të të dërguarve, ngase peygamberët dhe të dërguarit erdhën me da'ue të diturisë dhe veprës.

Pra, Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar i solli udhëzim cilitdo që deshi ta udhëzojë nëpërmjet da'ues së tyre. Allahu do t'i udhëzojë ata që i përshtaten mirësisë ndërsa e mban larg [udhëzimin] prej atij që është i pafat. Kështu Allahu e ka gjykuar atë në braktisje dhe devijim, ngase ai nuk i është përshtatur mirësisë. Dhe Allahu nuk pyetet për atë që bën, por ata pyeten. Pra s'mund të thuhet, 'Përse Ai i gjykoi këta në udhëzim kurse i humbi të tjerët?' Kjo s'do të thuhet nga ai që ka dituri mbi Qenësinë [dhat] e Allahut, e as që do të thuhet nga ai që e ka kuptuar lartësinë e vërtetë të Allahut. Thënia e këtillë bëhet vetëm nga njerëzit e herezisë, devijimit dhe mungesës së diturisë së dobishme, e cila sjell veprën e mirë si fryt.

Pra, nga shtyllat e thirrjes për në dituri dhe vepër dhe nga mënyrat madhështore të Sheriatit është sabri [durimi] ndaj dëmit që duhet përballur për shkak të da'ues. Kjo është çështja e katërt, 'durimi ndaj dëmit me të cilin përballemi për shkak të saj [thirrjes].' Kjo ngase është e pashmangshme që thirrësi të përballet me grupe të njerëzve, të cilët dallojnë në të kuptuarit e tyre dhe dallojnë në prirjet dhe shkallët e tyre. Kështu që prej tyre janë ata që do ta pranojnë da'uen e tij me rastin e parë, dhe këta janë ata, fitreja [prirja natyrore] e të cilëve ka mbetur e padëmtuar. Kur ata thirren për tek Allahu dhe i dërguari i Tij [salallahu alejhi ue selam], ju do t'i shihni ata se e përqafojnë të parët thirrjen, e pranojnë atë dhe e duan atë. Më pas do të shihni të tjerë që e refuzojnë thirrjen për në mirësi dhe thirrjen për në të vërtetën dhe udhëzimin për shkak të injorancës së tyre ndaj asaj për çka kanë pasur nevojë dje. Nëse ai ka nevojë për ushqim, pije dhe oksigjen, ai po ashtu ka nevojë për dituri dhe vepër, mu ashtu siç ka nevojë për ushqim, pije dhe oksigjen. Më saktë, nevoja e tij për dituri dhe vepër është më e madhe, por shumë njerëz s'janë të vetëdijshëm për urtësinë për të cilën ata janë krijuar dhe riprodhuar. Për shkak të kësaj mospërputhjeje dhe dallimi mes njerëzve dhe pozitave të tyre të ndryshme, është e pashmangshme që thirrësi për në dituri dhe vepër të jetë i durueshëm ndaj asaj që e dëmton atë. Shembujt e tij në këtë janë të dërguarit dhe pejgamberët e Allahut [alejhimus-salatu ues-selam], dhe çdo thirrës për tek Allahu duhet të jetë i durueshëm dhe i sinqertë dhe duhet të shpresojë në kënaqësinë e Allahut dhe parajsën e Tij për da'uen e tij dhe ai duhet të ketë frikë nga dënimi i Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar.

Vërtet, autori – rahimehullah – e ka përdorur kaptinën më madhështore si dëshmi për thirrje për në dituri dhe veprim sipas saj. Dhe ai e ka përdorur këtë si dëshmi për ta thirrur krijimin në të dhe për të qenë i durueshëm ndaj asaj që e dëmton personin në këtë shteg. Kjo kaptinë është kaptina Asr, meqë Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ka përmendur një parim të përgjithshëm në të. Në të qëndron se i gjithë njerëzimi është në humbje, që do të thotë se ata janë të shkatërruar, përveç atyre që janë lavdëruar në thënien e Allahut,

“Përveç atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira, e këshillojnë njëri-tjetrin me të vërtetën dhe e këshillojnë njëri-tjetrin për durim.” [Asr:3]

Pra, këta janë ata që kombinojnë diturinë, të vepruarit sipas saj, të thirrurit krijimin në të dhe të qenit i durueshëm ndaj dëmit që e pranojnë si rezultat i tërë kësaj. Këta janë elita e njerëzimit, më të mirët prej tyre dhe më të dëlirët. Prandaj, Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar s'i ka përshirë në humbje. Dhe kushdo që është i sigurt nga humbja, ai është që përfiton dhe ai arrin sukseset më të mëdha në jetën e kësaj bote, *berzekhun* e tij dhe në jetën e përtejme të tij. Ai është i suksesshëm dhe triumfues ngase ndjek urdhrin e Zotit të Tij. Ai beson në çdo gjë në të cilën është e detyrueshme të besohet, së brendshmi dhe së jashtmi, në thënie, vepra dhe besim. Dhe ai duhet të kryej vepra të mira me gjymtyrët e tij. Pra, shërbimi i gjymtyrëve dhe i ndjenjave është që të zbatojnë detyrime të ndryshme.

Më pas ai nis të thërret krijimin në pafundësinë e së vërtetës në urdhrat dhe ndalimet, në sqarim dhe shpjegim, në fitore dhe pushtim. Ai nuk dëshiron ndonjë lavdërim apo falënderim prej tyre. Mirëpo, ai do që ata të përshkojnë në kënaqësinë e Zotit të tyre dhe t'i afrohen Atij më shumë me vepra të mira dhe të mbeten larg nga vendet e poshtërimt. Kështu që me këtë, ai dhe grupi i tij ishin të suksesshëm dhe ishin vazhdimisht të durueshëm në këtë gjatë jetëgjatësisë së tyre në të cilën ata i bënë da'ue krijimit të Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Kjo ishte një pasqyrë e shkurtë e mësimi paraprak.

Teksti dhe shpjegimi

Tha shejhul-Islam Muhamed ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, 'Ka thënë esh-Shafi'i¹⁸ [v.204H] – rahimehullahu te'ala – 'Sikur Allahu të mos i kishte shpallur krijimit të Tij kaptinë tjetër pos kësaj, kjo do të mjaftonte për ta.'¹⁹

Thënia e esh-Shafi'iut në lidhje me suretul-Asr

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, 'Pra ne jemi ndalur tek thënia e esh-Shafi'iut – rahimehullah, "Sikur Allahu të mos i kishte shpallur krijimit të Tij kaptinë tjetër pos kësaj, kjo do të mjaftonte për ta."

18. Ai është Imami, dijetari i kohës së tij, përkrahësi i hadithit, fekihi i fesë, Ebu Abdullah Muhamed Ibn Idris Ibnul-Abas esh-Shafi'i. Ai është lindur në Ghezeh. Nëna e tij e çoi në Meke kur ai ishte dy vjeç që mos ta humbiste prejardhjen. Kështu që ai u rrit aty dhe lexoi Kur'an derisa ishte djalë shtatë vjeç dhe e mësoi përmendsh el-Mueta kur ishte dhjetë vjeç. Ai nisi të japë fetua kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç, dhe thuhet se ishte tetëmbëdhjetë vjeç. Ai shkroi libra dhe regjistroi dituri. Ai përgënjeshtroi shumë Imamë duke ndjekur atharin [gjurmët e të parëve]. Ai shkroi në lidhje me usulul-fikh dhe degët e tija. Ai vdiq në vitin 240H në moshën pesëdhjetë e katër vjeçare. Referoju el-Bidaje uen-Nihaje [10/254], Sijer E'lamun-Nubela [10/5] dhe Terkribut-Tehdhib [2/53].

19. Transmetuar nga Ibn Kethir në tefsirin e tij [4/549]

Pra kjo thënie provon thellësinë e të kuptuarit dhe diturisë të esh-Shafi’iut mbi domethënien e fjalës së Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Njëlloj është rasti me çdonjërin që zbaton studim të vëmendshëm - ai do të shohë se sikur Allahu të mos i kishte shpallur gjë tjetër krijimit pos kësaj kaptine, e cila thërret krijimin që të besojë në çdo gjë që Allahu ka bërë detyrim të besohet në të, kjo do të mjaftonte ngase Allahu ka thënë,

“Përveç atyre që besojnë...”

Pra në të gjendet thirrja për në vepër të mirë me të gjitha llojet e saja nga detyrat e obligueshme dhe Suneti. Kjo është da’ue për njerëzit për tek e vërteta, që të vepron sipas saj dhe të kihet durim ndaj fatkeqësive që vijnë si rezultat i kësaj. Kështu që esh-Shafi’i – rahimehullah – ishte i vërtetë kur tha, “Sikur Allahu të mos i kishte shpallur krijimit të Tij kaptinë tjetër pos kësaj, kjo do të mjaftonte për ta.” E si mund të mos jetë kështu kur Allahu shpalli njëqind e katërbëdhjetë kaptina [sure]. Prej tyre janë ato që janë të gjata, të shkurtra dhe prej kësaj janë ato më pak se kjo dhe prej kësaj janë ato që janë të detajizuara. Kjo çështje është e njohur ngase Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e shpalli këtë Kur’an dhe e bëri detyrim mësimin përmendsh të tij, siç qëndron në thënien e Tij,

“Vërtet, Ne e kemi shpallur Përkujtuesin dhe Ne do ta ruajmë Atë.” [Hixhr: 9]

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Dhe el-Buhari – rahuimehullahu te’ala – ka thënë, “Kaptina: Dituria vjen përpara thënieve dhe veprave, dhe dëshmi është thënia e Allahut të Lartësuar,

“Pra ta dish se nuk ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe pendohu për mëkatet tua.” [Muhamed: 19]

Kështu ai nisi me dituri përpara thënieve dhe veprave.”

Titujt e kaptinave të el-Buharit pasqyrojnë parime fikhu

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Pra el-Buhari – rahimehullah – tha, “Kaptina: Dituria vjen përpara thënieve dhe veprave.’ Titujt dhe temat e el-Buharit pasqyrojnë parime të fikhut dhe parime të diturisë, ngase ai nisi me atë që përkrahet nga Kur’ani fisnik apo hadithi i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Kështu që ai e caktoi këtë titull të kaptinës, ‘Kaptina: Dituria vjen përpara thënieve dhe veprave.’ Ai e mori këtë nga thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

“Pra ta dish se nuk ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe pendohu për mëkatet tua.” [Muhamed: 19]

Pra, këtu ai nisi. Ai nisi me atë çka Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm nisi në lidhje me këtë çështje, e cila është e bekuar për peygamberin [salallahu alejhi ue selam] dhe Umetin e tij që e ndjek në këtë. Allahu e urdhëroi atë me dituri. E kujt i referohet kjo, përveç asaj se çdo akt adhurimi i kryer pa dituri nuk ka kurrfarë peshe tek Allahu. Më saktë, është e pashmangshme që dituria t’i paraprijë veprës, derisa kryesi i veprës të arrijë mendjehollësi në lidhje me çështjen e tij.

Dhe ne kemi përmendur më herët se dituria dhe vepra duhet të shkojnë së bashku. Kushdo që kombinon të dyja këto, ai do të jetë i udhëzuar për në Rrugën e Drejtë, dhe kushdo që përfiton dituri por nuk vepron sipas saj, ai ka përshkuar shtegun e atyre mbi të cilët është hidhërimi i Allahut. Dhe kushdo që vepron pa dituri, por në vend të kësaj vepron bazuar në injorancë dhe gabim, ai ka përshkuar shtegun e atyre që janë të humbur. Pra, këto janë parimet e mirënjohura përbrenda fesë Islame. Prandaj, në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm qëndron,

“Pra ta dish se nuk ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe pendohu për mëkatet tua.” [Muhamed: 19]

Më së miri për thirrësin dhe mësuesin është që të ndalen në domethënien e kësaj fjale, *kelimetul-ihlas* [fjala e sinqeritetit]: La ilahe ilAllah [Nuk ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut]. Kështu që ai së pari duhet t’i njohë shtyllat e kësaj, konditat e kësaj së dyti dhe të drejtat dhe kushtet paraprake të kësaj sipas aftësisë e tij së treti.

Shtyllat e La ilahe ilAllah

Vërtet, dijetarët tanë – rahimehullah – kanë përmendur se La ilahe ilAllah ka shtylla, kushte, të drejta, detyrime dhe kushte paraprake. Shtyllat e saja janë dy: [i] afirmimi (el-ithbat) dhe [ii] mohimi (en-nefi).²⁰ Për sa i përket en-nefi (mohimit), kjo është marrë nga thënia e juaj, ‘La ilahe (Nuk ka perëndi që meriton të adhurohet).’ Për sa i përket el-ithbat (afirmimit), kjo është marrë nga thënia e juaj, ‘ilAllah (përveç Allahut).’

Kështu që kuptimi i përgjithshëm është se s’ka perëndi të vërtetë që meriton të adhurohet përveç Allahut [la me’bud bi hak ilallah] të vetëm, pa ndonjë ortak. Pra, adhurimi i Allahut është e vërteta. Kurse adhurimi i tjetërkujt pos Allahut, nga idhujt dhe statujat që adhurohen krahas Allahut, është adhurim i gabuar që ushtrohet nga ai që ka rënë në këtë. Dhe adhurimi i tjetërkujt përveç Allahut është krimi më i madh mbi faqen e dheut dhe njëherësh mëkati më i madh me të cilin kundërshtohet Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar.

20. Vërtet, shejhu ynë, Zejd el-Madkhali i ka radhitur të dyja këto në një poemë me thënien e tij, 'Fjala e sinqeritetit ka dy shtylla, ato janë: mohimi dhe afirmimi. Kështu që mësoni përmendsh të dyja këto.'

Ekziston dëshmia që tregon në atë se Allahu nuk e fal atë njeri i cili vdes duke qenë në këtë. Në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm qëndron,

"Vërtet, Allahu nuk fal që Atij t'i shoqërohet ndokush krahas Tij, por Ai fal çfarëdo që është më pak se kjo cilitdo që Ai do." [Nisa:48]

Po ashtu qëndron në përgjigjen e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] ndaj atij që e pyeti, 'Cili është mëkati më i madh?' Ai u përgjigj: "Mëkati më i madh është që të adhurosh diçka krahas Allahut ndërsa Allahu është Ai që të ka krijuar."²¹

Kushtet për La ilahe ilAllah

Pra u përmenden shtyllat për La ilahe ilAllah. Shtatë kushtet e saja po ashtu janë përmendur, të cilat do të mësohen nëpërmjet ndjekjes dhe kontrollit të Librit dhe Sunetit.

Kushti i parë: Dituria [Ilm] mbi domethënien e saj. Kjo ngase kur robi flet dhe thotë, 'La ilahe ilAllah,' është e detyrueshme që ai të jetë i mirinformuar për domethënien e saj. Domethënë se s'ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut. Dhe çdo kusht prej kushteve të saja e ka të kundërtën. Kështu që e kundërta e diturisë është injoranca. Kur njeriu është injorant ndaj domethënies së saj, ai s'është në gjendje që ta zbatojë atë që kërkohet derisa të përfitojë dituri. Për shkak të kësaj, el-Buhari – rahimehullahu te'ala – ka thënë, "Kaptina: Dituria vjen përpara thënieve dhe veprave." Pra, e kundërta e diturisë është injoranca. Dhe kjo është bazë e fesë. Kështu që i takon çdo muslimani, qoftë mashkull apo femër, që t'i mësojë shtyllat dhe kushtet e saja, edhe nëse e mëson atë me anë të sqarimit të përgjithshëm.

Kushti i dytë: Bindja [jekiin] dhe kjo është që kur folësi të thotë, 'La ilahe ilAllah,' ai duhet të jetë i bindur në domethënien e saj dhe kjo e detyron mohimin [nefiin] dhe afirmimin [ithbat]. E kundërta e kësaj është dyshimi [shekk], kështu që s'është e lejueshme për muslimanin që të dyshojë në atë që është provuar nga domethënia e fjalës së ihlasit [sinqeritetit].

Kushti i tretë: Pranimiti [kubul] i domethënies madhështore të saj, e cila është mohim dhe afirmim. Pra, njeriu duhet ta pranojë atë me gjoks të hapur, më shpirt të kënaqur dhe iman [besim] të thellë. Vërtet, kjo fjalë është baza e fesë dhe parimi fundamental i saj. E kundërta e pranimit është refuzimi. Vërtet kjo ka qenë refuzuar nga mosbesimtarët

Kurejshitë, të cilëve peygamberi [salallahu alejhi ue selam] ua adresojë këtë da'ue [thirrje]. Pra, ata e refuzuan këtë fjalë [kelimeh] nga mendjemadhësia e adhurimit të idhujve dhe statujave, gjë në të cilën i gjetën etërit dhe gjyshërit e tyre dhe ata jetuan në fushëbeteja. Dhe Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i dha fitore grupit të besimtarëve duke i dhënë peygamberit bujar [salallahu alejhi ue selam] udhëheqjen mbi këta mosbesimtarë kokëfortë, të cilët nuk iu nënshtruan fjalës së sinqeritetit, përveç pasi qenë sulmuar dhe pasi që peygamberi [salallahu alejhi ue selam] i bëri të vuajnë.

21. Transmetuar nga el-Buhari [4/252] dhe en-Nesa'i [4/266]

Pra, grupi i besimtarëve që ndjekën peygamberin [salallahu alejhi ue selam] në nismën e çështjes ishin të pakët në numër. Prej tyre ishin ata që bënë hixhret [emigrim] për në el-Habeshe dhe prej tyre ishin ata që mbeten të fshehur gjersa Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm e solli fitoren e qartë. Kështu që së pari ndodhi hixhreti [emigrimi], më pas ndodhi fet'h [fitorja] dhe njerëzit hynë në fenë e Allahut në turma. Të vërtetës i qe dhënë fitorja dhe fjala - për të cilën Allahu krijoi të dy botrat, për të cilën Ai krijoi qiejt dhe tokën dhe për të cilën Ai krijoi Parajsën dhe Zjarrin - u ngrit lart dhe u bë më e larta. Xhahadi u ligjërta krahas da'ues, nasihatit [këshillës] dhe urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja. E gjithë kjo qe bërë për t'u realizuar domethënia e kësaj fjale bujare: La ilahe ilAllah.

Kushti i katërt: Nënshtrimi [el-inkijad], që do të thotë servilizëm dhe dorëzim së jashtmi dhe së brendshmi ndaj domethënies që gjindet në fjalën e sinqeritetit.

Kushti i pestë: Vërtetësia [es-sidk] dhe dëshmimi për të vërtetën e domethënies. Kështu që kur të thoni La ilahe ilAllah, ju duhet të jeni të vërtetë në atë që thoni. Dhe dëshmia për vërtetësi është që ju ta veçoni Zotin tuaj në të gjitha aktet e adhurimit, qofshin ato të ndërlidhura me pasuri apo trup, apo me të dyja këto së bashku. Pra ju e veçoni Allahun, pa i shoqëruar ortakë. Dhe ju nuk ia drejtoni askujt aktet tuaja të adhurimit përveç Atij, pikërisht ashtu siç ka urdhëruar Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm në thënien e Tij,

"Dhe Zoti yt ka marrë vendim që ju mos të adhuroni ndokënd tjetër përveç Tij." [Isra: 23]

Njëllor është edhe thënia e Tij,

"Adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni të tjerë Atij." [Nisa: 36]

Po ashtu thënia e Tij,

"Vërtet, xhamitë janë për Allahun, pra mos lutni ndokënd tjetër krahas Allahut."

[Xhin: 18]

Po ashtu qëndron në thënien e Tij të vërtetë,

"Kushdo që lutë perëndi tjetër krahas Allahut, ai për këtë nuk ka dëshmi. Kështu që llogaritja e tij do të jetë tek Allahu, dhe vërtet Ai nuk iu jep sukses mosbesimtarëve."
[Mu'minun: 117]

Ngjashëm qëndron edhe në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Ata s'qenë urdhëruar me tjetër pos që ta adhurojnë Allahun, duke e praktikuar fenë sinqerisht vetëm për Të. Dhe, ta falin namazin dhe ta japin zekatin – kjo është feja e saktë." [Bejjine: 5]

Dhe ka tjetër pos kësaj nga teksti në të cilin Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm urdhëroi krijimin për t'i drejtuar aktet e tyre të adhurimit nga zbatimi i urdhrave dhe përmbajtja prej ndalimeve, të konsideruarit e hallallit si të lejuar dhe të konsideruarit e haramit si të ndaluar, kryerjen e detyrave obligative, zbatimin e ndëshkimeve të parashkruara dhe përmbushjen e detyrimeve vetëm Allahut. Dhe njeriu duhet të përpiqet për t'iu afruar Allahut edhe më shumë duke bërë akte të rekomanduara. Këto janë aket e adhurimit me të cilat Allahu e ka obliguar tërë krijimin nga bota e njerëzimit dhe e Xhinëve. Andaj, domethënia e *siddk* [vërtetësisë] është se njeriu duhet të jetë i vërtetë dhe besnik ndaj domethënies së kësaj fjale madhështore.

E kundërta e *siddk* [vërtetësisë] është *kedhib* [refuzimi], mu ashtu siç është refuzuar nga mosbesimtarët në grupimet e tyre të ndryshme. Idhujtarët e refuzuan atë dhe heretikët që nuk besonin në ekzistencën e Allahut, as në Parajsën, as në Zjarrin, as në ringjalljen, e as në gjykimin. Çifutët e refuzuan atë dhe po ashtu edhe të Krishterët e refuzuan, kështu që Allahu u hidhërua me ta ngase ata nuk dëshmonin për vërtetësinë e kësaj fjale. Tërë ajo që ata bënë ishte vendosja e perëndive krahas Allahut. Pra idhujtarët mosbesimtarë vendosën tjera gjëra për t'u adhuruar krahas Allahut nga ushqimi, gurët, imazhet e skalitura dhe varret. Më pas ata kërkuan ndihmë prej tyre dhe nga ata të cilët i konsideronin *eulija* [të afërm të Allahut] në sjelljen e dobive dhe largimin e dëmit.

Pra, Çifutët adhuruan trininë, ashtu siç vepruan edhe të Krishterët, siç është shpjeguar qartë në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Çifutët thanë që Uzejri është i biri i Allahut." [Teube: 30]

Pra ata bënë një bir për Allahun.

"Të Krishterët thanë që Mesia është i biri i Allahut." [Teube: 30]

Allahu i përgënjeshtrojë ata dhe u heqi vërejtjen me thënien e Tij,

"Kjo është thënie nga gojët e tyre. Ata i imitojnë ata që mohuan përpara." [Teube: 30]

Dhe Ai i qortoi ata me thënien e Tij,

"Ata i morën murgjit dhe rabinët si dhe Mesinë, të birin e Merjemes për zota krahas Allahut." [Teube: 31]

Domethënë që ata i morën dijetarët dhe adhuruesit për zota, duke e konsideruar të lejuar atë që ata e shpallnin të lejuar dhe duke e konsideruar të ndaluar atë që ata e shpallnin të ndaluar. Pra ata i pasuan në këtë, kështu që Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i përgënjeshtroi ata ashpërsisht me qëllim që t'i japë Umetit të Kur'anit një këshillim dhe një pasqyrim kundër tyre duke e bërë atë që Allahu e ka sqaruar me thënien e Tij,

"Ata i morën murgjit dhe rabinët si dhe Mesinë, të birin e Merjemes për zota krahas Allahut. Mirëpo, ata s'qenë urdhëruar me tjetër pos që të adhuronin një perëndi, që s'ka të adhuruar me meritë përveç Tij. I Lavdëruar dhe i Lartësuar është Ai mbi atë që ata i shoqërojnë Atij." [Teube: 31]

Përsa i përket herëtikëve si *Duhrijin*²², *Tebai'jin*²³ dhe Marksistëve²⁴ - Pra ata nuk besojnë në ekzistencën e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Ata besuan vetëm në natyralizëm, e që kjo është të besosh se natyra ka shkaktuar çdo gjë përbrenda universit. Kur ata pyeten në lidhje me këtë natyrë, ata thonë se kjo është një vepër e jashtëzakonshme, sidoqoftë ata nuk dinë gjë lidhur me realitetin e saj. Pra, kjo është shtrirja maksimale e mohimit dhe herezisë.

Kushti i gjashtë: Sinqeriteti [ihlas], dhe e kundërta e saj është Shirku. Vepra e mushrikut [idhujtarit] është e pavlefshme dhe e anuluar dhe i kthehet atij për shkak të thënies së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Dhe Ne do t'u kthehem veprave që ata bënë, dhe do t'i bëjmë ato sikur grimcat e shpërndara pluskuese të pluhurit." [Furkan: 23]

Kushti i shtatë: Dashuria [mehebbah] ndaj kësaj fjale dhe domethënies së saj. Kjo përfshin dashuri ndaj atij që e ka shpallur këtë fjalë dhe urdhëroi që ajo të realizohet. Kjo po ashtu përfshin dashuri ndaj atij që thërret në këtë fjalë nga të dërguarit, pejgamberët dhe ata që trashëguan da'uen e tyre. Pra kushdo që e do këtë fjalë dhe i do ata që urdhërojnë në këtë fjalë dhe e do domethënien e saj dhe atë që ajo paraqet, ai është musliman i vërtetë.

22. *Duhrije* janë një sekt që mohojnë Rububijetin [Zotërimin]. Ata bëjnë dredhira në lidhje me urdhërimin dhe ndalimin, dhe ata mohuan mundësinë e shpalljes [së librave]. Ata muk e pranojnë ndëshkimin dhe nuk e njohin hallallin [të lejuarën] dhe haramin [të ndaluarën]. Dhe ata nuk pranojnë asnjë dëshmi në gjithë botën që tregon në atë se ka prodhues dhe diçka të prodhuar, e as që e pranojnë se ka Krijues dhe krijim. I Lartësuar është Allahu mbi çdo gojosje, dhe na ruajt Ai nga pavërtetësia nëpërmjet mëshirës së Tij. Referoju Aka'iduth-Thealthe ues-Seb'in Firkeh [2/767], el-Munteken-Nefis [f. 67] dhe Ighathetul-Lehfan [f. 612].

23. *Tebai'jin* [natyralistët] janë ata që pohojnë se universi vazhdon të ekzistojë prej natyre. Kështu që ai del në ekzistencë dhe shkon në mosqenie vetvetiu. Ai nuk ka ndonjë Zot që do ta drejtonte atë. Ai lind vetvetiu ndërsa toka përbin gjërat. Këto grupe përfshijnë shumicën e madhe të filozofëve: *Duhrije* dhe natyralistët. Referoju Me'arixhul-Kubul [2/776] dhe el-Munteken-Nefis [f.70].

24. Marksizmi zuri fill me Karl Marks [1818-1883]. Ai ishte një filozof Gjerman, një socialist dhe revolucionar ambicioz. Ai ishte themeluesi dhe udhëheqësi i lëvizjeve të mëdha e të forta: Komunizmit Demokratik [dmth socializmit] dhe Komunizmit revolucionar. Referoju el-Meusu'etul-Arabije [22/66] për konspekt.

Dhe kushdo që e urren atë dhe i urren ata që kanë ardhur me të dhe nuk vepron sipas domethënies dhe asaj çka ajo paraqet, atëherë ky nuk është nga mesi i muslimanëve në çfarëdo qoftë. Dhe e kundërta e dashurisë [mehebbah] është urrejtja [bughd].

Unë do t'i përsërisë shtatë kushtet²⁵ në një mënyrë të përgjithshme, për t'i mësuar ato përmendsh më lehtë:

[1] Dituria (Ilm)

[2] Bindja (jekiin)

[3] Pranimi (kubul)

[4] Nënshtrimi (inkijad)

[5] Vërtetësia (sidk)

[6] Sinqeriteti (ihlas)

[7] Dashuria (mehebbah)

Të drejtat dhe kushtet paraprake të La ilahe ilAllah

Përsa i përket të drejtave dhe kushteve paraprake të La ilahe ilAllah, kjo përfshin të gjitha detyrimet Sheriatike nga detyrat e obligueshme që Allahu ka urdhëruar të respektohen. Sipas kësaj duhet me doemos të veprohet. Dhe këto përfshijnë të qenit larg çështjeve të ndaluara dhe bërjen e veprave të rekomanduara. E tërë kjo plotëson La ilahe ilAllah dhe dëshmon për vërtetësinë dhe dashurinë e atij që e thotë këtë."

25. Është thënë se ekziston edhe kushti i tetë po ashtu, e që shejh Zejd el-Madkhali i ka thurur në poezi me thënien e tij,

'Kushtet e saja janë tetë siç vijon;

Dituria dhe bindja, sinqeriteti dhe qëllimi;

E katërta është vërtetësia pasuar nga i pesti;

E që kjo është nënshtrimi ndërsa pranimi është i gjashti

I shtati është dashuria dhe domethënia e saj.

Kështu që ata e bëjnë atë që i forcon.

Dhe i teti është urrejtja për çfarëdo që adhurohet përveç Allahut

Pra, kuptoju këto, o njeri inteligjent.'

Mësimi i tretë

Lavdi i takon Allahut dhe paqja dhe përhëndetjet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij dhe shoqëruesit e tij si dhe këdo që identifikohet me të. Më tej:

Në mësimin e fundit ne e ndërpreme tek thënia e autorit – rahimehullah, “Dije – Allahu ju mëshiroftë – se është detyrim për çdo musliman, qoftë mashkull ose femër, që t’i mësojë këto tre çështje dhe të veprojë sipas tyre. E para është se Allahu na krijoi, na furnizoi dhe nuk na ka braktisur. Më saktë, ai na e dërgoi një lajmëtar. Kështu që kushdo që i bindet atij, hyn në parajsë; dhe kushdo e kundërshton atë, hyn në Zjarr.”

Dobi në lidhje me fjalën, ‘Dije [se]’

Në thënien e autorit – rahimehullah, ‘Dije [se],’ gjendet një njoftim, udhëzim dhe orientim për kërkuesin e diturisë për të anuar ndaj temave të saja dhe për t’i kushtuar rëndësi çështjeve të saja. Pra, dituria është gjëja më e mirë për t’i kushtuar rëndësi dhe gjëja më e mirë për zemrën dhe gjymtyrët që të anojnë ndaj saj. Është gjëja më e mirë për t’u kuptuar në kontekstin e saj të drejtë. Më pas, njeriu duhet veprojë sipas kësaj diturie, meqë kjo është fryti i diturisë.

Vijimi i njoftimit me lutje

Dhe deklarata e tij, ‘Allahu ju mëshiroftë,’ është njoftim për çdo lexues dhe dëgjues. Në përgjithësi, kjo është dëshmi për këshillën dhe sinqeritetin e autorit ndaj vëllezërve dhe besimtarëve muslimanë, meqë ai u lut për ta para përmendjes së çështjeve të rëndësishme me qëllim që ata t’i mësojnë këto çështje, që t’u kushtohet atyre vëmendje dhe të veprohet sipas kërkesave të tyre. Dijetarët e Selefit përshkuan këtë shteg të të kapurit të vëmendjes së dëgjuesit dhe lexuesit duke u lutur për ta sinqerisht në direktivat e tyre për shkrim, të folur dhe instruksione të ndershme.

Më pas ai shpjegoi se këto tre çështje janë prej fundamenteve të Islamit dhe parimeve të imanit. Është detyrim për çdo musliman, qoftë mashkull apo femër, që t’i mësojë ato, t’i kuptojë ato me një të kuptuar të shëndoshë dhe të veprojë në pajtim me kërkesat e tyre. Pra, autori përmbledhi këto tre çështje nëpërmjet shqyrtimit dhe studimit të kujdesshëm të tekstit të Librit dhe Sunetit.

Çështja e parë është se 'Allahu na krijoi, na furnizoi dhe nuk na ka braktisur' dhe shpjegimi i saj

Më pas ai nisi t'i shpjegojë këto çështje. Kështu që ai nisi me çështjen e parë, e kjo është, "Allahu na krijoi, na furnizoi dhe nuk na ka braktisur. Më saktë, ai na e dërgoi një lajmëtar. Kushdo që i bindet atij, hyn në parajsë; kushdo që e kundërshton, atë hyn në Zjarr."

Dëshmitë për këtë çështje janë vërtetuar qartë në Libër dhe Sunnet. Allahu krijoi krijimin në grupe dhe lloje të ndryshme të tyre. Kjo është pohuar haptas në ajetet e qarta. Prej tyre është thënia e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar,

"Allahu është Krijues i çdo gjëje dhe Ai është përgjegjës për çdo gjë." [Zumer: 62]

Dhe prej tyre është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Ai ka krijuar çdo gjë dhe e ka matur atë saktësisht sipas masave të duhura."
[Furkan:2]

Po ashtu është edhe thënia e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar,

"I Bekuar është Ai, në Dorën e të cilit është mbretëria. Ai ka mundësi për çdo gjë. Është Ai i cili krijoi jetën dhe vdekjen që t'ju sprovonë se cili prej jush është më bamirës. Dhe Ai është i Plotfuqishëm, që fal shumë." [Mulk: 1-2]

Dhe prej kësaj është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Lexo në emër të zotit tënd që ka krijuar. Ai e krijoi njerëzimin nga një droçkë."
[Alak:1-2]

Pra ekzistojnë ajete të shumta që dëshmojnë mirësinë, bekimin, shkëlqesinë dhe dashamirësinë e Allahut ndaj krijimit të Tij dhe sprovën e botës së krijuar që është obliguar, nga njerëzimi dhe xhinët. Dhe gjithashtu, Ai i ka krijuar ata, mu ashtu siç i ka furnizuar ata dhe askush nga krijimi i Tij, as nga bota e tokës, e as nga bota e qiejve nuk ka marrë pjesë me Të në krijim, riprodhim, furnizim dhe dhënie ndaj krijimit të Tij. Më saktë, ishte vetëm Ai i cili i krijoi ata, i riprodhoi ata dhe i forcoi ata me këtë.

"O njerëz! Çfarë ju bëri të shkujdesur ndaj Zotit tuaj, që është më Bujari? Është Ai i cili ju ka krijuar dhe ju ka dhënë formë të përkryer." [Infitar: 6-7]

"Lavdëro emrin e Zotit tënd të Lartësuar, i cili ka krijuar çdo gjë e më pas e ka bërë të jetë në harmoni me gjërat tjera, dhe i cili ka matur e më pas ka drejtuar." [A'la: 1-3]

Dhe Ai furnizon, kështu që Ai është *er-Rezzak*, Posedues i Fuqisë dhe Mundësisë. Ngjashëm, kjo është sqaruar në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishtëm,

"Vërtet, Allahu është Furnizuesi, Poseduesi i Fuqisë dhe Mundësisë." [Dharijat: 58]

Gjithashtu, është edhe një thënie e vërtetë e Allahut të Lavdëruar,

"Në qiej gjendet furnizimi juaj dhe çfarëdo që ju është premtuar." [Dharijat: 56]

Domethënë se shkak i furnizimit është shiu të cilin Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm e zbrit nga qielli në tokë. Pra, kjo bën që toka të dridhet dhe kjo e ndanë farën. Të gjitha grupet e ndryshme të krijimit hanë nga kjo, dhe kjo është nga përsosmëria, dhënia dhe furnizimi i Allahut. Askush tjetër, absolutisht, nuk merr pjesë në këtë. Gjithashtu, ai forcon nëpërmjet furnizimit, siç përmendet në shumë ajete. Dhe përse e tërë kjo përveç që i tërë Umeti të ngelë një Umet që është falënderues ndaj Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishtëm për dhënien dhe për pafundësinë e furnizimit të Tij. Siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm,

"Thuaj: Kush ju furnizon nga qielli dhe toka? Kush posedon të dëgjuarit dhe të parët? Dhe kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe kush e nxjerr të vdekurin nga i gjalli?" [Junus: 31]

Pra, me pak fjalë, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm ka krijuar krijimin, të drejtët dhe të pabindurit, besimtarët dhe mosbesimtarët, folësit dhe të heshturit, atë që është e pajetë dhe të gjallën. Allahu krijoi, furnizoi, ruajti, harmonizoi dhe i lehtësoi çështjet. Pra, Allahu e bëri tërë këtë të lehtë për sigurimin e Umetit. Qëllimi i menduar i Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar në tërë këtë, është ajo që Ai ka përmendur në thëniet e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishtëm,

"Unë nuk i kam krijuar Xhinët dhe njerëzimin për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj ndonjë furnizim prej tyre, e as që dua që ata të më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi, Poseduesi i Fuqisë dhe Mundësisë." [Dharijat: 56-58]

Allahu i krijoi ata në format më të mira dhe Ai i nderoi ata. Allahu i i nderoi fëmijët e Ademit me fisnikëri që s'mund të numërohen. Dhe, Ai u dha atyre forcë në këtë, siç qëndron në thënien e Allahut të Lartësuar,

"Vërtet, Ne i nderuam fëmijët e Ademit, dhe Ne i mbartëm ata në tokë dhe det dhe Ne i furnizuam ata me gjëra të mira e të lejueshme, dhe i kemi parapëlqyer ndaj atyre të cilët Ne i krijuam me përparësi të dukshme." [Isra: 70]

Atyre u është dhënë intelekti dhe ndjenjat me qëllim që t'i kuptojnë çështjet e dobishme. Pra, atyre u është dhënë dëgjimi që të dëgjojnë atë për të cilën kanë nevojë nga çështjet e lejueshme dhe detyrimet. Dhe me dëgjimin, ata dëgjuan [përfituan] diturinë, fjalën e

vërtetë dhe mirësinë. Pra, ata dëgjuan atë që kishin nevojë ta dëgjonin shprehur në udhëzim, dhe atë që i përmbush nevojat e tyre dhe marrëdhëniet e tyre shoqërore e familjare. Atyre u është dhënë të parët me të cilin ata panë atë për të cilën kishin nevojë. Atyre u është mundësuar shfrytëzimi dobiprurës i zemrave dhe intelektëve me çka ata e dalluan të dëmshmen dhe të dobishmen, të vërtetën dhe të gabuarën, të drejtën dhe të ligën. Kështu që krahas këtyre dhuratave, disa nga të cilat i tregova, Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar nuk i ka lënë ata pa ndonjë urdhër apo ndalesë. Dhe Ai nuk i ka lënë që të varen nga intelektet dhe ndjenjat e tyre. Më saktë, Ai u dërgoi lajmëtarë atyre duke filluar me Ademin [alejhimus-selam] gjer në përfundimin e porosive dhe detyrave të pejgamberllëkut me porosinë e pejgamberit tonë Muhamed [salallahu alejhi ue selam]. Allahu u shpalli Libra atyre, të cilat u qenë shpjeguar nga këta të Dërguar, dhe po ashtu edhe pejgamberët që erdhën pas tyre i shpjeguan ato. Kurse dijetarët e drejtë dhanë mësim, përkujtuan dhe mësuuan atë që sollën të dërguarit nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm. Me këtë, dëshmia është vendosur dhe është hequr arsyetimi, siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm,

"Të Dërguar si prurës të lajmeve të mira dhe si paralajmërues me qëllim që njerëzimi të mos ketë arsyetim tek Allahu pas të dërguarve. Dhe Allahu është i Plotfuqishëm, i Urtë." [Nisa: 165]

Pra, me porositë e të dërguarve dhe përhapjen e da'ues së tyre gjithandej krijimit është vendosur dëshmia, ndërsa arsyetimi është anuluar për ditën kur ata do të pyetën nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar në lidhje me atë me çka erdhën të dërguarit.

Dhe Allahu e ka caktuar kënaqësinë e Tij dhe parajsën në bindjen ndaj të dërguarve, ngase Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm i dërgoi ata që t'u bëhet respekt atyre, dhe u dha fund atyre me porosinë e pejgamberit tonë Muhamed [salallahu alejhi ue selam] ashtu që ata të respektohen. Pra, ai s'bën të kundërshtohet. Dhe unë e kam theksuar këtë me thënien e Allahut të Lavdëruar,

"Dhe Ne nuk dërguam lajmëtar vetëm se t'i bëhet respekt atij [nga njerëzit] me lejen e Allahut." [Nisa: 64]

Gjithashtu, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm ka thënë,

"Kushdo që i bindet Allahut dhe të dërguarit, ata do të jenë me ata që i ka favorizuar Allahu nga Pejgamberët, besnikët, dëshmorët dhe të drejtët." [Nisa: 69]

Pra, Ai i thirri ata me një thirrje elokuate, duke i urdhëruar ata që t'i binden Atij, t'i binden të dërguarit dhe t'u binden udhëheqësve muslimanë. Kështu që Allahu ka thënë,

"O ju që besoni! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të dërguarit dhe atyre që janë përgjegjës nga ju." [Nisa: 59]

Kështu Ai i udhëzoi ata nga mospajtimet dhe dallimet e tyre në kthimin tek Librit dhe Zoti i tyre dhe Suneti i pejgamberit të tyre [salallahu alejhi ue selam] pas vdekjes së tij,

"Nëse keni mospajtim ndërmjet vete për ndonjë gjë, referojani atë Allahut dhe të dërguarit të Tij nëse sinqerisht besoni në Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo është zgjidhja më e mirë dhe më e përshtatshme për vendimin përfundimtar." [Nisa: 59]

Dhe kushdo që e kundërshton të dërguarin do të hyjë në Zjarr. Allahu e ka shkruar hidhërimin, pakënaqësinë dhe urrejtjen e Tij për të dhe Ai do t'i shkaktojë atij një torturë të rëndë, ngase ai është që i ka bërë padrejtë vetes duke refuzuar atë me të cilën erdhën të dërguarit dhe ndjekin dëshirat, shejtanin dhe shpirtin që nxit në të këqija. Pra, këto janë tre llojet e së keqes dhe të thirrësve për në humbje. Kështu dëshirat i marrin banuesit e tyre për në Zjarr dhe në vendbanimin dëmtues – shpëtimi kërkohet prej Allahut.

Kurse shejtani është ashtu siç na ka informuar dhe paralajmëruar Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm në lidhje me të në thënien e Tij,

"O ju që besoni! Mos i ndiqni hapat e shejtanit. E kush i ndjek hapat e shejtanit, atëherë ai do ta urdhërojë atë në gjëra të turpshme dhe ligësi." [Nur: 21]

Kështu që Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm na ka informuar për shëmtinë e da'ues së shejtanit, që të na paralajmërojë kundër çdo akti të mosbindjes nga thëniet apo veprat, qoftë publik apo i fshehtë, për shkak të cilit robi mund të degjenerohet. Pra kjo është si rezultat i përgjigjes së tij ndaj thirrjes së shejtanit. Për shkak të rrezikut të kësaj, në Librin e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm ka ardhur një njoftim, udhëzim dhe direktivë, ashtu që Umeti të paralajmërohet kundër dëshirave dhe ndjekjes së shejtanit, dhe t'i paralajmërojë ata kundër përgjigjes ndaj kërkesave të shpirtit që urdhëron në të këqija në shumë ajete, siç gjendet në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm ndaj pejgamberit të tij [salallahu alejhi ue selam] dhe Ummeti i tij e ka ndjekur atë në këtë thënie,

"Nëse u bindesh shumicës që janë në tokë, ata do të të çorientojnë larg nga Rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin veçse supozim, dhe s'bëjnë gjë veçse gënjejnë." [En'am: 1116]

Dhe thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm,

"Mos iu bind dëshirës, meqë ajo do të të çorientojë nga Rruga e Allahut." [Saad: 26]

Po ashtu thënia e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar,

"A e ke parë atë që e ka marrë dëshirën e tij për zot? Dhe Allahu, duke e njohur atë si të tillë, e ka lënë atë të humbasë dhe ia ka vulosur dëgjimin dhe zemrën. Dhe Ai ka

vërë vello mbi sytë e tij, kështu që kush do ta udhëzojë atë pas Allahut? A s'do të përkujtoni pra?" [Xhathije: 23]

Njëlloj është edhe thënia e Allahut të Lavdëruar dhe të Lartësuar,

"Vërtet, shpirti urdhëron në të këqija, përveç atë që e mëshiron Allahu." [Jusuf: 53]

Allahu ka thënë në lidhje me realitetin e shejtanit dhe në paralajmërim kundër të ndjekurit atë dhe përfundimin e ndjekësit [të shejtanit],

"Vërtet, premtimi i Allahut është i vërtetë. Kështu që mos u mashtroni nga jeta e kësaj bote, e as mos lejoni që kreu i mashtruesve të ju mashtrojë lidhur me Allahun." [Llukman: 33]

"Vërtet, shejtani është armik i juaji, kështu që konsiderojeni atë si armik. Ai thërret për tek grupi i tij vetëm që ju të bëheni prej banorëve të Zjarrit." [Fatir: 6]

Gjithashtu, ekzistojnë thënie të përngjashme në Librin e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm.

Andaj, lumturia në të dy vendbanimet [jetën e kësaj bote dhe jetën e përtejme] është e kufizuar përbrenda bindjes ndaj Allahut dhe bindjes ndaj të dërguarit të Tij [alejhimus-salatu ues-selam] siç ka urdhëruar Allahu, ka shpjeguar dhe zbritur në Librat e Tija: Teurat [Tora], Ingjil [Bibla], Zebur [Psalmet] dhe Kur'an dhe shkrimet e shenjta të Musait dhe Ibrahimit. Dhe arsyeja për fatkeqësi dhe devijim është mosbindja ndaj të dërguarve, duke e refuzuar thirrjen e tyre dhe duke kundërshtuar Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar. Për shkak të kësaj, autori bëri dy deklarata të shkurtra lidhur me të drejtën e të dërguarve [salallahu alejhi ue selam], "Më saktë, Ai na dërgoi lajmëtar. Pra, kushdo që i bindet atij, ai do të hyjë në parajsë, dhe kushdo që e kundërshton atë do të hyjë në Zjarr."

Kështu që s'ka dyshim që çështjet e diturisë janë të përkrahura me dëshmi. Domethënë kur ndokush thotë, 'Kjo është e lejuar ndërsa kjo është e ndaluar; kjo është e vërteta ndërsa kjo është pavërtetësia; dhe ky është shtegu i udhëzimit kurse këto janë shtigje të humbjes.' Nuk ka dyshim se njeriu duhet të përftojë dëshmi për këtë nga dy burimet madhështore: Libri i pastër i Allahut dhe Suneti besnik i të dërguarit [salallahu alejhi ue selam]. Kështu që nga dëshmitë e përgjithshme që Allahu na e ka dërguar një lajmëtar, pikërisht ashtu siç u ka dërguar lajmëtarë edhe popujve të mëparshëm, është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Vërtet, Ne jua dërguam një lajmëtar që të jetë dëshmitar ndaj jush." [Muzemmil: 15]

Pra kjo e folme i adresohet Umetit të Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]. Dhe qëllimi i menduar këtu është: çdokush që ka qenë mbi faqen e dheut që prej dërgimit të

pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Të gjithë këta janë Umeti i Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]. Është e detyrueshme për ta që t'i binden atij [salallahu alejhi ue selam] dhe t'i nënshtrohen Sheriatit të pastër të tij. Dhe nuk ka arsytim për askë që të adhurojë Allahun me ndonjë Sheriat nga Shera'i [legjislacionet] e mëparshme pas dërgimit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Kështu thirrja e atij që pohon se është i lirë për t'i shkelur kufijtë e Sheriatit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], mu ashtu siç el-Hidr doli nga Sheriati i Musait [alejhis-selam], është e papranueshme.

Dëshmia për këtë është vendosur, dhe nga kjo është thënia e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar,

"Ne nuk të dërguam ndryshe përveç si mjaftueshmëri për njerëzimin, një prurës të lajmeve të mira dhe paralajmërues." [Sebe: 28]

Fjala '*nas*' [njerëzim] përfshin të gjithë njerëzit, nga Arabët dhe jo-Arabët. Ngjashëm është edhe fjala e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Thuaj: O ju që besoni! Unë jam i dërguar i Allahut te të gjithë ju." [A'raf: 158]

Pra në përmendjen e pejgamberëve dhe të dërguarve që Allahu ka dërguar, Ai nuk la jashtë Shera'i [legjislacionet] e mëparshme. Me saktë, ata e lanë këtë si trashëgimi, ngase Kur'ani vërteton të gjitha librat që erdhën para tij. Dhe porosia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] është e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse. S'është e lejueshme për askënd që të adhurojë Allahun me ndonjë gjë nga ajo të cilën e sollën pejgamberët e mëparshëm e që nuk gjindet në Sheriatin tonë fisnik, për shkak të plotësimit dhe përsosmërisë së kësaj feje.

"Sot, Unë jua kam përsosur fenë dhe e plotësova dhuntinë Time ndaj jush, dhe e kam zgjedhur Islamin për fe tuajën." [Ma'ideh: 3]

Ndërsa pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] e mbështeti këtë me thënien e tij, "Pasha Allahun, nuk ka asnjë nga ky popull që dëgjon për mua, qoftë ai Çifut apo i Krishterë, e që vdes ndërsa nuk ka besuar në atë me çfarë kam ardhur unë, përveç se do të jetë nga njerëzit e zjarrit."²⁶

26. Transmetuar nga Muslimi [1/134], referoju Silsiletul-Ahadithus-Sahihah [nr. 185] të Imam el-Albanit.

Përgënjeshttrim i pohimit se porosia e Muhamedit që vetëm për Meken dhe qytetet e saja të afërta

Prandaj, dëshmia është vendosur ashtu siç e përmenda pak më parë, se Umeti i Muhamedit përfshin çdonjërin i cili ka qenë mbi sipërfaqen e planetit që prej dërgimit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], qoftë ai nga Arabët apo jo-Arabët. Pra ky është ai të cilit i është adresuar, që është obliguar dhe që është i përgjegjshëm për porosinë e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Vërtet, ai ishte dërguar kur kishte mbushur dyzet vjet, dhe historia e tij është e mirënjohur dhe e famshme në librat e historisë dhe biografisë. Kjo s'është mohuar, përveç nga të lodhshmit prej Çifutëve apo të Krishterëve, apo nga njerëzit e shtrembërimit [tehrif], apo nga të shkujdesurit, nga tepria apo neveria, dhe ekstremizmi në lidhje me të dërguarit dhe pejgamberët e tyre. Ata thanë, 'Vërtet, ne jemi njerëzit e legjislacionit të lashtë. Pra, ne jemi në Sheriat. Kështu që kushdo nga ata që dëshmon për faktin se pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] është lajmëtar i dërguar, atëherë ata i thonë atij, 'Ai u është dërguar vetëm Arabëve.' Dhe ata kërkojnë dëshmi me anë të dyshimit, të cilin e sjellin nga Kur'ani, dhe pohojnë se kjo përbën dëshminë. Kështu ata e përdorin thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Që ju të paralajmëroni Nënë e Qyteteve [Meken] dhe të gjithë ata përreth saj."

[En'am: 92]

Pra, ata thonë se porosia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] ishte vetëm për njerëzit e Mekes dhe qyteteve në fqinjësi të saj. Përsa i përket asaj që e tejkalon këtë, atëherë njerëzit janë ndjekës të porosive të lashta, siç është Teurati [Tora] dhe Ingjili [Bibla]. Dhe ata gënjyen në lidhje me këtë, ngase Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e përfundoi porosinë dhe detyrat e pejgamberllëkut me porosinë e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], dhe Ai i përfundoi Librat e shpallura me Furkanin [kriterin, dmth Kur'anin] pas të cilit nuk ka libër tjetër. Dhe nuk ka të dërguar pas Muhamedit. Pra, ai është i fundit nga pejgamberët dhe të dërguarit. Kështu që s'është në rregull asnjëri nga robërit e Allahut, gjersa ata të kufizohen në Sheriatin fisnik. Andaj, i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] është dëshmitar ndaj Umetit të tij. Vërtet, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm shpjegoi këtë dëshmi dhe kjo do të realizohet në Ditën e Gjykimit. Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar ka thënë,

"E, si do të jetë atëherë, kur Ne të sjellim dëshmitar ndaj çdo populli dhe kur Ne të sjellim ty [O Muhamed] si dëshmitar ndaj këtyre." [Nisa: 41]

Vërtet, është shpallur e vërtetë në Sunen dhe në Musned të Imam Ahmedit²⁷ se në Ditën e Gjykimit Allahu do t'i tubojë popujt e mëhershëm dhe të mëvonshëm. Dhe, Nuhu [alejhis-selam] do të thirret dhe do të pyetet, 'A ua ke kumtuar porosinë popullit tënd?' Ai do të thotë, 'Po, unë ua kam kumtuar porosinë atyre.' Kështu që popullit të tij do t'i thuhet, 'A jua ka kumtuar Nuhu porosinë?' Ata do të thonë, 'Askush nuk na ka paralajmëruar.' Nuhut do t'i thuhet, 'Kush do të dëshmojë për ty?' Nuhu do të thotë,

'Muhamedi dhe Umeti i tij.' Kështu që Umeti i Muhamedi do të sillen si dëshmitarë ndaj popullit të Nuhut, duke dëshmuar se Nuhu në fakt u erdhi atyre, i thirri ata, i paralajmëroi, i porositi dhe i thirri ata fshehurazi dhe publikisht, gjatë ditës dhe natës. Kështu populli i Nuhut do të nënshtrohet dhe do të merren në llogari për mëkatet e tyre. Pra kjo është në pajtim me urtësinë, përsosmërinë dhe drejtësinë e Allahut. Atëherë, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] do të dëshmojë ndaj këtij Umeti, duke dëshmuar se ai ua ka kumtuar atyre porosinë.²⁸

27. Ai është Imami, dijetari, dëshmia, ai që është ekspert me aftësi të mëdha, Hafidhi, Ebu Abdullah Imam Ahmed Ibn Muhamed Ibn Hanbel esh-Shejbeni. Ai ka shumë punime madhështore, prej të cilave më i njohuri është Musnedi i tij. Ai është lindur në vitin 164H, dhe vdiq në vitin 241H.

28. Formulimi i këtij hadithi është siç vijon: Nga Ebi Se'id i cili tha, i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] ka thënë, "Nuhu dhe Umeti i tij do të sillen. Kështu që Allahu i Lartësuar do të thotë, "A e ke kumtuar porosinë?" Ai do të thotë, "Po, o Zot." Kështu që Umetit të tij do t'i thuhet, "A jua ka kumtuar porosinë ai?" Ata do të thonë, "Askush nuk na erdhi si pejgamber." Nuhut do t'i thuhet, "Kush do të dëshmojë për ty?" Ai do të thotë, "Muhamedi [salallahu alejhi ue selam] dhe ky Umet." Kështu që Umeti i Muhamedit do të dëshmojë se ai në të vërtetë ua ka kumtuar porosinë atyre. Dhe kjo përshkruhet në thënien e Allahut, dhe sa madhështore është përmendja e Tij,

"Ngjashëm, Ne ju bëmë një Umet të drejtë, ashtu që të jeni dëshmitarë ndaj njerëzve."

Transmetuar nga Ahmed [3/22], el-Buhari [nr. 3339] dhe et-Tirmidhi [nr. 4284].

Për sa i përket dëshmisë së Umetit të Muhamedit, Umetit që i është përgjigjur thirrjes, njerëzve që kanë iman në Kur'an, ata në dëshminë e tyre u mbështetën në atë që është ardhur në Librin e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm, të cilin ata e lexuan dhe e kënduan në çdo kohë dhe moment. Kështu që një thënie e përgjithshme në lidhje me këtë është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm,

"Vërtet, Ne e kemi dërguar Nuhun tek njerëzit e tij, ashtu që ti të paralajmërosh popullin tënd para se t'i zë në befasi një ndëshkim i rëndë. Ai tha: O njerëz! Vërtet, unë jam një paralajmërues i qartë për ju, që ju të adhuronit Allahun, ta keni frikë Atë dhe t'i bindeni Atij." [Nuh: 1-3]

Vërtet, ata u mbështetën në fjalët e Zotit të tyre dhe ata do të dëshmojnë çiltërsisht. Dhe pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] do të dëshmojë ndaj Umetit të tij, duke dëshmuar se ai ua ka kumtuar porosinë atyre, dhe dëshmia e tij mjafton si e vërtetë dhe realitet.

Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm e ka informuar Umetin e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam] se dërgimi i lajmëtarëve dhe zbritja e librave tek popujt është një Sunet lidhur me robërit që është vendosur dhe i vazhdueshëm, kështu që atyre nuk u është lënë ndonjë argument kundër Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm. Allahu ka thënë,

"Gjithashtu, Ne i dërguam një lajmëtar Firaunit." [Muzemmil: 15]

Dhe ai ishte Musai [alejhis-selam]. Vërtet, ai e thirri Firaunin dhe popullin e tij. Ai i thirri ata, i përkujtoi për Allahun dhe u dëshmoi atyre se Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm është Krijuesi dhe Furnizuesi i tyre. Kështu që Ai është i cili meriton të adhurohet, dhe Ai është el-Alij [më i Larti] el-A'la [i Lartësuar]. Pra, Firauni shfaqti mendjemadhësi dhe ua keqinterpretoi veten e tij popullit duke thënë atë çka Allahu shpalli lidhur me të,

"O ju pari! Unë nuk njoh për ju ndonjë Ilah [perëndi] tjetër pos meje." [Kisas: 38]

Ngjashëm, është edhe thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"E ai tha: Unë jam Zoti juaj, më i Larti." [Naziat: 24]

Kështu Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm shpjegoi se Ai i ka dërguar atij lajmëtar. Pra, Firauni kundërshtoi të dërguarin. Dhe ai u ndëshkua në atë kohë dhe do të ndëshkohet në të ardhmen. Kështu ndodh Suneti i Allahut në mesin e popujve që janë të pabindur; ata ndëshkohen në jetën e kësaj bote, në berzekh [ndërkohë; intervali mes jetës së kësaj bote dhe jetës së përtejme] dhe në jetën e përtejme sipas krimeve dhe sipas kundërshtimit dhe mosbindjes.

"Dhe Zoti yt nuk i bën padrejtë askujt." [Kehf: 49]

Vërtet, ndëshkimi që u bëhet atyre më shpejt, pasohet nga ndëshkimi që do ta pranojnë më vonë. Kështu që ndëshkimi i së ardhmes do të ndodhë kur Allahu ua shtyn afatin mëkatarëve të pabindur dhe i jep atij të mirat e veta dhe e lejon atë që të fitojë pasuri, siguri, dhe i lejon atij që të qëndrojë në një gjendje në të cilën ai vazhdimisht e shton mosbindjen e tij ndaj Allahut. Kjo ndodh për shkak të parëndësisë së kësaj bote tek Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm, dhe më pas personi vdes në mosbindje ndaj Allahut. Më pas do të jetë një ditë kur ai do të kthehet tek Allahu. Këtu asnjërit nga mesi i njerëzve s'do t'i hiqet sikleti përveç atyre që janë besnikë, dhe askush s'do të ndalohet përveç tiranëve dhe shkelësve nga mesi i tyre.

Vërtet, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë lidhur me këtë domethënie,

"E tillë është kapja e Zotit tënd kur Ai kap [popullatën] qytetet ndërsa ata janë duke bërë padrejtësi. Vërtet, kapja e tij është e dhimbshme dhe e ashpër." [Hud: 102]

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë, "Allahu i jep tiranit sundim skajshmërisht të gjatë, kështu që kur ta kapë atë, atij nuk i mbetet ndonjë arsytim."²⁹ Pra kjo është një shprehje që tregon ashpërsinë e ndëshkimit dhe fuqinë e Kapjes.

"Kapja e Zotit tënd është e ashpër." [Buruxh: 12]

Për shkak të kësaj, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm tha,

"Firauni e kundërshtoi të dërguarin, kështu që Ne e ndaluan atë me një torturë të rëndë." [Muzemmil: 16]

Domethënë kjo ishte tejet e ashpër, që mbërrin kufijtë maksimalë të ashpërsisë. Kjo është një njoftim për Umetin e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam], që ata të qëndrojnë sa ma larg veprave të Firaunit dhe njerëzve të tij, dhe që ata të pranojnë bindjen ndaj pejgamberit të tyre [salallahu alejhi ue selam] ngase Allahu i informoi ata se Suneti i Tij është fort i vendosur në të vërtetën. Kur Allahu dërgon një lajmëtar, është e detyrueshme për njerëzit që ta ndjekin atë dhe t'i binden atij. Pra, kushdo që i bindet atij, do të hyjë në parajsë; dhe kushdo që e kundërshton atë, do të hyjë në Zjarr.

29. Që të plotësohet ky hadith, ai më pas lexoi ajetin, "E tillë është kapja e Zotit tënd kur Ai kap [popullatën] qytetet ndërsa ata janë duke bërë padrejtësi. Vërtet, kapja e tij është e dhimbshme dhe e ashpër." [Hud: 102] Është transmetuar nga el-Buhari [2/243] nga Ebi Musa [radiallahu anhu].

Çështja e dytë është se 'Allahu s'është i kënaqur që të shoqërohet ndokush me të në adhurim' dhe shpjegimi i kësaj

Ka thënë shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Dhe çështja është se Allahu s'është i kënaqur që të shoqërohet ndokush me të në adhurim, as ndonjë engjëll pranë tij, e as ndonjë pejgamber që dërgohet. Dhe dëshmi për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Dhe xhamitë janë për Allahun, kështu që mos lutni askënd tjetër krahas Tij." [Xhin: 18]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, 'Pra në realitet, Allahu është ai që ka krijuar robërit dhe i ka furnizuar ata. Ai është i cili qeverisë me njerëzit dhe i rregullon çështjet e tyre. Allahu s'është i kënaqur që t'i shoqërohet ndokush në adhurim. Dhe el-ibadeh [adhurimi] është emër i përgjithshëm për çdo gjë që Allahu do dhe me të cilën është i kënaqur, nga thëniet dhe veprat, qofshin ato të bëra publikisht apo fshehurazi.³⁰ Pra, kushdo që ia drejton ndonjë akt adhurimi tjetërkujt pos Allahut, ai ka bërë Shirk të madh [Shirk Ekber]; kushdo që shoqëron tjetërkënd krahas Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, ai ka bërë Shirk të madh.

Sqarimi i rrezikut të Shirkut

Andaj, të gjitha veprat e adhurimit dhe veprat e bëra për t'iu afruar më shumë Allahut, siç është *isti'aneh* [të kërkuarit mbrojtje], *istighatheh* [kërkim shpëtimi], kurhani, bërja e betimit, *regbeh* [dëshira e zjarrtë], *rehbeh* [tmerri], *khushu* [përlulja], *khashjeh* [frikë e përzier me nderim], *inabeh* [kthimi me pendim], *teuekul* [mbështetja në Allahun], *rexhaa* [shpresa] dhe *khauf* [frika].

30: Shënim: Ka thënë shejhul-Islam Ibn Tejmije [v.728H] – rahimehullah, 'Adhurim [el-Ibadeh] është bindja ndaj Allahut duke ndjekur atë që Ai ka urdhëruar në gjuhën e të dërguarit të tij." Ai po ashtu tha, "Adhurim [el-Ibadeh] është term gjithpërfshirës që mbulon çdo gjë që Allahu do dhe më të cilën është i kënaqur – qoftë kjo thënie apo vepër, e jashtme apo e brendshme." Referoju Muxhmu ul-Fetaua [10/149]. Tha Imam Ibnul-Kajjim [v.751H] – rahimehullah, "Adhurimi vërtitet rreth pesëmbëdhjetë parimeve. Kushdo që i plotëson ato, ai ka plotësuar stadet e ubudijes [robërimit ndaj Allahut]. Shpjegimi i kësaj është se ibadeh ndahet mes zemrës, gjuhës dhe gjymtyrëve. Dhe për secilën nga këto vlej në pesë lloje të rregullave, që mbulojnë të gjitha veprat: uaxhib [detyrim], mustehab [e rekomanduar], haram [e ndaluar], mekruh [mospëlqim], dhe mubah [e lejuar]. Referoju Medarixhus-Salikin [1/109]. Tha Imam el-Kurtubi [v.671H] – rahimehullah, "Rrënja e ibadeh është përlulja dhe nënshtrimi. Detyrat e ndryshme që janë parashkruar për njerëzit quhen ibadat [akte të adhurimit], meqë ajo që kërkohet është që këto akte të adhurimit duhet të bëhen me përlulje dhe nënshtrim ndaj Allahut – më të Lartit." Referoju el-Xhami li-Ahkamil-Kur'an [1/225] dhe [17/56]. Tha el-Hafidh Ibn Kethir [v.774H] – rahimehullah, "Dhe Ibadeh është bindja ndaj Allahut duke vepruar sipas asaj që Ai ka urdhëruar, dhe duke e lënë atë që Ai ndalon; dhe ky është realiteti dhe esenca e Islamit. Domethënia e Islamit është: istislam [nënshtrim dhe dorëzim] ndaj Allahut – më të Lartit – së bashku me pajtimin maksimal, nënshtrimin, dhe përluljen ndaj Tij." Referoju Tefsirul-Kur'anil-Adhim [7/402]. Dhe po ashtu tha, "Vërtet Allahu – më i Larti – krijoi krijimin ashtu që ata të mund të adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar Atij ndonjë ortak. Kushdo që i bindet Atij do të shpërblehet plotësisht, ndërsa kushdo që e kundërshton Atë do të dënohet me një ndëshkim të rëndë. Dhe Ai na ka informuar se Ai s'është as i varur, e as që ka ndonjë nevojë për ta. Më saktë, janë ata të cilët kanë nevojë të skajshme për Të, në çdo rrethanë dhe gjendje, meqë Ai është i cili krijon, furnizon, dhe kujdeset për ta."

E tërë kjo është prej veprave të adhurimit, të cilat s'bën t'i drejtohen tjetërkujt pos Allahut. Dhe s'është e lejueshme që të vendoset ndonjë ortak krahas Allahut, ngase Allahu s'është i kënaqur me këtë. Dhe Shirku i madh është një mëkat me të cilin kundërshtohet Allahu, dhe është mëkat të cilin Allahu nuk e fal, e as që e meritojnë ndërmjetësimin njerëzit e tij [Shirkut]. Ata thjesht janë prej njerëzve të Zjarrit, që do të banojnë aty përherë, ashtu siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm,

"Vërtet, Allahu nuk fal që t'i shoqërohen ortakë Atij, por Ai fal çfarëdo që është më pak se kjo cilitdo që Ai do." [Nisa: 116]

Domethënë, mos adhuroni kurrë tjetërkënd krahas Allahut: as engjëj që janë pranë, as të Dërguar fisnikë, as nga pejgamberët madhështorë, as nga të drejtët nga mesi i krijimit, as drunjte, as gurët, apo çfarëdo pos kësaj. Kjo është për faktin se çfarëdo akti i adhurimit i bërë për tjetër pos Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm është adhurim i tagutit.³¹

Muslimanët nuk janë larg prej rrezikut të Shirkut. Kështu që Shirku i madh dhe Shirku i vogël janë të rrezikshëm, si dhe Shirku i pakët dhe i shumtë. Pra nisur nga kjo bëhet e detyrueshme për muslimanët dhe për studentët e diturisë posaçërisht, që të shqyrtojnë tërë këtë në të gjitha çastet e jetës së tyre, kështu që veprat e tyre të mos ndyhen me Shirk ndaj Allahut. Dhe ata duhet ta shqyrtojnë gjendjet e njerëzve, dhe duhet të përpiqen fort që t'i mësojnë dhe t'i drejtojnë ata gjersa të mos mbetet asgjë nga llojet e ndryshme të Shirkut, ndryshe ata do të shkatërrohen. Vërtet, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] na informoi se ai kishte shumë frikë nga rënia e Umetit në Shirk kur tha, "Vërtet, ajo prej të cilës më së shumti kam frikë për ju është Shirku i vogël." Ata thanë, "Ç'është kjo?" Ai tha, "Kjo është *er-rija* [paraqitja sa për sy e faqe]." **32**

31. Shënim: Ka thënë Umer Ibnul-Khatab [radiallahu anhu], "Taguti është Shejtan." Transmetuar et-Taberi në Xhami'ul-Bejan en-Te'uulil-Kur'an [nr. 5834], el-Hafidh Ibn Haxher ka thënë në Fet'hul-Bari [8/251], "Zingjiri i tij i transmetimit është i fortë." Xhabir Ibn Abdullah [radiallahu anhu] ka thënë, "Tagutët janë fatthënësit dhe falltarët, të cilëve u zbresin shejtanët." Transmetohet nga et-Taberi në Tefsirin e tij [nr. 5845]. Imam Malik [v.179H] – rahimehullah – ka thënë, "Tagut: çdo gjë që adhurohet përveç Allahut." Transmetuar nga es-Sujuti në ed-Darul-Menthur [2/22], përmes Ibn Ebi Hatim. Imam Ibnul-Kajjim [v.175H] – rahimehullah – ka dhënë një definicion gjithëpërfshirës, ku tha, "Taguti është e gjithë ajo që e bën personin t'i tejkalojë kufijtë në lidhje me atë që adhurohet, ndjeket apo dëgjohet. Pra, taguti në çdo popull është kushdo që i kthehet tjetërkujt pos Allahut dhe të dërguarit të Tij në çështjet e gjykimit, apo që është i kënaqur që të adhurohet krahas Allahut, apo që ndjeket pa ndonjë dëshmi të qartë prej Allahut, apo që dëgjohet në atë që dihet se është mosbindje ndaj Allahut." Referoju Ilamul-Muwekki'in [1/53].
32. Transmetuar nga Imam Ahmedi [3/8] dhe [5/228-229] dhe et-Teberani [4/253]

Pra kjo është një kategori nga kategoritë e Shirkut. Kështu që s'ka dyshim se Teuhidi duhet të realizohet së jashtmi dhe së brendshmi, dhe duhet të ketë mohim të Shirkut dhe njerëzve të tij. Dhe njeriu duhet të shikojë në shpirtin e tij, kështu që asgjë nga llojet e ndryshme apo kategoritë e rrezikshme të Shirkut të mos hyjnë në të. Vërtet, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] qe pyetur, siç qëndron në hadithin e Abdullah Ibn Mes'udit kur ai i tha atij, "O i dërguar i Allahut! Cili është mëkati më i madh?" Ai tha, "Që të vendosësh dikë tjetër për adhurim krahas Allahut, ndërsa Ai është i cili të ka krijuar." **33** Kjo është për shkak të madhësisë dhe rrezikut të mëkatit të Shirkut për njerëzit.

Pra, Ne do të mjaftohemi më këto dy çështje gjer në mësimin e tjetër, nëse kështu do Allahu i Lartësuar. Dhe paqja qoftë mbi Muhamedin, familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij.

33. Transmetuar nga el-Buhari [nr. 6811] dhe en-Nesa'i [nr. 7125].

Mësimi i katërt

Lavdi i takon Allahut, dhe paqja dhe bekimet qofshin mbi të dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij, mbi Shoqëruesit e tij dhe të gjithë ata që janë të udhëzuar me udhëzimin e tij.

Paraprakisht ne mbuluam shpjegimin e dy çështjeve nga tre çështjet:

Çështja e parë: Kjo është thënia e autorit, 'Allahu na krijoi, na furnizoi dhe nuk na ka braktisur. Më saktë, ai na e dërgoi një lajmëtar. Pra kushdo që i bindet atij [salallahu alejhi ue selam] do të hyjë në parajsë, dhe kushdo e kundërshton atë do të hyjë në Zjarr.'

Çështja e dytë: 'Allahu s'është i kënaqur që të shoqërohet ndokush me të në adhurim; as ndonjë engjëll pranë Tij, e as ndonjë pejgamber që dërgohet,' dhe tjetër nga këto nga çështja e parë. Dhe ne u njohëm me domethënien e Shirkut, llojet e Shirkut dhe rrezikun e tij për Umetin. Po ashtu ne kuptuam se ekziston edhe Shirku i fshehtë [shirkul-khefi] së bashku me atë për çka robërit kanë nevojë në shqyrtimin e vetvetes, zemrave të tyre dhe veprave të tyre.

Tema e mësimi të sotshëm do të jetë:

Çështja e tretë, 'Kushdo që i bindet të dërguarit dhe e veçon Allahun; dhe shpjegimi i kësaj

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Çështja e dytë është se kushdo që i bindet të dërguarit dhe pohon Teuhidin e Allahut, s'është e lejueshme për të që të ketë besnikëri/miqësi me ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, edhe nëse ata janë njerëzit më të afërm të tij."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Pra shpjegimi i kësaj është se ndjekësit e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam] duan për hir të Allahut dhe urrejnë për hir të Allahut. Ky është një parim [ka'ideh] që njerëzit e së vërtetës, Ehlus-Suneh uel-Xhema'a – nga Selefus-Salihi ynë dhe ndjekësit e tyre e zbatojnë dhe me të cilin ndërveprojnë gjer në Ditën e Gjykimit. Çdonjëri që i bindet të dërguarit [salallahu alejhi ue selam] në çkado me të cilën ai erdhi nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm nga Libri dhe Suneti, dhe pohon Teuhidin e Allahut në Rububijetin [zotërimin] e Tij, Uluhijetin [hyjninë] e Tij, Emrat dhe Cilësitë [Esmat-ues-Sifat] e Tij dhe të gjitha veprat [ef'al] e Tij, atëherë s'është e lejueshme për të që të ketë ndonjë besnikëri/miqësi, dashuri apo marrëveshje me atë që kundërshton Allahun, Sheriatin e Tij fisnik dhe atë me çka erdhi i dërguari i Tij [salallahu alejhi ue selam], edhe nëse ai

është prej njerëzve më të afërm të tij.

Parimi i besnikërisë dhe armiqësisë dhe si është aplikuar kjo nga Sahabët [Shoqëruesit e të dërguarit salallahu alejhi ue selam]

Prej këtu bëhet e detyrueshme për kërkuesin e diturisë që të kuptojë realitetin e *el-uela uel-bera* [besnikërisë dhe armiqësisë]. Domethënë që të dihet se kë duhet dashur dhe më kë duhet pasur afri? Dhe po ashtu të dihet se mbi cilën çështje duhet të bazohen besnikëria dhe dashuria? Dhe, cilat janë arsytet për armiqësi, urrejtje dhe bojkotim? Këto çështje janë prej fundamenteve të akides [kredos]. Dhe pikërisht në këtë çdonjëri duhet t'i bindet pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe ta pohojë Teuhidin e Allahut në Rububijetin e Tij, Uluhijetin e Tij dhe Esma ues-Sifatet e Tij. Është e detyrueshme për të që të gjithë dashurinë, urrejtjen, besnikërinë dhe armiqësinë e tij ta bëjë për hir të Allahut. Kështu që pasi ta bëjë këtë, atëherë ai vërtetë ka kapur vend-kapjen e imanit [besimit]. Atëherë, vërtet, ai ka bërë besnikëri ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, e besnikëri nuk duhet të kihet ndaj ndokujt tjetër pos Tij.

Vërtet, Shoqëruesit e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] e mësuan parimin e *el-uela uel-bera*. Atëherë, ta dish se për kë ka qenë besnikëria dhe kujt duhet treguar armiqësi. Ata ndërvepruan me këtë parim. Kështu që biri kundërshtonte babanë dhe e luftonte atë nga që ai ishte armik i Allahut. Dhe disa nga ata dilnin dhe i luftonin birtë e tyre nga që ata ishin në tjetër pos menhexhit [metodologjisë] se Islamit. Kjo është njëra prej shkaqeve të njohura për shpalljen e këtij ajeti fisnik,

“Ju s’do të gjeni popull që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, e të kenë dashuri për ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij.” [Muxhadile: 22]

Kjo është shpallur në lidhje me Ebi Ubejde Amir Ibnul-Xherrah, i cili e mbyti babanë e vet për arsye se ai ishte mosbesimtar [kafir]. Dhe është shpallur në lidhje me Ebi Bekr, i cili e luftoi të birin nga që ai ishte kafir.³⁴

34. Ka thënë el-Kurtubi, Seid es-Sudi, ‘Kjo është shpallur në lidhje me Abdullah Ibn Abdullah Ibn Ubej [radiallahu anhu]. Ai u ul me pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] ndërsa pejgamberi pinte ujë. Ai i tha atij, “O i dërguar i Allahut, më lejo që t’i jap të pijë babait tim nga ajo që mbeti prej pijes sate. Ndoshta ai do ta pastrojë zemrën e tij me këtë.” Kështu që ai e mori dhe e erdhi tek ai me të [pijen]. Abdullahu i tha atij, “Ç’është kjo?” Ai tha, “Kjo është çfarë ka mbetur nga pija e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam]. Unë ta solla këtë që ta pish, ndoshta Allahu do ta pastrojë zemrën tënde me këtë.” Babai i tij i tha atij, “Po të ma sillje urinën e nënës sate, ajo do të ishte me e pastër për mua se kjo.” Kështu ai u hidhërua dhe shkoi tek pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] dhe tha, “O i dërguar i Allahut, a më lejon që ta mbys babanë tim?” Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha, “Jo, madje ji i butë me të dhe sillu mirë ndaj tij.” Kurse Ibnul-Xhurejxh tha, “Më është transmetuar se Eba Kuhafe e kishte fyer pejgamberin [salallahu alejhi ue selam], kështu që Ebu Bekr e rrahu atë gjersa ai u rrëzua me fytyrë në tokë. Më pas erdhi pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] dhe ai ia përmendi këtë. Kështu që ai tha, “Nëse ai ngulmon në këtë, mos vepro më kësioj me të.” E ai tha, “Pasha Atë që të dërgoi ty si pejgamber, po ta kisha pasur afër shpatën time në atë çast, do

ta kisha mbytur atë." Dhe Ibn Mes'ud tha, "Është shpallur në lidhje me Ebu Ubejde Ibnul-Xherrah. Ai e mbyti babanë e vet, Abdullah Ibnul-Xherrah, të Hënën, dhe thuhet se kjo ka ndodhur në ditën e Bedrit. Dhe el-Xherrah i rezistonte Ebi Ubejdes, ndërsa Ebi Ubejde anonte nga ai. Kështu që kur ai e shtoi armiqësinë ndaj Ebi Ubejdes, ai e mbyti atë. Kështu Allahu e shpalli këtë ajet kur ai mbyti babanë e tij, "Ju s' do të gjeni popull që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, e të kenë dashuri për ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij." [Muxhadile: 22] Dhe Maliku [v.179H] – rahimehullah – e përdori këtë ajet si dëshmi për armiqësinë ndaj Kaderive dhe bojkotimin e tubimeve të tyre. Ai tha: Unë them se domethënia e Kaderive është të gjithë njerëzit mëkatarë dhe armiqësorë." Kjo është transmetuar në el-Xhami li-Ahkamil-Kur'an [18/199], paksa e shkurtuar.

Kështu ata e realizonin pikënisjen e *el-uela uel-bera*. Allahu e shpalli një ajet në lidhje me këta dy dhe të ngjashmit me ta nga Kur'ani, i cili do të lexohet gjersa Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ta ngrejë atë nga gjokset dhe ta ngrejë atë nga toka.

Shkallët e besnikërisë dhe armiqësisë

Tema e *el-uera uel-bera* ka nevojë për një elaborim të mëtejshëm. Kështu që *el-uela* [besnikëria] ka shkallë të ndryshme sipas atij ndaj të cilit ushtrohet kjo besnikëri. Njëlloj edhe *el-bera* ka shkallë të ndryshme. Pra, kushdo që është në menhexhin e Selefus-Salihit në kredo, adhurim, ndërveprim, sjellje dhe marrëdhënie miqësore, dhe njëkohësisht është në vëllazërinë Islame, iman dhe *ihsan*, ai e meriton shkallën më të lartë dhe më të plotë të *el-uela* pas *uelas* ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam]. Pra kjo është domethënia e fjalës së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishtëm,

"Vërtet *ueli* [aleati] juaj është Allahu dhe i dërguari i Tij, dhe ata që besojnë, e falin namazin, e japin zekatin dhe ata janë që përkulen. Pra, kushdo që bën aleancë me Allahun, të dërguarin e Tij dhe ata që besojnë, atëherë, grupi i Allahut është fitimtar." [Ma'ideh: 56-57]

Kjo përfshin *uela* për hir të Allahut duke dashur dhe urryer për hir të Tij, dhe *uela* për të drejtën e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam] duke e dashur atë, duke zbatuar urdhrat e tij, duke u përmbajtur nga ndalimet e tij, duke e marrë atë për shembull dhe duke i dashur ndjekësit e tij gjer në Ditën e Gjykimit përgjithësisht me një dashuri e cila është miratuar nga Sheriati. Kjo është nga aktet e mira të adhurimit dhe nga shenjat, cilësitë dhe karakteristikat e veçanta të njerëzve të imanit, të cilët dallohen nga të tjerët për shkak të kësaj. Kushdo që është në shkallë më të ulët se kjo nga mesi i muslimanëve, ai meriton besnikëri për shkak të asaj çka posedon nga Islami, *imani* dhe *ihsani*. Dhe atë duhet urryer për shkak të asaj çka ai posedon nga mosbindja dhe mëkati.

Efektet e pafavorshme të Partishmërisë [Hizbijë] dhe organizatave sekrete ne studentët dhe diturinë

Dhe kushdo që është nga njerëzit e risive [bidateve] të çorientuara, me llojet e ndryshme të bidateve, e ato janë të shumta, dhe përderisa këto të jenë përbrenda fushës së Islamit dhe përgjithësisë së muslimanëve dhe bidati i tyre nuk i nxjerr ata nga Islami, atëherë këta duhet urryer sipas mosbindjes dhe bidatit të tyre. Dhe ata duhet braktisur, tubimet e tyre duhet bojkotuar dhe dituria s' duhet të merret prej tyre. Kjo bëhet sipas dobisë që përfitohet nga bojkotimi i tyre dhe qëndrimi larg tyre.³⁵ Pra, sa njerëz ka që janë me fitreh [prirje natyrore ndaj së mirës] të shëndoshë, të aftë për të bërë mirë, që kërkojnë të mirën, që synojnë korrëgjimin e vetvetes, e pastaj njerëzit e bidatit ushtrojnë ndikim mbi ta me llojet e tyre të ndryshme. Ata mund të jenë nga mesi i Xhehmive³⁶ që mohojnë Cilësitë e Allahut, apo Mu'tezile,³⁷ apo Esha'ireh³⁸ dhe ata që janë afër tyre, apo nga njerëzit e partishmërisë [hizbijes] dhe organizatave sekrete me xhematet [grupimet] e tyre të ndryshme, të cilat janë bërë të shumta dhe shatërvanët e tyre kanë ndryshuar. Të gjitha këta janë njerëz të bidatit. Kur ata ushtrojnë ndikim mbi kërkuesin e diturisë, ata i afrohen atij me anë të dashurisë, vëllazërisë, fitores për Islam dhe çfarëdo që i gjason kësaj. Ata e mashtrojnë atë gjersa ta kontrollojnë plotësisht. Më pas ata ia servojnë mësimet e tyre çorientuese pak nga pak gjersa të bëhet njëri prej tyre dhe ushtar nga mesi i ushtarëve të tyre në tjetër pos menhexhit të drejtë. Atëherë, ai lihet me vetëm këto bidate, paudhësi dhe shkaqe për fitan [sprova, fatkeqësi]. Kjo është e pranishme ndër radhët e partiakëve [hizbijunëve] në kategoritë e tyre të ndryshme dhe ndër aktivistët sipas emrave të ndryshëm të tyre.

Paralajmërim kundër mashtrimeve të Hizbijunëve [partiakëve]

Që këtë bëhet e detyrueshme që të këshillohen studentët e diturisë, që të kenë kujdes nga njerëzit e bidatit dhe t'i shmangen tubimeve të tyre, edhe nëse ata ju qasen juve me fjalë të buta dhe përpiqen që t'ju bëjnë mirë. Kështu që sipas akides dhe menhexhit të Selefrit, e cila detyron të kuptuarit e shëndoshë të Islamit, *imanit* dhe *ihسانit*, s'është e lejueshme që të dilet me ta e as që t'u bashkëngjitemi atyre.

35. Tha Imam Ismail Ibn Abdur-Rahman es-Sabuni [v.449H], "Ata [Selefi] shmangeshin nga njerëzit e bidatit dhe devijimit, dhe shfaqnin armiqësi ndaj njerëzve të dëshirave dhe injorancës. Dhe ata i përbuznin njerëzit e bidatit, të cilët risonin në këtë Fe atë që s'është prej saj. Ata nuk i donin ata, as nuk shoqëroheshin me ta, as nuk i dëgjonin fjalët e tyre, as nuk rrinin me ta, as nuk argumentonin me ta lidhur me Fenë, e as nuk debatonin me ta. Ata i ruanin veshët që mos t'i dëgjojnë pavërtetësitë e tyre, pasi e dinin se po kaloi ajo nëpër veshët e tyre dhe të hyjë zemrat e tyre, atëherë ajo do të dëmtonte dhe do të shkaktonte ligësi duke pëshpëritur dhe duke sjell rreziqe të mëdha."

Ai po ashtu tha, "Ata qenë dakord në mposhtjen dhe mbizotërimin e njerëzve të bidatit, duke i poshtëruar ata, duke i dënuar ata, duke qëndruar larg tyre, duke i larguar nga ata që shoqërohen me ta dhe u afrohen atyre. Dhe ata kërkonin afrimet ndaj Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisë duke qëndruar larg nga ata dhe duke i bojkotuar ata." Referoju Akidet-us-Selaf ue As'habul-Hadith [f.105, 113], paksa e shkurtuar.

36. Xhehmije janë ndjekësit e el-Xhehm Ibn Safuan. Ai ishte një xheberije. Bidati i tij u paraqit ne Tirmidh dhe ai u mbyt nga Selem Ibn Ehuez el-Mazini nga fundi i sundimit të Beni Umeje. Ata u pajtuan me Mu'tezilet në mospranimin e Cilësive të brendshme dhe ata i shtojnë disa gjëra tjera veç kësaj. Referoju el-Milel uen-Nihel [1/73].

37. Mu'tezile janë ndjekësit e Uesil Ibn Ataa el-Ghezal, i cili braktisi tubimet e el-Hasan el-Basrit. Ai besonte se ai që bën një mëkat të madh s'është as besimtar e as mosbesimtar, dhe pohoi një shkallë mes këtyre dy shkallëve. Kështu ai u dëbua, dhe i braktisi tubimet ndërsa ndjekësit e tij u bënë të njohur si Mu'tezile. Referoju el-Milel uen-Nihel [1/38].

38. Esharije është një sekt që qe themeluar nga Ebul-Hasan el-Esh'eri në pjesën e parë të çështjes së tij. Më pas, ai dalloj nga Mu'tezileh, e të mos e përmendim edhe atë që ai u pendua nga ky besim dhe u kthye në medhhebin e Selefite. Pika kryesore e referimit për ta është intelekti, dhe ata s'i pranojnë disa nga Cilësitë dhe bëjnë te'uil [shpjegim figurativ] për disa prej tyre [Cilësive]. Referoju el-Exhuibetus-Sedideh [4/53] të autorit.

Pra akideja yte është e shëndoshë dhe menhexhi yt është i vërtetë, të dyja këto janë më e rëndësishmja nga ajo që posedoni. Për të dyja këto ju jeni krijuar dhe kjo është rruga në të cilën ju e jepni mundin me fjalë të sinqertë dhe me penë, për të mbrojtur shtegun e qartë e të pastër të Sunetit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], të cilin njerëzit e bidatit e kanë ndotur me bidatet e tyre të ndryshme. Kjo pavarësisht se a janë ata nga njerëzit e sekteve të vjetra, apo nga njerëzit e bidateve moderne. Për këtë arsye ne e themi të vërtetën në lidhje me bidatçiun [mubtedi], dhe ai pëlqehet sipas asaj që ka nga Islami. Mirëpo, atë duhet urreyer, bojkotuar, tubimeve të tija duhet shmangur dhe komunikimi me të duhet të ndërpritet gjersa ai të mos e lë bidatin e tij në të cilin i thërret njerëzit. Kjo duhet të bëhet sipas dobisë dhe largimit të dëmit.

Grupet që ekzistojnë sot mbartin bidate të shumta, jo vetëm një

Vërtet, këto xhemate që janë të pranishme në skenë sot mbartin me vete bidate të shumta. Është detyrim që të flitet e vërteta dhe të bëhet sqarim dhe të mos fshihet asgjë. Ata nuk mbartin vetëm një bidat, ata mbartin një vistër bidatesh.

Organizatave e fshehta përbrenda shtetit musliman janë bidat

Pra organizatat sekrete në vendet muslimane janë bidat, dhe mbledhjet e fshehta në përjashtim të njerëzve të thjeshtë³⁹ ndërsa pohohet se janë tubime të përkujtimit dhe lexim diturie janë prej bidateve.

Bërja e njerëzve që të largohen nga shkencat Sheriatike

Njëlloj është edhe shkaktimi i neverisë ndaj shkencave Sheriatike, të cilat e ndërlidhin rininë e Umetit me Krijuesin e tyre [khalik] dhe Riprodhuesin [bari] e Lavdëruar, si dhe ndaj Sunetit të të dërguarit të tyre [salallahu alejhi ue selam], duke i bërë ata të

painteresuar për të dhe për mbrojtjen e tij.

Prezantim i Xhematut-Teblig dhe Ihuanëve

E gjithë kjo është prej bidateve në të cilat kanë rënë xhematet e sotshme, siç janë Ihuanije,⁴⁰ Tebligje⁴¹ dhe kushdo që e ndjek rrugën e tyre, përshkon shtegun e tyre dhe përvetëson menhexhin e tyre. Andaj ji syçelë ndaj të gjithë njerëzve të risisë [bidatit] që kanë lënë menhexhin e vërtetë për një menhexh që është sajuar së voni nga dikush që është injorant ndaj çështjeve. Dhe dëshmitë për injorancën e tyre ndaj çështjeve janë vendosur tashmë. Pra, themeluesit e këtyre grupeve ishin injorantë ndaj çështjeve.

39. Nga el-Euza'i [v.157H] i cili tha, 'Ka thënë Umer Ibn Abdul-Aziz [v.101H], "Kur të shihni njerëz duke diskutuar ndonjë çështje në përjashtim të njerëzve të thjeshtë, atëherë dije se ata janë në fundamentin e devijimit." Transmetuar nga ed-Darimi [1/103]

40. Ishte Xhematul-Ihuanil-Muslimun i cili ishte themeluar nga themeluesi i vet, Hasan Ibn Ahmed el-Bena. Ai u lind në vitin 1324H në Egjipt, dhe vdiq në vitin 1368H. Ai u edukua nga rendi i Sufive Hesafije. Ai u bëri bejen [zotimin e besnikërisë] atyre pranë Besjuni el-Abd, më pas pranë Abdul-Uehab el-Hesafi i cili ishte zëvendës kryetar i rendit. Hasan el-Bena vazhdimisht ishte i pranishëm në tubimet e tyre. Synimi i kësaj lëvizjeje ishte që t'i tërheq të gjithë muslimanët e Egjiptit pavarësisht metodologjive të ndryshme të tyre, qofshin ata në Selefizëm apo Sufizëm. Pra lëvizja njihje 'ed-Dauetus-Selefije,' 'Tarikatus-Sufije' dhe 'Hakikatus-Sufije.' Lëvizja donte të kombinonte përbrenda anëtarësisë së vet studentët e Fesë si dhe ata të jetës së kësaj bote. Ajo po ashtu pohonte të jetë një 'komitet politik,' një 'grup i devotshëm,' 'një bashkim i diturisë edukative,' një 'ndërmarrje ekonomike' dhe 'një ideologji e unifikuar.' Referoju Hakikatud-Da'ue ilAllahi Te'ala [f.76-77], deri diku i përshtatur.

41. Ky është një grup që është themeluar nga themeluesi i vet, Muhamed Ibn Iljas Ibn Muhamed Isma'il el-Kandehleui. Ai u lind në vitin 1302H, dhe vdiq në vitin 1363H. Ai ishte Deobandi në menhexh, Hanefi në medhheb, Eshari dhe Maturidi në akiden e tij dhe Sufi në tarikat. Xhematut-Teblig kanë gjashtë fundamente apo gjashtë cilësi; ato janë:

[1] Realizimi i fjalës së mirë: La ilahe ilAllah, Muhamedur-Rusulullah

[2] Të falurit e namazit me përpulje dhe nënshtrim

[3] Dituria – e virtyeteve, e jo e çështjeve aktuale – së bashku me përkujtim [dhikr]

[4] Nderimi i muslimanëve

[5] Përmirësimi i qëllimit

[6] Thirrja për tek Allahu dhe dalja [khuruxh] në rrugë të Allahut [sipas menhexhit të et-Teblig]

Mirëpo, këto gjashtë fundamente apo cilësi kanë një qëllim të paramenduar, një virtyt dhe një metodë të kufizuar të arritjes. Referoju Hakikatud-Da'ua ilallahi Te'ala [f.75,80], deri diku i përshtatur.

Udhëheqësit e këtij grupi nuk e aplikojnë parimin e besnikërisë [miqësisë] dhe armiqësisë

Pra nëse *el-uela uel-bera* është parim i imanit, disa nga udhëheqësit e këtij grupi nuk e aplikojnë çështjen e *el-uela uel-bera* në mënyrën e cila kërkohet nga Sheriati. Dhe do t'jua

sjell disa shembuj lidhur me këtë.

Shembulli për këtë dhe përgënjeshtrimi i së njëjtës

Njëri prej ithtarëve i këtij grupi⁴² ka sqaruar në njëren prej traktateve të tija se, “Rafidhat⁴³ janë vëllezërit e muslimanëve. Dhe nuk ka dallim mes nesh dhe atyre, përveç në çështjet anësore, siç është ndryshimi mes medhhebeve, që do të thotë katër Imamëve.”⁴⁴ Kjo është një analogji e çoroditur. Rafidhat janë të mirënjohur për kredon e tyre djallëzore, veprat e tyre të neveritura dhe sjelljen e tyre armiqësore. Veç çështjes së Shirkut që gjinden ndër ta, ata urrejnë Shoqëruesit e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], përveç një grupi të veçantë njerëzish. Që nga nisja, ata urrejnë, apo më saktë ata e mallkojnë Ebu Bekrin dhe Umerin [radiallahu anhuma]. Dhe të dy këta janë më të mirët nga ata, këmbët e të cilëve kanë shkelur në tokë pas të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam] sipas konsensusit [ixhmas] së Umetit Islam.

42. Shejhu – rahimehullah – i referohet themeluesit të grupit të njohur si Ihuanul-Muslimin.

43. Fjala ‘rafd’ domethënë braktisje. Dhe ata janë të cilët kanë refuzuar [jerfedun] udhëheqësinë e dy shejhëve: Ebi Bekr dhe Umer [radiallahu anhuma] dhe ata distancohen nga këta dy. Ata po ashtu i shajnë Shoqëruesit e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe i konsiderojnë fajtorë. Referoju Bedhelul-Mexhud fi Ithbat Mushabehetir-Rafideh lil-Jehud [1/85]

44. Referoju el-Exhuibetus-Sedideh alal-Es’iletir-Reshideh [5/43-44]

Kur themeluesi i Ihuanëve deklaroi se Rafidhat janë vëllezërit e ndjekësve të Sunetit, kjo ishte prej gabimeve më mizore dhe prej thënieve më të këqija. Kjo është shprehje që dëshmon injorancën e atij që thotë këtë në lidhje me menhexhin e Ehlu-Suneh uel-Xhema’a. Vërtet, ai vdiq – rahimehullah – dhe mbeti në atë që parapriu. Mirëpo, ata që e mbrojnë këtë menhexh, i cili është themeluar mbi të tilla parime, është e detyrueshme që të sqarohet gjendja e tyre, të bëhet paralajmërim kundër tyre dhe t’i shmangemi tubimeve të tyre ashtu që ata të mos kenë mundësi t’i helmojnë bijtë tanë, rininë tonë dhe vëllezërit tanë.

Një shembull tjetër dhe përgënjeshtrimi i tij [shembullit]

Gjithashtu, themeluesi i këtij grupi thotë, “Nuk ka armiqësi në lidhje me Fenë mes nesh dhe Çifutëve. Dallimi mes nesh bazohet vetëm në ekonomi.”⁴⁵ Kjo është nga thëniet më të këqija, ngase Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm haptas ka bërë të ditur që besimtarët duhet të kenë armiqësi ndaj Çifutëve dhe politeistëve [mushrikinë]. Në thënien e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar qëndron,

“Ju do të shihni se njerëzit më armiqësorë ndaj besimtarëve janë Çifutët dhe politeistët.” [Ma’ideh: 82]

Pra ai nuk e merr parasysh këtë ajet, përkundër qartësisë së tij, dallueshmërisë dhe urtësisë. Kjo tregon pasojën e diçkaje të rrezikshme. Gjithashtu, themeluesi i lartpërmendur ka hyrë në temën e el-Esma ues-Sifat [Emrave dhe Cilësive të Allahut]. Kështu që ai thotë, “Ne e kthejmë [tefuid]⁴⁶ çështjen e këtyre teksteve tek Allahu.”⁴⁷

45. Referoju librit, el-Ihuanul-Muslimun Sene’atut-Ta’rikh [f. 409]

46. Dobi – Sqarim i dyshimit të *Teufid*: Ka thënë Imam Muhamed Ibn Salih el-Uthejmin [v.1421H], “Akideja e Ehlus-Suneh uel-Xhema’a, ndërkaq, është e lirë nga *tehrif* [shtrembërimi] dhe *te’til* [mohimi]. Dhe me anë të kësaj ne e njohim devijimin apo rrenën e atyre që thonë, ‘Mënyra e Selefët është *tefuid*.’ Këta njerëz kanë devijuar nëse e kanë thënë këtë ndërsa nuk e kanë njohur mënyrën e Selefët. E nëse e kanë thënë këtë me dije, ata kanë gënjyer qëlimisht. Po ashtu mund të themi: Ata kanë gënjyer në dy mënyra: Në kuptimin e gjuhës së Hixhazit, pasi *kedhib* [rrena] për njerëzit e Hixhazit e ka kuptimin e *khata* [gabim]. Dhe në çfarëdo rrethane, s’ka dyshim se ata që thonë: Medhhebi i Ehlus-Suneh është *tefuid* – ata kanë gabuar ngase medhhebi [drejtimi] i Ehlus-Suneh është që të pohohet domethënia përveç bërjes së tefuid të *kefijeh* [si është, modalitetit] të tij.

Dhe le të dihet se të folurit me *tefuid* – siç ka thënë shejhul-Islam Ibn Tejmije [në Der’ut-Te’arudul-Akl uen-Nakl [1/121] – është ndër thëniet më të këqija të Ehlul-Bid’ah uel-Ilhad. Kur personi degjon në lidhje me *tefuid*, ai thotë, ‘Kjo është mirë, unë do të jem i sigurt nga këta njerëz dhe të tjerët, unë s’do të flas me medhhebin e Selefët e as që do të flas me medhhebin e atyre që bëjnë *te’uil* [komentim], unë do ta marrë rrugën e mesme dhe do të shpëtojë nga e gjithë kjo. Ndërsa unë them: Allahu e di më së miri, ne nuk e dimë se çfarë është domethënia e saj.’

Mirëpo, shejhul-Islam thotë, “Kjo është ndër thëniet më të këqija të Ehlul-Bid’ah uel-Ilhad.” Dhe ai – rahimehullah – e ka folur të vërtetën. Kur të reflektoni në këtë ju do të kuptoni se kjo detyron [këtë që vijon]: mohimin e Kur’anit, se i dërguari [salallahu alejhi ue selam] ka qenë injorant, dhe arrogancë në emër të njerëzve të filozofisë. Kjo është mohim i Kur’anit ngase Allahu thotë,

“Ne ta kemi shpallur Librin që është shpjegim për çdo çështje.” [Nehl: 89]

Ku është shpjegimi në fjalë, domethëniet e të cilit s’janë të njohura?! Dhe shumica e saj që është përmendur në Kur’an janë Emra të Allahut dhe Cilësive të Tij. Nëse nuk e dimë se çfarë janë domethëniet e saj, a s’është Kur’anit shpjegim për çdo gjë?! Ku është shpjegimi?! Këta njerëz thonë, ‘I dërguari [salallahu alejhi ue selam] nuk e njeh domethënien e Kur’anit në lidhje me atë që është treguar për Emrat dhe Cilësitë.’ Dhe kur i dërguari [salallahu alejhi ue selam] nuk e di, atëherë është më se e sigurt që tjerët veç tij nuk e dinë këtë. Më e çuditshme se kjo është kur ata thonë, ‘I dërguari [salallahu alejhi ue selam] flet në lidhje me Cilësitë e Allahut ndërsa nuk e di domethënien e tyre. Ai thotë, ‘O Allah, Zoti ynë që është mbi qiell,’ dhe kur Ai pyetet në lidhje me këtë, ai [salallahu alejhi ue selam] thotë, ‘Nuk e di!’ Dhe gjithashtu ne lidhje me thënien e tij, ‘Zoti ynë zbret në qiellin më të ulët...’ dhe kur ai pyetet në lidhje me domethënien e ‘Zoti ynë zbret,’ ai thotë, ‘Nuk e di.’ Dhe bazuar në këtë, e njëjta mund të thuhet për të gjitha Cilësitë tjera.

A ka fyerje më të madhe për të dërguarin [salallahu alejhi ue selam] se kjo? Kjo është ndër fyerjet më të mëdha. Një i dërguar prej Allahut që u është dërguar njerëzimit, megjithkëtë ai nuk e di domethënien e ajeteve rreth Cilësive dhe hadithet që u përkasin këtyre. Dhe ai flet me fjalë, domethënien e të cilave nuk e di. Kështu që kjo [dëmi i *tefuidit*] është nga dy aspekte – mohim i Kur’anit dhe përkrahimi i injorancës ndaj të dërguarit [salallahu alejhi ue selam].” Referoju Sherhul-Akidetil-Uesitije [1/100] të Ibnul-Uthejmin.

47. Referoju Risaletul-Aka’id [f.74-76]

Ai kundërshton Ehlul-Suneh uel-Xhema’a në këtë. Ehlul-Suneh nuk i kthejnë domethëniet [tek Allahu]. Mirëpo, ata i kthejnë *kefijjat* [se si është, mënyrën].

Domethënë, *kejfieh* [si, mënyra] e Cilësive të Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm duhet t'i kthehen [tefuid] Allahut. Përsa i përket domethënieve, ato janë të qarta dhe të kuptueshme nga që Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm na është adresuar me atë që ne e dimë dhe e kuptojmë. Dhe Allahu na ka urdhëruar që të reflektojmë mbi këtë Kur'an, nga çelja e tij deri në përfundimin e tij, ashtu që të kuptojmë domethënien e tij.

Shembulli i tretë dhe përgënjeshtrimi i kësaj

Njëlloj është ajo që ndërlidhet me detyrimin e *bej'eh* [zotimit të besnikërisë] që është në funksion në këtë menhexh [Ihuan]. Kështu që s'është e lejueshme që kjo të aplikohet, veçanërisht përbrenda shtetit musliman që ka institucionalizuar *bej'eh* në qafët e muslimanëve dhe ka zëvendës kryetarin, udhëheqësit dhe gjykatësit. Domethënë s'është e lejueshme që aty të ketë *bej'eh*, edhe nëse Ihuanul-Muslimun e quajnë atë *bej'eh* në drejtësi dhe devotshmëri. Pra, ky është realiteti. Përsa i përket prijësit të parë të Ihuanëve, atëherë ai pat thënë në fjalimin e tij, "Vërtet, shtyllat e *bej'eh* sonë janë dhjetë, kështu që mbani mend ato."⁴⁸ I këtillë është menhexhi që merret prej tyre.

48. Në Mexhmu'etur-Resa'ilil-Iman esh-Shehid Hasan el-Bena [f.7], "O vëllezër besnikë! Shtyllat e zotimit tonë janë dhjetë, kështu që mbani mend ato: sinqeriteti, vepra, xhihad, sqarimi, bindja, qëndrueshmëria, pavarësia, vëllazëria dhe besnikëria." Dhe referoju Risaletut-Te'alim li-Hasan el-Bena [f.3] dhe el-Medkhel li-Da'uetil-Ihuan li-Se'id Heuaa [f.30]

Shembulli i katërt dhe përgënjeshtrimi i kësaj

Gjithashtu ata nuk e kanë realizuar *el-uela uel-bera* për të cilën jemi duke folur në këtë mësim në lidhje me vëllazërinë dhe në shoqërim me Sufije [Sufizëm]⁴⁹, të cilët janë të devijuar dhe i humbin të tjerët. Vërtet, themeluesi i grupit el-Ihuan i ka lavdëruar ata tej mase. Ai ishte pjesë e një rendi [tarikati] Sufi të quajtur et-Tarikatul-Mireghnijeh. Kështu festimi i përvjetorit të një personi nga Tarikati, Muhamed Uthman el-Miraghni,⁵⁰ është regjistruar në dokumentet historike. Ai tha, "Vërtet, thirrja e Ihuanëve nuk e harron epërsinë e tyre. Da'ueja nuk qe vendosur, përveç mbi krijët e tyre dhe ajo nuk qe stabilizuar, përveç nëpërmjet përpjekjeve të Mireghnijeh."⁵¹ Ai i quajti ata shtyllat e Islamit dhe çështja tjera që provojnë injorancën e tij në lidhje me rrezikun e shtigjeve të Sufive, të cilat nuk kanë bazë në Librin e Allahut dhe Sunetin e peygamberit [salallahu alejhi ue selam]. Vërtet, referenca kryesore e tyre është vetëm nga *mukashfat* [zbulimi] dhe ajo që ata i konsiderojnë mrekulli. Gjithashtu ata flasin në lidhje me *keshf* [të zbuluarit], *el-uexhd* [ekstazën], ëndërrat, vizionet dhe çfarëdo që i përngjan kësaj nga pikat referuese që janë të lira nga çkado nga Libri i Allahut dhe Suneti i peygamberit [salallahu alejhi ue selam].

Lavdërimi [aprovimi] i Hasan el-Benas për tarikatin Sufi të el-Hesafijeh

Më pas themeluesi [Hasan el-Bena] lavdëroi Sufizmin dhe tarikatin në të cilin ai u edukua. Ky është Tariketul-Hesafijeh.⁵² Ai e lavdëroi atë në librin e tij, *Mudhakiratud-Da'ue ued-Da'ijeh*.⁵³ Andaj, megjithëkëtë, përse duhet që ta bartim këtë menhexh? Dhe përse duhet që të studiojmë librat e këtij menhexhi? Dhe përse t'i bashkangjitemi këtij menhexhi? Dhe përse duhet ta lëmë menhexhin e pastër, menhexhin e Selefus-Salih, të cilët morën diturinë e tyre nga Libri i Zotit të tyre dhe Sunetin e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam].

49. Ata quhen kështu për shkak të veshjes së leshtë [sufë] që ata mbartin. Pikat kryesore të referimit të Sufive pa marrë parasysh shkallët e ndryshme të tyre janë tre: [i] *el-keshf* (zbulimi); [ii] *edh-dheuk* (shija); [iii] *el-uexhd* (ekstaza). Secila nga këto pika të referimit ndahet në kategori dhe shkallë të ndryshme. Dhe kjo nuk mohon praninë e pikave tjera të referencës krahas këtyre trijave." Referoju el-Mesadirul-Ammeh lit-Teleki indes-Sufijeh [f.31, 183].

50. Kjo i referohet Uthman el-Mireghnit, i cili e trashëgoi atë nga babai i tij, Muhamed Uthman el-Mireghni, i cili vdiq në vitin 1368H. Ai ishte i cili thoshte për veten e tij, 'Kushdo që më sheh dhe kushdo që e sheh atë që më ka parë mua gjer në pesë njerëz, nuk do të preket nga Zjarri. Dhe në këtë s'ka kurrfarë dëmi nga që Allahu e cakton mëshirën e Tij për këdo që Ai do.' Dhe ai e quante veten *el-Khetm* [Fundi], apo *Khatimul-Eulija* [Eulijaja i fundit]. Ky emër u bë shenjë e shtegut Sufi të tyre, kështu që ata u quajtën *el-Khetmije*, që do të thotë i fundit nga të gjitha shtigjet dhe çkado tjetër që pohohet në favor të kësaj mbi pjesën tjetër të Umetit përfshirë këtu edhe Ebu Bekr dhe Umer [radiallahu anhu]. Referoju el-Exhuibetus-Sedideh [3-4/264] të autorit.

51. Kjo është nga fjalimi i mbajtur nga el-Bena në selinë e Ihuanëve në Kajro, më 09.06.1948, rreth përshtatjes së vizitimit të shejhut të tarikatis në kohën e tij, Muhamed Uthman el-Miraghni, i cili e trashëgoi atë nga i ati i tij. Referoju el-Exhuibetus-Sedideh [3-4/264] dhe *Kafiletul-Ihuan* [2/8].

52. Kjo është në lidhje me Hesnejn el-Hesafi. Ai ishte shejhu i parë i tarikatis kurse i ati i tij, Abdul-Uehab el-Hesafi, është shejhu aktual i saj. Ky është njëri nga rendet e Sufive.

53. [f. 22-23]

Ata u iu përmbajtën direktivave të dijetarëve të drejtë, siç janë katër Imamët dhe ata që erdhën përpara tyre si dhe ata që erdhën pas tyre në menhexhin e vërtetë. Ata nuk u mashtruan nga thëniet e njerëzve të bidatit.

Pozita e Selefus-Salih ndaj njerëzve të bidatit

Kurdo që është paraqitur ndonjë person i bidatit në tre gjeneratat e para, ai është mposhtur nga dijetarët e drejtë. Kështu ata e hidhnin poshtë bidatin e tyre dhe bënë në njohur gjendjen e tij dhe ia sqaronin atë njerëzve. Ata e sqaruan bidatin e Kaderijes⁵⁴, të cilët mohonin Kaderin [paracaktimin hyjnor]; ata e hodhën poshtë bidatin e xhehmive dhe bidatin e Mu'tezileve. Njëlloj ishte rasti me çdo bidat tjetër të shejtanit që mbinte. Kjo qe sqaruar nga njerëzit e diturisë, të cilët e kuptuan Librin e Allahut dhe Sunetin e pejgamberit të tyre [salallahu alejhi ue selam] me një të kuptuar të shëndoshë. Ata e

ndriçuan shtegun dhe i zgjëruan krahërorët dhe i dhanë të pamët atyre që dëshironin të vërtetën me qëllim që të jetonin nën hijen e saj dhe të vdisnin në të.

Gjithashtu erdhën edhe bidate të shumta, siç është bidati i Sufizmit. Ata u mposhtën nga dijetarët e drejtë. Kështu edhe Ibn Tejmije⁵⁵ [v.728H] – rahimehullah – i përgënjeshtroi ata. Ai është Imami, individi i jashtëzakonshëm, ai që rigjallëroi, këshilluesi. Ata po ashtu qenë përgënjeshtuar nga nxënësi i tij, Ibnul-Kajjim⁵⁶ dhe të tjerë pos këtyre dyve nga dijetarët e Sheriatit. Ata e hodhën poshtë bidatin e Sufizmit dhe bënë të ditur se feja e Allahut ishte plotësuar, dhe se Sufizmi ka ardhë me diçka që është e re dhe nuk ka kurrfarë lidhje me librin e Allahut dhe Sunetin e peygamberit [salallahu alejhi ue selam]. Dhe aty asnjëherë nuk është përmendur *tesewufi*. Ata kanë shtigje të ndryshme, të cilat s’është e mundur të numërohen tani. Mirëpo, në përgjithësi ne paralajmërojmë kundër të gjitha shtigjeve të tyre ekstreme dhe të tjerëve nga ekstremistët ndër të fshehurit.

54. Kaderitë janë ndjekësit e Me’bed el-Xhuheni. Ata thonë se robi është i detyruar që t’i bëjë veprat e tija dhe ai nuk ka liri zgjedhjeje. Ai i bën ato pa vullnetin e tij. Më saktë, ai nuk ka fuqi mbi veprën e vet. Ata po ashtu njihen si Xheberije, kurse emri el-Kaderije po ashtu është i zbatueshëm ndaj tyre. Referoju Mexhmu Resa’ilul-Xhemij fil-Akideh ues-Suneh [f.29], deri diku i përshtatur.

55. Ai është shejhul-Islam Tekijud-Din Ahmed Ibn Abdul-Halim Ibn Tejmije el-Herrani ed-Dimeshki. Ai ishte ndër oqeanet e diturisë, skajshmërisht inteligjent, bujar dhe i guximshëm. Ai është lindur vitin 661H, dhe vdiq në vitin 128H. Allahu e mëshiroftë.

56. Ai është Ebi Abdullah Shemsud-Din Muhamed Ibn Ebi Bekr, përgjithësisht i njohur si Ibnul-Kajjim el-Xheuzije. Ai qe tërhequr prej shkencave të Fesë gjersa arriti shkallën e një Imami në Fe. Ai qe vrerosur nga sprova të shumta njëjtë sikur mësuesi i tij, shejh Ibn Tejmije – rahimehullah. Ai u lind në vitin 691H dhe vdiq në vitin 715H.

Mësimet e përhapura nga një Egjiptian Sufi i quajtur el-Hizb es-Sejfi

Ne paralajmërojmë kundër tubimeve të tyre të *adhkar* [përkujtimeve/përmendjeve] që nuk kanë ndonjë bazë në Kur’anin Fisnik, e as në librat e hadithit siç janë *Sihah* [librat e besueshëm], *Sunen* [librat mbi traditën], librat e *mesanid* [librat e musnedit] dhe librat e *adhkar*. Vërtet, këto janë thjesht *adhkar* [përkujtime] të risuara. Në ditët e sotme ju mund të shihni shumë të tilla tubime. Ato janë përhapur nga një Egjiptian Sufi i quajtur el-Hizb es-Sejfi. Ai transmeton nga Ali Ibn Ebi Talib [radiallahu anhu] ndonëse Ali Ibn Ebi Talib nuk ia ka treguar asnjë fjalë atij. Kështu që ky gënjen njerëzit dhe ua sjell menhexhin Sufi njerëzve, që është i humbur dhe i humb të tjerët.

Tubimet e Sufive, si luajnë ata me dhikr dhe përgënjeshtrimi i tyre

Ata i kanë tubimet e tyre, termet teknike në lidhje me dhikr [përkujtim] dhe sillen si budallenj. Ata i shkurtojnë dhikret e tyre, dhe kështu e mbledhin fjalën Allah. Ata e

përsërisin *la ilahe* [nuk ka të adhuruar/Perëndi] ndërsa rrotullohen në të djathtë. Më pas ata thonë, *la ilahe* [nuk ka të adhuruar/Perëndi] nga njëqind herë apo dyqind herë. Më pas ata rrotullohen në të majtë ndërsa thonë, *la ilahe, la ilahe*. Kjo është një shembull i qartë i lojës⁵⁷ në të cilën sheshit vërehet ndikimi i shejtanit. Disa nga ata që e shqyrtoan dhe shkruajtën rreth menhexhit të Ihuanul-Muslimun e kanë përshkuar këtë shteg djallëzor, mu ashtu siç themeluesi i parë ndjeku menhexhin e Ihuanul-Muslimin.

Përmendja e disa nga grupet të cilat janë të pranishme sot

Këtë e kam sqaruar në librin tim, *el-Exhuibetus-Sedideh*, të mbështetur me prova dhe deklarata nga librat e njerëzve të tyre.⁵⁸

57. Tha shejh Hamud Ibn Abdullah et-Tuwejxhiri, “Vërtet, disa nga dijetarët e Tebligjijnëve kanë shprehur një lloj tjetër të dhikrit. Kjo ishte kur ata përsëritnin frazën, ‘*la ilahe*’ gjashtëqind herë. Ata e përsëritnin frazën, ‘*ilallah*’ katërqind herë. Dhe ata përmendnin një numër tjetër, diku rreth gjashtëqind herë. Pas kësaj ata përsëritnin frazën, ‘*ilallah*’ një njëqind herë. Dhe përmendjen e bënin me njëzëshmëri me zë të ngritur. Njërezit në rrugë mund t’i dëgjonin ata. Kjo është bërë në praninë e një shejhu ndër *shujuhtë* e mëdhenj Indianë. Vërtet, ata e përsëritnin këtë akt një kohë të gjatë. Dhe këtë e bënin në dy kohëra të ndryshme brenda muajit; herën e parë në mesin e muajit kurse herën tjetër në fund të muajit. S’ka dyshim që kjo është përqeshje e Allahut dhe Dhikrit të Tij. S’do të mbetet e panjohur për atë që posedon dituri dhe të kuptuar, se kjo vepër përbën kufër [mosbesim] gjashtëqind herë, ngase ndarja e mohimit nga vërtetimi në deklamimin, ‘*la ilahe ilallah*’ [nuk ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut] për një periudhë të gjatë kohore, dhe ndarja e një pjese të frazës nga pjesa tjetër në mënyrën që ata e kanë zgjedhur kërkon mohimin e Uluhijetit [Hyjnisë] të Allahut të Lartësuar gjashtëqind herë. Dhe kjo është kufër i qartë. Edhe nëse kjo bëhet vetëm një herë, ai me siguri do të jetë mosbesimtar. E si qëndron puna me atë që e përsëritë këtë gjashtëqind herë në një seancë? Pastaj ata vijnë me frazën e pohimit pasi që e ndajnë atë nga fjala e mohimit për një periudhë të gjatë kohore. Kjo s’do t’u bëjë fare dobi atyre. Vërtet, ata vetëm luajnë me dhikrin e Allahut dhe e përqeshin Atë.” Referoju *el-Keulul-Beligh fit-Tehdhir min Xhema’atul-Teblig* [f.9].

58. Referoju *el-Exhuibetus-Sedideh* [3-4/252-267].

E kam bërë këtë që rinia Islame dhe studentët e diturisë të kuptojnë se s’është e lejueshme që t’u bashkangjiten njerëzve të bidatit, e as që është e lejueshme që të pranojnë menhexhin e njerëzve të bidatit ndërsa përpara tyre dhe pas tyre qëndron Libri i Allahut, Suneti i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe menhexhi i Selefit që është purifikuar nga papastërtitë. Pra, çfarë ka përveç një xhemati të vetëm. Ky është ai [xhemat] për të cilin foli pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] kur qe pyetur në lidhje me Ta’ifetun-Naxhijetil-Mensureh [grupi i shpëtuar fitimtar], “Ky është xhemati.”⁵⁹ Dhe kjo s’është vetëm që të thuhet se ka xhemate [grupe të shumta], apo ‘sa shumë grupe ka në kohën e sotme, ku nga më të njohurat ndër ato janë Xhema’atul-Ihuan, Xhema’tut-Teblig, Xhema’a Hizbut-Tahrir, Xhema’a Hizbul-Islah, Xhema’a Shebab Muhamed, Xhematut-Tekfir uel-Hixhreh.’ Ekziston një numër i madh i këtyre xhemateve,⁶⁰ të cilat kanë devijuar nga Rruga e Drejtë sipas kundërshtimit të tyre ndaj asaj në çka kanë qenë

Selefus-Salih ynë.

Dituria mbi Sheriatin është shpëtim nga bidati

Kini kujdes! që të jeni të sigurt nga e keqja e tyre. Dhe s'është e mundur që ju të jeni të sigurt përveç nëse përpiqeni shumë rreth Librit të Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm, duke e lexuar atë, duke menduar thellë mbi domethënien e tij, së bashku me leximin e librave të njohur të tefsirit, siç është Tefsir Ibn Kethir,⁶¹ Tefsiri i Ibn Xheririt,⁶² Tefsiri i es-Se'dit⁶³ dhe Tefsiri i el-Begauit.⁶⁴

59. Shejhu i referohet hadithit që transmetohet nga Ibn Maxheh [nr.3992], nga Auf Ibn Malik i cili tha, 'I dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] ka thënë, 'Çifutët do të ndahen në shtatëdhjetë e një grupe, kështu që një do të jetë në parajsë kurse shtatëdhjetë do të jenë në Zjarr. Të Krishterët do të ndahen në shtatëdhjetë e dy grupe, kështu që shtatëdhjetë e një do të jenë në Zjarr kurse një do të jetë në parajsë. Dhe pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, Umeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, dhe njëra do të jetë në parajsë kurse shtatëdhjetë a dy do të jenë në Zjarr.' Qe thënë, 'O i dërguar i Allahut, kush janë ata?' Ai tha, 'Ata janë Xhemati.' Po ashtu është transmetuar nga Imam Ahmed [4/102] [3/145] dhe nga Ibn Ebi Asim në es-Sunneh [1/32-33] përmes Auf Ibn Malik, Enes, Mu'auije, Ebi Hurejre dhe Ebi Umameh [radiallahu anhum]. Është shpallur sahi nga shejh el-Albani në shënimet e tija për Kitabus-Sunneh, ku thotë, "Hadithi definitivisht është sahi, sepse ka edhe gjashtë rrugë tjera nga Enes, dhe ka dëshmitarë nga një grup Shoqëruesish [Sahabësh]."

60. Siç është Hizbut-Teuhidil-Islami, Xhema'atul-Kur'anije, Xhema'atul-Xhihad, Xhemati i Frontit Islamik dhe Xhemati i Frontit të Shpëtimit. Çdo grup *hizb* [grup] nga mesi i këtyre *ahzab* [grupeve] ka një ideologji, direktiva, një menhexh të cilin e kanë risuar, një organizatë të formuar nga themeluesi i tij dhe thirrësit e tij. Kështu qëndron puna edhe me secilin grup tjetër, gjithashtu edhe ata kanë ideologji të shumta, menhexhe të ndryshme dhe shtigje të veçanta. Të gjitha këto grupe përfundojnë duke e kundërshtuar menhexhin Selef, qoftë nëse e kuptojnë këtë apo jo. Referoju el-Irhab ue Atharuhu el-el-Efrad uel-Umem [f. 56] të autorit.

61. Ai është Imami, kënduesi [i Kur'anit], muhadithi, komentatori i Kur'anit, historiani, fekihi, Imadud-Din Ebul-Fida Isamil Ibn Muhamed Ibn Kethir, me prejardhje Kurejshite, që banoi në Damask. Ai ishte shenjë nga shenjat e muslimanëve në shekullin e tetë Hixhri. Ai u lind në vitin 700H, apo së shpejti pas kësaj ai u rrit në Damask ndërsa shoqërohej vazhdimisht me el-Hafidh el-Mizi, muhadithin e Shamit atëbotë. Kështu ai dëgjoi shumë shkrime nga ai dhe u martua më të bijën e tij. Ai po ashtu u shoqërua me shejhul-Islam Ibn Tejmije dhe mori prej tij, dhe u sprovua për shkak të tij. Ai vdiq në Damask në vitin 774H. Ai pati shumë punime, dhe nga më të njohurat ndër ato është libri i tij, Tefsirul-Kur'anil-Adhim. Referoju el-Bidaje uen-Nihaje [1/Hyrja].

62. Ai është Imami, dijetari, muxhtehidi, dijetari i kohës së tij, Ebu Xhafer Muhamed Ibn Xherir Ibn Jezid Ibn Kethir et-Tebari, autori i shkrimeve origjinale, ndër njerëzit e Amulit, Teberistan. Ai u lind në vitin 224H dhe filloi të kërkojë dituri pas 240H. Ai udhëtoi shumë për këtë qëllim, takoi shumë njerëz të shquar dhe ishte njëri nga individët unik dhe inteligjent të kohës së tij.

63. Ai është Abdur-Rahman Ibn Nasir Ibn Abdullah es-Se'di et-Temimi, komentator ndër dijetarët e Henabileh në mes të Nexhdit. Ai u lind në vitin 1307H dhe vdiq në vitin 1376H në Unejzeh [në Kasim]. Ai ishte ndër të parët që nisi një librari përbrenda saj në vitin 1358H. Ai ka shkruar rreth tridhjetë libra. Referoju el-E'lam [3/340] të ez-Zirkilit.

64. Ai është shejhu, Imami, el-Allame, shembulli, Hafidhi, shejhul-Islam, ai që e rigjallëroi Sunnetin, Ebu Muhamed el-Husejn Ibn Mes'ud Ibn Muhamed Ibnul-Fira el-Begauit esh-Shafi'i, komentatori i Kur'anit, autori i shkrimeve. Ai u lind në vitin 436H dhe ishte udhëheqës, Imam, dijetar, Allame, zahid [ai që përmbahet nga jeta e kësaj bote] i cili ishte i kënaqur me pak. Ai shkroi punime të gjata dhe i mbështeti ato me një pranim të plotë. Ai nuk jepte mësim, përveç në lidhje me pastrim/edukim. Ai ishte ekonomik në

veshje. Ai kishte një *theub* [veshje] të bërë nga fije të papërpunuara kurse mbulesa e kokës së tij ishte e vogël. Ai ishte në menhexhin e Selefite shprehur në ndikim dhe fuqi. Ai kishte njohuri të thella në tefsir dhe shpenzoi shumë kohë në fikh. Ai vdiq në vitin 516H. Referoju Sijer E'lamun-Nubela [19/439], el-Bidajeh uen-Nihaje [12/193] dhe el-E'lam [2/259] të ez-Zirkilit.

Pra, kjo është e bollshme dhe në të ka mjaftueshmëri. Dhe ju duhet që të përpiqeni fort në lidhje me Sunetin e peygamberit [salallahu alejhi ue selam] duke lexuar libra; duke filluar me libra të vogla, më pas duke vazhduar gjer në leximin e koleksioneve autentike [sihah], librave të *Suneneve* [traditave] dhe *mesanid* [musnedet]. Dhe e gjithë kjo s'do të mjaftojë për ju gjersa të largoheni nga këto menhexhe, njerëzit e të cilëve janë larguar me sjelljen e tyre nga menhexhi i vërtetë, i cili është i detyrueshëm për ne që ta ndjekim dhe të mbahemi për të në pajtim me fjalën e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar,

“Dhe mbahuni të gjithë për litarin e Allahut, e mos u përçani.” [Ali-Imran: 103]

Prandaj, Ehlu-Suneh uel-Xhema'ah dhe dijetarët e Selefite, si dhe ndjekësit e tyre janë ata që e zbatojnë këtë ajet fisnik, i cili e përfundon suretul-Muxhadileh,

“Ju s'do të gjeni popull që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, e të kenë dashuri për ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij.” [Muxhadile: 22]

Dhe *el-muhaddat* [kundërshtimi] ka shkallë të ndryshme. Prej tyre është edhe ajo që e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe kështu përfundon duke dalur nga Islami. Nga këto është edhe ai që e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij me bidate. Kështu që kjo konsiderohet të jetë shkalla e dytë e kundërshtimit pas Shirkut.

Përse bidati është më i rrezikshëm se mëkatet e mëdha?

Bidati është më i rrezikshëm se mëkatete e mëdha ngase personi që kryen ndonjë mëkat të madh, siç është rasti me atë që pin verë [alkool], ose kurorshkelësi, ose vjedhësi, ose të ngjashmit me këta do të ndjejnë keqardhje ndonjëherë dhe do t'i pendohen Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishtëm kur të kujtohet.

Pastaj ai e kupton se ka rënë në mosbindje. Kurse personi që bën bidat – bidat që zë vend në zemër – do të shihni se ai e mbron atë, duke e marrë atë për Fe të tijën dhe duke e përhapur atë me etje dhe zell. Kështu që kur Ehlu-Suneh mbrojnë dhe sqarojnë pavërtetësinë e bidatit, ai bëhet i justifikueshëm dhe hidhërohet, ai nis bojkotimin për shkak të kësaj dhe bën çkado që është e mundur për ta mbrojtur atë.

Ndërmarrja e një udhëtimiti në kërkim të diturisë është xhihad në rrugë të Allahut

Dhe në përfundim, hizb [grupi] i Allahut – ata me të cilët Allahu është i kënaqur dhe ata janë të kënaqur me Të – janë ata që marrin nga Libri i Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm me një të kuptuar të shëndoshë dhe një interesim të plotë, dhe marrin nga Suneti i pejgamberit bujar [salallahu alejhi ue selam] me një të kuptuar të shëndoshë dhe interesim të plotë po ashtu. Dhe s'është e mundur që dikush të arrijë të kuptuar të shëndoshë dhe interesim, përveç nëse ai merr dituri nga njerëzit e saj [diturisë] ndër dijetarët e Sheriatit, njerëzit që janë të preokupuar me Kur'an dhe tefsirin [komentimin] e tij, me akiden e Selefus-Salih dhe me Sunet të Udhëheqësit të të dërguarve [alejhis-salatu ues-selam]. Kështu që studentët e diturisë duhet të përshkojnë këtë shteg dhe t'i marrin dijetarët për mësues. Nëse ata udhëtojnë gjatë dhe përfshijnë largësi të mëdha [në kërkim të diturisë] atëherë kjo do të konsiderohet një përpjekje e vogël dhe e parëndësishme. Pra, të udhëtuarit për të kërkuar dituri është nga praktikatat e qëndrueshme të të drejtëve, nga karakteristikatat e punës së dijetarëve të mëhershëm dhe kjo është nisur nga Shoqëruesit e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]. Kështu udhëtuan ata individë të shkëlqyer nga Medineja pejgamberike, nëpër natë dhe ditë, vetëm për të dëgjuar një hadith kur ndonjëri nga ata kishte një vëlla në Sham, i cili e kishte mbajtur në mend atë hadith. Kështu kur Xhabir Ibn Adbullah mbërriti tek vëllai i tij, Abdullah Ibn Unejs, ai kërkoi lejen e tij. Ai tha, "O vëllai im, kam dëgjuar që ti ke mbajtur në mend një hadith në lidhje me drejtësinë, e unë kisha frikë se mos po vdes para se ta dëgjoja atë, apo se ti do të vdesësh para se ta dëgjoja atë prej teje."

Dhe ai ia tregoi hadithin atij. Më pas ai hipi mbi shtazën e tij dhe u kthye.⁶⁵ Pra ai bëri një udhëtim pothuajse një mujor vetëm për ta dëgjuar një hadith.

65. Teksti i hadithit është: Nga Xhabir Ibn Abdullah [radiallahu anhu] i cil tha, 'Më mbërriti një hadith nga Shoqëruesit e të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam], kështu që unë u nisa me një deve dhe udhëtimiti im ishte shumë i vështirë. Pastaj udhëtova një muaj gjersa mbërrita në Sham. Kështu arrita tek shtëpia Abdullah Ibn Unejs el-Ensari dhe ia dërgova një porosi atij se Xhabiri qëndronte tek dera. Lajmëtari u kthye dhe pyeti, 'Xhabir Ibn Abdullahu?' Unë thashë, 'Po.' Dhe ai doli dhe më përqafoi, dhe unë e përqafova atë.' Ai tha: Unë thashë, 'Më ka mbërritur se ti ke dëgjuar një hadith nga i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] në lidhje me padrejtësinë, gjë që unë nuk e kam dëgjuar prej tij.'" Ai tha, 'Kam dëgjuar të dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ue selam] duke thënë, 'Allahu i Lavdëruar do t'i mbledhë robërit, apo njerëzit – me një pasiguri shqetësuese – dhe ai dha sinjal me dorën e tij nga Shami, të cilët do të jenë të zhveshur dhe të pa bërë sunet. Ai tha, 'Ne thamë, 'Ç'farë kanë ata?' Ai tha, 'Asgjë.' Kështu që do të bëhet një thirrje me një zë që do të dëgjohet afër dhe larg, "Unë jam Mbreti, Unë jam Zoti. S'është me vend për askë që të hyjë në Zjarr gjersa njerëzit e parajsës të kërkojnë që ai të nxirret për ndonjë padrejtësi që ai ka bërë dhe të pajtojë me të.'" Ai tha, 'Ne thamë, 'Si do të jetë puna kur t'i vijmë Allahut zhveshur, zbathur dhe të pabërë sunet?' Ai tha, 'Duke tregtuar veprat e mira me veprat e këqija.'" Isnadi është hasan dhe hadithi është sahi. Është transmetuar nga el-Buhari [nr. 370-371] dhe Imam Ahmed në Musnedin e tij [3/495].

Dhe sa bujare dhe e famshme është kjo, nga që është prej Sunetit të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] dhe të udhëtuarit për të është Xhihad në rrugë të Allahut. Më saktë, ky është Xhihadi më i madh në fushë betejë, ngase dijetarët bëhen shkak për rigjallërimin e zemrave nëpërmjet përhapjes së diturisë, duke i udhëzuar injorantët dhe duke ofruar shpëtim për të ngatërruarin dhe tjetër pos kësaj nga dobitë që arrihen nga studentët e singertë të diturisë duke studiuar në menhexhin e saktë. Këta janë disa nga dobitë e marrjes së rrugës së drejtë [në studim] dhe marrjes së akides e menhexhit nga njerëzit e besueshëm të diturisë, të cilët kanë dituri me tepri. Ky është shtegu, dhe pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë në lidhje me të, “Kushdo që përshkon rrugë për të kërkuar dituri, Allahu do t’ia bëjë të lehtë rrugën për në parajsë.”⁶⁶ Pra të udhëtuarit në kërkim të diturisë asnjëherë s’është tepër i shtrenjtë, pa marrë parasysh se a është udhëtim në një vend të afërt apo diku skjashmërisht larg.

Një inkurajim nga ana e shejhut ndaj studentëve pjesmarrës në seminarin e diturisë

Dhe unë konsideroj që kjo ardhje e juaja⁶⁷ nga shtëpitë e juaja, vendet e juaja, familjet e juaja dhe braktisja që i keni bërë asaj që shijojnë njerëzit, të cilët nuk ia japin diturisë statutin që i takon; konsideroj që ju i keni lënë ata dhe keni ardhur këtu me qëllim që të kërkonit dituri nga thëniet e Allahut dhe thëniet e të dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam] dhe të përfitoni dituri në menhexhin e Selefus-Salih dhe të përfitoni dituri rreth menhexheve opozitare me qëllim që të ruheni prej tyre.

Vërtet, unë admirohem me këtë dhe e lus Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar që t’ju bëjë udhëzues që i udhëzojnë të tjerët dhe dijetarë që mësojnë atë që është ardhë në Librin e Zotit tonë dhe çfarë është ardhë në Sunetin e pejgamberit tonë [salallahu alejhi ue selam] dhe çfarë bartën nga dituria dijetarët e drejtë nga Selefus-Salihin. Toka asnjëherë s’do të jetë pa këta njerëz me fuqinë e Allahut, edhe nëse ata janë të pakët ndërsa të tjerët krahas tyre janë të shumtë. Dhe përshëndetjet e Allahut qofshin mbi pejgamberin tonë Muhamed dhe mbi familjen e tij dhe të gjithë Shoqëruesit e tij.

66. Sahi: Transmetuar nga Ebu Daud [nr. 3641], et-Tirmidhi [nr. 2822] dhe Ibn Maxheh [nr. 223]. Është saktësuar nga shejh el-Albani në Sahi Sunen Ibn Maxheh [nr. 182]. Kjo po ashtu është transmetuar nga ed-Darimi [nr. 342], dhe referoju Sherhus-Suneh [nr. 173-179].⁶⁷ Këto fjalë u qenë drejtuar studentëve në Seminarin e Parë të Diturisë, shejh Abdullah Ibn Muhamed el-Ker’au – rahimehullah – në vitin 1415H. Aty qenë të pranishëm studentë nga vende të largëta dhe vende malore. Kjo zuri vend në qytetin Samiteh, në provincen e Xhazanit.

Mësimi i pestë

Lavdi i takon Allahun dhe paqja e përshëndetjet qofshin mbi të dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij, mbi Shoqëruesit e tij dhe këdo që identifikohet me ta. Më tej:

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Dije – Allahu të udhëzoftë në bindje ndaj Tij – se el-Hanefije [Teuhidi i pastër] është Feja e Ibrahimit. Kjo është që të adhurosh Allahun, duke e praktikuar Fenë sinqerisht për Të."

Komentoi el-Allame Zejd ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Thënia e autorit – rahimehullah, "Dije [se]," ndodh në formë veprimi që tregon një njoftim për atë të cilit i adresohet kjo porosi, që ta përgatisë veten për ta kuptuar atë që vijon. Kjo vepër është ndër mësimdhëniet e çiltëra dhe parimet dobiprurëse në lidhje me temën e besimit të Teuhidit dhe mospranimin e çfarëdoqoftë që e kundërshton atë.

Përsëritja e dobisë së njoftimit nëpërmjet lutjes

"Allahu të udhëzoftë... "Vërtet, ai e vijoi këtë urdhër me një lutje të bekuar dhe kjo me qëllim që të kërkohet udhëzim nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar për robërit e Tij. Kjo është udhëzim në bindjen ndaj Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishtëm. Dhe, kjo është nga metodat e të shkruarit, ku autori e njofton dëgjuesin dhe lexuesin për t'i përgatitur vetet e tyre për atë që vijon. Dhe ai e vijon atë me një lutje për çdo dëgjues dhe lexues si një këshillë, dhe prej dashurisë dhe dëshirës së zjarrtë për Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar për të bekuar krijimin e tij me udhëzim dhe drejtim.

Domethënia e dëgjueshmërisë [bindjes]

"... në dëgjueshmëri ndaj Tij..." Dëgjueshmëria është nënshtrimi i atij që urdhërohet. Domethënë, nënshtrim ndaj asaj në çka Allahu e ka urdhëruar atë në Librin e Tij dhe çfarëdo që i dërguari i Tij [salallahu alejhi ue selam] e ka urdhëruar atë në Sunetin e tij. Kjo përfshin zbatimin e urdhërave dhe largimin nga ndalimet dhe konfirmimin e *hallallit* si *hallall*, konfirmimin e haramit si *haram* së bashku me besimin e korrekt që *hallalli* është *hallall* dhe *harami* është *haram*, si dhe afrimi ndaj Allahut më shumë me këtë.

Domethënia e menduar e el-Hanefije

"... që el-Hanefije është Feja e Ibrahimit..." Këtu autori hyn në temë. Me këtë pasazh është menduar informimi i muslimanëve, mashkujve dhe femrave, se Feja el-Hanefije është Feja e Ibrahimit [alejhis-selam]. Qëllimi i menduar i el-Hanefije është mosdashja e

Shirkut dhe prirja ndaj Teuhidit, dhe në përgjithësi kjo është mosdashje e së keqes dhe prirje ndaj së mirës. Pra, kjo është mosdashje e mosbindjes dhe prirje ndaj dëgjueshmërisë. Ky është shtegu për në lumturi dhe mënyra e suksesit. Më pas ai shpjegoi se fundamenti dhe bazat parësore të Fesë së Ibrahimit [alejhis-selam] janë:

Kushtet për pranimin e veprave dhe dëshmia për ato

"Kjo është që të adhurosh Allahun, duke e praktikuar Fenë sinqerisht për Të." Kjo është feja e Ibrahimit, babait të Pejgamberëve dhe mikut të afërt të er-Rahmanit [Mëshiruesit] të cilin Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar e dërgoi te një popull që ishte fundosur në Shirkut dhe idhujtari. Allahu e dërgoi atë për t'i thirrur ata dhe për t'i shpëtuar ata nga errësira e Shirkut dhe devijimit për në dritën e Librit dhe Sunetit. Pra, ai shpjegoi se baza dhe parimet parësore të saj është që muslimani ta drejtojë nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm të gjithë pasurinë e tij dhe aktet trupore të adhurimit, apo të dyja këto së bashku. Ai duhet t'ia kushtojë të gjitha këto vetëm Allahut, krahas *ihlas* [sinqeritetit], pasi *ihlas* është kusht ndër kushtet për pranimin e veprave. Dhe vepra nuk do të pranohet pa *ihlas*, nga që Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar nuk do të pranojë ndonjë vepër, përveç atyre që janë të sinqerta [khalis] dhe korrekte [seuab].⁶⁸

"... praktikimi i Fesë sinqerisht për Të..." Domethënë, për askë tjetër pos Tij. Njeriu s'bën ta praktikojë Fenë e vet për ndokënd tjetër pos Allahut, as ndonjë gjë nga aktet e tija të adhurimit, as ndonjë thënie, as ndonjë vepër, as çfarëdo pune, qofshin ato të bëra publikisht apo fshehurazi. Më saktë, e tërë kjo është për Allahun e Fuqishëm dhe të Madhërisëm. Kjo duhet të bëhet sinqerisht për kënaqësinë e Allahut dhe parajsën e Allahut, dhe me shpresë për shpëtimin nga ndëshkimi i Tij poshtërues, hidhërimi dhe pakënaqësia.

Sa shumë tekste ka në Kur'anin Fisnik që thërrasin njerëzit për sinqeritet në veprat e tyre? Dhe sa hadithe janë vërtetuar nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] që pohojnë të njëjtën gjë? Nga këto ajete është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm:

"Thuaj: Vërtet, unë jam urdhëruar që të adhuroj Allahun duke e praktikuar Fenë sinqerisht për Të." [Zumer: 11]

Urdhëri për pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] është urdhër për të gjithë Umetin, përveç asaj që ka dëshmi të veçantë që tregon ndryshe. Pra, kjo është bërë e njohur në disa vende, ndërsa Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm ka thënë,

"Thuaj: Vetëm Allahun e adhuroj duke e praktikuar Fenë sinqerisht për Të. Pra, adhuroni çfarë të doni krahas Tij." [Zumer: 14]

68. Ka thënë Fudejl Ibn Ijad [v. 187H] – rahimehullah, "Vepra më e mirë është ajo që është e singertë dhe korrekte." Dhe ai tha, "Ajo s'do të pranohet po s'që khalis [e singertë] dhe seuab [korrekte]. Ajo është khalis kur bëhet për hir të Allahut, ndërsa është seuab kur bëhet sipas Sunetit." Transmetuar nga Ebu Nu'ejm në el-Hiljeh [8/95] dhe është përmendur nga shejhul-Islam Ibn Tejmije në Mexhmu'ul-Fetaua [1/333], Ibnul-Kajjim në Medarixhus-Salikin [1/83], el-Bidaje uen-Nihaje [10/199], Tefsiri [8/176] të el-Begauit dhe Xhami'ul-Ulum uel-Hikem [1/44].

Dhe urdhëri i tij, "**Pra, adhuroni çfarë të doni krahas Tij,**" është urdhër qortimi për ta dhe është kërcënim ndaj tyre, nga që ata do të ndëshkohen kur të dalin para Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm dhe adhuruan tjetër pos Tij. Vërtet, është vërtetuar nga peygamberi [salallahu alejhi ue selam] se do t'u thuhet atyre, "Shkoni dhe kërkoni shpërblimin tuaj nga ata që ju kanë shiquar."⁶⁹ Dhe askush s'do të jetë në gjendje që të japë ndonjë gjë si shpërblim në Ditën e Gjykimit, as me anë të bërjes së ndonjë dobie, as duke e hequr dëmin. Pra, çdonjëri do të gjykohet nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm dhe ata do të shpërblehen sipas veprave të mira dhe të këqija të tyre, siç ka thënë Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar,

"Kujt i takon Mbretëria sot?" [Gafir: 16]

Kështu që Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar do të përgjigjet Vetë,

"I takon vetëm Allahut, të Papërballueshmit! Në këtë Ditë secili njeri do të shpërblehet për atë që meritoi. Askujt s'do t'i bëhet padrejtësi. Vërtet, Allahu është i shpejtë në bërjen e llogarisë." [Gafir: 17]

Gjithashtu është vërtetuar nga peygamberi [salallahu alejhi ue selam] në një hadith kudsij që Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar ka thënë, "Unë jam i vetëmjaftueshëm dhe s'kam nevojë për ndonjë ortak dhe për Shirkun e atij që ma shoqëron ndokënd. Unë e kam lënë atë dhe Shirkun e tij." Gjithashtu në një tjetër transmetim qëndron, "Pra ajo është për atë të cilin ma shoqëroi."⁷⁰ Është edhe hadithi i famshëm dhe i mirënjohur i Umerit [radiallahu anhu] i cili gjindet në hyrjen e pothuaj çdo libri të hadithit, "Vërtet, veprat janë sipas qëllimit. Dhe çdo personi do t'i takojë ajo që ka pasur për qëllim."⁷¹ Pra, kjo është dëshmi për *ihlas* [sinqeritet], korrektësi të qëllimit dhe vërtetësi [sidk] ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar në vepra.

Kundërshtimet brenda grupeve të mosbesimit në lidhje me Ibrahimin

Vërtet, grupet e kufrit [mosbesimit] janë në kundërshtim në lidhje me Ibrahimin [alejhis-selam], ku secili grup pohon që Ibrahim është me ta. Kështu që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i shpalli ata gënjeshtarë dhe e sqaroi realitetin e vërtetë të Fesë së Ibrahimit. Ai

sqaroi se s'është ashtu si thonë ata, dhe se ai është i lirë nga ata. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë,

"Ibrahimi s'ishte Çifut e as i Krishterë. Por, ai ishte musliman [hanifen muslimen], dhe ai s'ishte nga idhujtarët." [Aali-Imran: 67]

69. Sahi: Transmetuar nga Ahmed [5/428-429], dhe është saktësuar nga Imam el-Albani në Silsiletus-Sahih [nr. 951].

70. Transmetuar nga Muslim [nr. 2985], Ibn Maxheh [nr.4202] dhe Ahmed [3/215, 466]; nga Ebi Hurejre [radiallahu anhu].

71. Transmetuar nga el-Buhari [1/13] dhe Muslim [nr. 1907]

Çifutët, të Krishterët dhe idhujtarët të gjithë kanë pretendime ndaj Ibrahimit [alejhis-selam]. Kështu që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i shpalli të gjithë gënjeshtarë, nga që ata gënjen në pohimet e tyre. Dhe është vërtetuar që Ibrahimi qëndroi larg nga Shirku nga i cili vuanin të gjitha grupet e sipërpërmendura; Çifutët, të Krishterët, idhujtarët dhe ata që janë me ta. Është vërtetuar se ai ka qenë musliman i pastër, domethënë ai që iu nënshtrua Allahut pa i shoqëruar Atij ndonjë gjë, jo duke iu nënshtruar apo dorëzuar diçkaje tjetër. Ai u nënshtrua vetëm ndaj urdhërit të Allahut, Zotit të botrave.

Thirrja e të dërguarit vjen pranë thirrjes së Ibrahimit

Prandaj çdo musliman – mashkull apo femër – dhe çdo besimtar – mashkull apo femër – është më afër Ibrahimit se këto grupe për shkak të thënies së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Vërtet, njerëzit më të afërt ndaj Ibrahimit qenë ata që e pasuan atë dhe ky pejgamber dhe ata që besojnë." [Aali-Imran]

Pra, çështja s'është siç pohojnë Çifutët, as siç pohojnë të Krishterët, e as siç pohojnë idhujtarët.

"Vërtet, njerëzit më të afërt ndaj Ibrahimit qenë ata që e pasuan atë."

Ata e pasuan Fenë, besimin dhe adhurimin e tij.

"Dhe ky pejgamber dhe ata që besojnë. Allahu është aleat i atyre që besojnë." [Aali-Imran: 68]

Për shkak të madhësisë së da'ues së Ibrahimit dhe statutit madhështor të Fesë së tij, pejgamberi ynë [salallahu alejhi ue selam] na urdhëroi që ta ndjekim atë si një shpallje nga Allahu, kur Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm tha,

"Pastaj Ne shpallëm se ti duhet ta ndjekësh Fenë e pastër të Ibrahimit, se ai s'ka qenë ndër idhujtarët." [Nahl: 123]

Njëllonj, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm urdhëroi Umetin e Muhamedit që ta marrë atë si shembull,

"Vërtet në Ibrahimin është një shembull i mirë për ju. Ata që ishin me të u thanë popullit të tyre: Ne largohemi nga ju dhe nga ajo që adhuroni përveç Allahut. Ne ju mohojmë dhe mes nesh dhe jush do të ketë armiqësi dhe urrejtje gjersa ta besoni në Allahun një." [Mumtehine: 4]

Vërtet, peygamberi bujar [salallahu alejhi ue selam] erdhi si një që e rigjallëron këtë Fe dhe ndjekësin e saj, ndonëse ajo dallonte nga ligjet e mëhershme të urdhëruara [shera'i].

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Dhe kjo është me çfarë i ka urdhëruar Allahu të gjithë njerëzit dhe për çfarë i krijoi njerëzit, siç ka thënë Allahu i Lartësuar,

"Unë s'kam krijuar Xhinët e as njerëzimin për tjetër pos që të Më adhurojnë."
[Dharijat: 56]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Domethënë, ashtu që ata të realizojnë Fenë e Ibrahimit, e cila është përshkruar me përshkrimet më të dëlira. Dhe dëshmi për këtë është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Lartësuar,

"Unë s'kam krijuar Xhinët e as njerëzimin për tjetër pos që të Më adhurojnë."
[Dharijat: 56]

Pra, ky ajet sqaron urtësinë dhe sqaron synimin dhe qëllimin e lartë të krijimit të dy botrave: botrat e Xhinëve dhe botën e njerëzimit. Vërtet, qëllimi është që të adhurohet Allahu pa ndonjë shoqërues në lidhje me çdo gjë që fjala Ibadet [adhurim] nënkupton. Dhe pasi aktet e adhurimit janë të llojeve të ndryshme, dhe më e madhja, më e mira dhe më e larta nga ato është Teuhidi i Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, autori tha,"

Gjëja më e madhe që ka urdhëruar Allahu është Teuhidi

Shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Dhe gjëja më e madhe që Allahu ka urdhëruar është Teuhidi. E kjo është që të veçohet Allahu me adhurim."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Kjo ngase Teuhidi është shkaku kryesor që njerëzit e tij shpëtojnë nga banimi në Zjarr,

ndonëse ata mund të banojnë në të për një kohë të caktuar për shkak të sasisë së mëkateve. Pra, Teuhidi është ai, për shkak të të cilit pasuria e njeriut është e sigurt, po ashtu edhe gjaku e nderi. Kjo është hallka më e madhe lidhëse mes të gjithë muslimanëve përkundër kombësive të ndryshme të tyre, gjuhëve të ndryshme dhe vendeve të largëta. Është hallkë lidhëse që sjell vëllazëri mes tyre dhe i bën ata si një trup, siç ka thënë pejgamberi [salallahu alejhi ue selam], "Muslimani është vëlla i muslimanit."⁷² Dhe ai e shpjegoi Teuhidin me një definicion të qartë.

72. Transmetuar nga Buhari [nr. 6951], Muslim [nr. 2580] dhe Ebu Daud [nr. 3239]

Shpegimi i Teuhidul-Ibadeh

"Kjo është që të veçosh Allahun me adhurim." Domethënë, të veçosh Allahun e Fuqishëm dhe të Madhërishëm duke ia drejtuar Atij çdo akt të adhurimit. Që do të thotë çdo akt i ligjruar i adhurimit Sheriatik duhet t'i drejtohet Allahut nga robërit e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Pra, kushdo që veçon Allahun me adhurim, ai është *muwehid* [ai që pohon Teuhidin], ndërsa kushdo që ia drejton adhurimin e vet tjetërkujt pos Allahut, ai është *mushrik* [ai që bën Shirk]. Dhe, kushdo që shoqëron dikë tjetër krahas Allahut në adhurim, ai po ashtu është *mushrik*. Pra, vetëm Allahu është që meriton adhurimin pa pasur në këtë ndonjë shoqërues së bashku me Të.

Dhe, detyrimet, siç e dini, janë urdhërat dhe ndalimet. Ne kemi përmendur më herët që urdhëri më i madh është Teuhidi i Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Njëlloj ndalimi më i madh dhe forma më e madhe e mëkatit është Shirku ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Për këtë shkak, autori – hafidhahullah – ka thënë,"

Gjëja më madhe që Allahu ka ndaluar është Shirku

Tha shejhu-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Dhe gjëja më e madhe që Allahu ka ndaluar është Shirku."

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Kjo është që të lutësh të tjerë pos Allahut krahas Tij. Dhe, Shirku është mëkati më i madh me të cilin kundërshtohet Allahu, siç përmendet qartazi në Kur'an. Vërtet, ndalimi i Shirkut ndodh në Kur'an në mënyra të ndryshme. Kjo ndodh në mënyrën e ndalimit të qartë, siç gjindet në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"**Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni gjësend Atij.**" [Nisa: 36]

Ngjashëm qëndron edhe në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Mos jini ndër idhujtarët, nga mesi i atyre që përçanë Fenë e tyre dhe u bënë grupe."

[Rum: 32]

Gjithashtu qëndron në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, ku informon lidhur me Lukmanin [alejhis-selam] kur e këshilloi të birin e vet me urdhëra dhe virtyte dhe e ndaloi nga mëkatet dhe veset,

"O biri im, mos i bëj Shirk Allahut. Vërtet, Shirku është mëkati më i madh." [Lukman: 13]

Kjo ndodh në mënyrën e një kërcënimi të ashpër ndaj atij që i shoqëron të tjerë Allahut dhe vdes në Shirk. Kështu që Allahu i Lavdëruar ka thënë,

"Vërtet, Allahu nuk fal që njeriu t'ia shoqërojë të tjerët Atij, ndonëse Ai ia fal kujtdo që Ai do atë që është më pak se kjo." [Nisa: 114]

Allahu i Lavdëruar ka thënë,

"Vërtet, kushdo që bën Shirk ndaj Allahut - Allahu e ka ndaluar parajsën për të, dhe vendbanim i tij do të jetë Zjarri. Për shkelësit nuk do të ketë ndihmë." [Mai' deh: 72]

Pejgamberi e nisi thirrjen e tij me dy çështje

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] e nisi da'uen e tij duke vënë theksin në dy çështje:

Çështja e parë: Veçimi i Teuhidit të Allahut, Zotit të botrave.

Çështja e dytë: Ndalimi i ashpër nga Shirku ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar."

Plotësimi i definicionit që shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab i bëri Shirkut

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Shirk është që të lutësh të tjerë pos tij krahas Tij. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni gjësend Atij." [Nisa: 36]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Në thënien e tij, 'Dhe kjo [Shirku] është që të lutësh të tjerë pos Tij krahas Tij,' ai e lidh këtë.

Kjo është që të lutësh të tjerë pos Allahut së bashku me Të. Kjo ngase mushriku [idhujtari] ose ia drejton aktin e vet të adhurimit tjetërkujt pos Allahut, siç janë idhujt dhe statujat dhe atë që i gjason kësaj ndër perënditë e rrejshme, ose ia drejton aktet e veta të adhurimit Allahut dhe tjetërkujt pos Allahut, siç është kur lutë të tjerë pos Allahut dhe kërkon ndihmë prej Tij nganjëherë, dhe po ashtu e lutë krijimin dhe kërkon ndihmë prej tyre herave tjera. Pra, të dyja këto janë gjendje të *Shirku Ekber* [Shirkut të madh] i cili përjashton njeriun prej Fesë Islame dhe kjo nuk çrrënjohet, përveç me teubeh [pendim] dhe vepra të mira. Nga dëshmitë e kësaj është ajo që ndodh në të urdhëruarit në Teuhid dhe paralajmërimin kundër Shirkut. Thënia e Allahut,

"Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni gjësend Atij." [Nisa: 36]

Kjo e urdhëron njeriun në adhurim dhe e ndalon nga Shirku. Pra, Teuhidi s'mund të jetë i plotë, përveç duke qenë i pastër nga Shirku. Ky është parim që është sqaruar nga Kur'ani në vende të shumta. Ndër ato është edhe ky vend, ku Allahu urdhëron në Teuhidin e Tij por Ai nuk mjaftohet me urdhërimin në Teuhid. Më saktë, Allahu e vijoi me ndalim nga Shirku pasi robi mund të jetë *muwehid* [ai që e realizon Teuhidin] në disa akte të tija të adhurimit dhe mund të jetë *mushrik* në disa nga ato. Dhe, robi mund të jetë *muwehid* në disa raste dhe *mushrik* ndonjëherë. Kështu që Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm urdhëroi realizimin e Teuhidit pakufishëm, me cilësi përjetësie. Ai e ndaloi Shirkun ndaj Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm në çdo kohë, me një cilësi të vazhdimësisë gjatë kohëzgjatjes së veprës.

Për këtë shkak, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm u bëri vërejtje mushrikinëve, kur u shpall në lidhje me ta dhe kur u erdhi ngusht puna atyre, ata u bënë të sinqertë në lutjen e tyre ndaj Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Kurse derisa ishin në një gjendje sigurie, rehatie dhe shprese, ata ua drejtuan veprat e tyre të adhurimit perëndive të rrejshme. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i qortoi ata, dhe ky qortim është regjistruar në Kur'an kur Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm tha,

"Dhe kur ata hipin në anije i luten Allahut, duke qenë të sinqertë ndaj Tij. Por, kur Ai i sjell të sigurt në tokë, ata nisin të bëjnë Shirk." [Ankebut: 65]

Prandaj, ndër rreziqet që i kanosen Umetit Islam është që ata të bëhen neglizhentë ndaj Zotit të tyre në gjendjet e bekimit, lehtësisë, shpresës, sigurisë, shëndetit të mirë dhe tjetër nga këto nga kategoritë e ndryshme të bekimeve. Kjo shkon deri aty, sa që kur i godet ndonjë fatkeqësi ata, zemrat dhe gjuhët i kaplon lutja duke kërkuar ndihmë dhe lehtësim të dëmit. Ndërsa kur Allahu e largon dëmi nga ata, ata i kthehen gjendjes së mëhershme të neglizhencës dhe amullisë në lidhje me kryerjen e detyrave dhe obligimeve. Kështu ata futen në mosbindje dhe mëkate. Pra, kjo është një çështje me rëndësi që duhet pasur parasysh, pasi askush nuk shpëton nga ndikimi i kësaj neglizhence. Dhe kur atë e godet ndonjë fatkeqësi dhe shqetësim, ai i drejtohet Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar me një dëshirë të zjarrtë dhe me frikë.

Më pas, autori nisi shpjegimin dhe elaborimin mbi parimet dhe bazat që duhet t'i di tërë njerëzimi, qofshin mashkuj apo femra, në da'ue dhe durim. Pra, ai përmendi se këto tre parime janë që robi të ketë dituri mbi Zotin e vet, Fenë dhe peygamberin Muhamed [salallahu alejhi ue selam]."

Cilat janë tre parimet fundamentale që janë të detyrueshme për njerëzimin t'i dinë ato?

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-uehab – rahimehullah, "Nëse ju thuhet, "Cilat janë tre parimet fundamentale që janë të detyrueshme për njerëzimin t'i dinë ato? Atëherë thuaj: Robi duhet ta njohë Zotin e vet, Fenë dhe peygamberin Muhamed [salallahu alejhi ue selam]."

[1] Dituria e robit për Zotin e vet

[1] Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Përsa i përket Zotit të Lavdëruar, i Cili ka Emra të bukur dhe Cilësi të përkryera, Ai është i cili mirëmban të gjithë krijimin e Tij në botën e tokës dhe botën e qiejve dhe çkado që ka mes tyre. Asgjë s'është e pavarur nga Allahu as sa kapsitja e syrit. Ndërsa mirëmbajtja [terbije] e Allahut ndaj krijesës së Tij ndahet në dy kategori:

Terbije e Allahut ndaj krijesës është dy llojesh:

[1] *Terbije* [mirëmbajtja] e përgjithshme.

[1] *Terbije* [mirëmbajtja] e veçantë.

Përsa i përket mirëmbajtjes së përgjithshme, kjo përfshin tërë krijimin, qofshin ata të drejtë apo mëkatarë, besimtarë apo mosbesimtarë, që flet apo i heshtur. I gjithë krijimi ka nevojë për Allahun e Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Ai është që e mirëmban atë, e riprodhon, e furnizon, i jep siguri dhe stabilitet dhe të gjitha bekimet e ndryshme fetare dhe të kësaj bote, përveç atyre që refuzojnë bekimin e Fesë. Pra, ky ka shkelur në dëm të shpirtit të vet dhe do të merr shpërblimin [denimin] e tij. Përsa i përket mirëmbajtjes së veçantë, kjo është mbajtje që është e veçantë për robërit besimtarë të Allahut, dhe kjo s'mund të jetë për ndokënd pos tyre nga që ata mbartin shkakun për këtë *terbije* të veçantë, e cila konsiston në fitore, ndihmë, sukses, udhëzim dhe mbrotje në shtegun më të fortë. Kjo është e veçantë për robërit besimtarë të Allahut nga që e meritojnë atë. Ata mbartin shkakun për këtë *terbije* të veçantë duke iu përgjigjur Allahut dhe duke iu përgjigjur të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam]. Ata i binden thënies së vërtetë të Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"O ju që besoni! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ata ju thërrasin në atë që do t'ju japë jetë." [Enfal: 24]

Kështu që besimtarët i përgjigjen, anojnë nga kjo dhe i nënshtrohen thirrjes së Allahut dhe mësimëve fisnike të Tij. Pra, ata i binden Zotit të tyre dhe i binden peygamberit Muhamed [salallahu alejhi ue selam]. Allahu i ka fisnikëruar ata me terbiye dhe udhëzim të veçantë. Andaj, dituria mbi Zotin në mënyrën e cila i përshtatet madhësisë së Tij është baza parësore ndër bazat [usul] që janë të detyrueshme për njerëzimi t'i dinë dhe ta adhurojnë Allahun në këto parime.

[2] Dituria e robit mbi fenë e tij

'Dhe Fenë e tij.' Ky është parimi i dytë fundamental, 'dituria e robit mbi Fenë Islame,' dhe çfarë nevojë më të madhe ka Umeti sesa njohja e Fesë Islame? Pra, kjo është Feja e tij dhe lidhja mes Umetit dhe Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërisëm. Islami është çfarë Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ka urdhëruar Umetin ta pranojë, dhe kjo është me çka Ai kënaqet. Umeti duhet t'i nënshtrohet urdhërave të Tij dhe të përshkojë shtegun e Tij në të cilin udhëtari do të vendoset në kënaqësinë e Allahut dhe kopshtet e bekuara. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm ka thënë,

"Vërtet, Feja e vetme tek Allahu është Islami." [Aali-Imran: 18]

Pra, ky është kufiri dhe mbyllja që kufizon tërë Umetin pasi u dërgua peygamberi [salallahu alejhi ue selam], qofshin ata Arabë apo jo-Arabë, nga afër apo larg. Kjo kufizon Umetin shprehur në adhurim dhe e vendos Fenë Islame si rrugën e vetme për ta kënaqur Allahun në përjashtim të rrugëve tjera. Allahu e mbështet këtë domethënie me thënien e Tij,

"Kushdo që kërkon Fe tjetër pos Islamit, ajo kurrë s'do t'i pranohet atij dhe në Jetën e Përtejme ai do të jetë ndër humbësit." [Aali-Imran: 85]

Thirrja për lirinë e Feve

Kushdo që pohon se adhuron Allahun me Fenë e Çifutëve apo të të Krishterëve apo cilëndo Fe tjetër nga Fetë ndërsa thërret në lirinë e feve,⁷³ të cilat s'kanë kuptim të shëndoshë, ai është mosbesimtar në Fenë Islame.

73. Kjo është sikur deklarata që erdhi nga Mustafa es-Siba'i në librin 'Dr.Mustafa es-Siba'i Rexhul Fikreh ue Ka'id Da'ueh' [f.93] ku ai tha, "Islami s'është Fe që shfaq armiqësi ndaj Krishtërit. Por, ajo e njeh Krishtërimin dhe e konsideron atë si të shenjtë. Përsa i përket atij që imagjnon se ka të meta ndër të Krishterët dhe nder të veçantë për muslimanët, atëherë, ku është ky nder i veçantë? A gjindet kjo në lirinë e

besimeve ku Islami i konsideron të shenjta të gjitha besimet? Apo, a mos është në të drejtat njerëzore ku të gjitha detyrimet janë të barabarta? Islami nuk bën dallim mes Muslimanit dhe të Krishterëve, dhe në shtetin Islam, muslimanit nuk i jepet më shumë sesa të Krishterit, ndërsa kushtetuta përmend barazi për të gjithë zgjedhësit në të gjitha të drejtat dhe detyrimet."

Më pas ai improvizoi tre modele:

[1] Islami është Feja e shtetit zyrtar

[2] Fetë e shpallura nga qielli janë të shenjta dhe të paprekshme

[3] Kushtet e individëve nga grupet e ndryshme fetare

[4] Nuk bën të ketë diskriminim nga ana e banuesve ndaj të porsaardhurve në ndonjë shtet të caktuar bazuar në Fe, kombësi apo gjuhë.

Kjo është përmendur nga Uthman Abdus-Selam Nuh në librin e tij, et-Tarik ilel-Xhema'atil-Umm Ilm ue Amelus-Selef [f. 134] dhe el-Exhuibetus-Sedideh [5/49] nga autori.

Ai do të jetë ndër njerëzit e Zjarrit nëse vdes në këtë, për shkak të dëshmisë që gjindet në këtë ajet fisnik si dhe dëshmisë përbrenda përgjithësisë të pejgamberit Muhamed [salallahu alejhi ue selam] për të cilën na informoi Allahu në thënien e Tij,

"Thuaj: O ju njerëz! Vërtet, unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju." [A'raf: 158]

Fjala '*naas*' nuk përjashton askë nga fëmijët e Ademit. Dhe nga kjo llambë ka ardhur thënia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], "Pasha Atë, në Dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit, askush nuk dëgjon për mua nga ky Umet, qoftë Çifut apo i Krishter dhe ai nuk beson në atë me të cilën kam ardhur, përveç se do të jetë ndër banorët e Zjarrit."⁷⁴ Pra, nuk ka Fe e as ndonjë shteg – pasi është dërguar pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] – që çon tek Allahu, kënaqësia e Tij dhe vendbanimi i Tij i fisnikërisë, përveç shtegut të të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam].

Shtegu i të dërguarit është i kufizuar në dy burime fisnike

Shtegu i të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam] është i kufizuar në dy burime fisnike:

Burimi i parë: Libri i Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm në lidhje me të cilin Allahu tha,

"Ndjeke atë që të është shpallur nga Zoti yt e mos ndjek ndonjë aleat pos Tij. Sa pak po përkujtoni." [A'raf: 3]

Burimi i dytë: Suneti i të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam] në lidhje me të cilin ai u shpreh singërisht, "Kapuni fort për Sunetin tim dhe Sunetin e Halifeve të udhëzuara drejt pas meje. Mbahuni në këtë dhe kafshojeni me dhëmballë."⁷⁵ Vërtet, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i ka ujdísur ndihmësit për këtë Fe në çdo kohë dhe vend, pavarësisht se a janë ata pak apo shumë. Udhëheqësi i tyre është pejgamberi fisnik [alejhis-salatu ues-selam]. Ai ishte i pari që pranoi Islamit dhe i pari që thirri në

Islam. Ai ishte shkaku për udhëzimin dhe ndihmësit e Islamit. Kështu që nxënësit e tij ishin emigrantët [muhaxhirët] dhe ndihmësit [ensarët] – Allahu qoftë i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me të.

74. Transmetuar nga Muslim [1/134], Ibn Mendeh [1/508]. Referoju es-Sahihëh [nr. 157] të Imam el-Albanit.
75. Sahi: Transmetuar nga Ebu Daud [nr. 4607], et-Tirmidhi [nr. 2676] dhe Ibn Maxheh [nr. 42-43]. Është saktësuar nga Imam el-Albani në Sahi Sunen Ibn Maxheh [1/13] dhe ed-Darimi [1/57].

Lutje kundër atij që urren Shoqëruesit [Sahabët]

Pra, duhet të ketë një largësi të madhe ndarëse nga ai që i urren ata.⁷⁶ Ata u përpoqën me vetet e tyre, pasurinë e tyre dhe gjuhët e tyre që fjala Islame të bëhet më e larta dhe që fjala e kufrit [mosbesimit] të jetë më e ulta. Kështu Allahu pushtoi pjesën lindore dhe perëndimore nëpërmjet duarve të tyre gjersa u përhap Islami dhe flamuri i tij u ngrit lart. Pra, ndjekësit e tij u bënë të shumtë ndër Arabët dhe jo-Arabët nëpërmjet epërsisë së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Pastaj, me këtë *xuhud* [përpjekje] të mirë e të sinqertë njeriu thërret në Islam, në dituri dhe *besire* [mendjehollësi, dëshmi të qartë] dhe thërret në fundamentet [usul] e saja, degët [furu] e saja dhe virtytet e tyre, me thënie, vepra dhe punë. Ata që i ndjekën në këtë janë ndihmësit e Islamit, ndër muxhahidinët [pjesëmarrësit e xhihadit] fitimtarë në gjeneratat e drejta, ndër dijetarët e drejtë që i dhanë rëndësi dhe qenë të preokupuar me regjistrimin e shkencave të Fesë Islame, siç është tefsiri i Zotit të botrave, regjistrimet e Sunetit të udhëheqësit të pejgamberëve dhe të të dërguarve, duke punuar për ta sqaruar *sahi* [të vërtetën] nga *da'if* [e dobëta] dhe të miratuarën nga e refuzuara.

Hizbijin [partiakët] u heqin vërejtjen njerëzve të diturisë

Kjo konsiderohet të jetë ndër llojet më të mëdha të xhihadit, nga që ata i qartësuan për njerëzit domethëniet e Libri të Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm dhe e fisnikëruan atë nga veprat dhe nga ajo që e bën shembull nga gjërat që afrojnë ndaj Allahut. Kjo ngase ata ua sqaruan njerëzve atë që është vërtetuar nga i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] nga ajo që s'është vërtetuar, deri aty ku asgjë s'mund t'i atribuohet pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] përveç asaj çka ai vërtet tha, bëri, vërtetoi apo miratoi. A s'është kjo xhihad? Pastaj, sot dhe dje janë shfaqur grupe që kritikojnë ata që i dhënë rëndësi çështjes së Tefsirit për të folurit e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm me qëllim që t'ia qartësojnë Umetit Sunetin autentik të pejgamberit të tyre [salallahu alejhi ue selam] nga e dobëta [da'if] e saj. Po, janë shfaqur grupe njerëzish që pohojnë së janë aktivistë [herakijjin] të cilët e qortojnë këtë grup dijetarësh të drejtë! A është me vend që të qortohet ai që i përkushtohet Librit të Allahut shprehur në

Tefsir [shpjegim], mësim, da'ue dhe përhapje? A është më vend që të fajësohet ai që i jep rëndësi punës për të dalluar Sunetin autentik të peygamberit [salallahu alejhi ue selam] nga transmetimet e dobëta, dhe të miratuarat nga të refuzuarat?

76. Tha Imam et-Tahau [v. 321H] – rahimehullah, "Ne i duam Shoqëruesit e të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam]. Ne nuk i tejkalojmë kufijtë në dashuri ndaj asnjërit nga ata, e as që distancohemi nga ndonjëri nga ata. Ne urrejmë këdo që i urren ata dhe që i përmendin me tjetër pos nga pikëpamja e mirë. Ne nuk i përmendim ata, përveç për të mirë. Dashja e tyre është pjesë e fesë, *imanit* dhe *ihsanit*. Dhe urrejtja e tyre është mosbesim, hipokrizi dhe shkelje." Referoju el-Akidetut-Tahauije [f. 46].

Përgjigja është se s'është me vend që të qortohet kjo. Por, është e detyrueshme që të thirret në të me udhëzim dhe korrektësi, nga që kjo punë është nga xhihadi më i madh në rrugë të Allahut. Dhe rruga e Allahut s'ka të bëjë asgjë me rrugët tjera që kanë në krye të tyren shejtanë nga Xhinët dhe njerëzimi, që thërrasin të tjerët për t'iu bashkangjitur atyre. Ky është dallim i qartë i së vërtetës nga e kota, udhëzimit nga devijimi dhe çorientimit nga rregullsia.

S'është e mundur për atë që s'ka interesim për Librin e Allahut dhe Sunetin e peygamberit [salallahu alejhi ue selam] që të jetë i qartë në lidhje me shtegun me të cilin Allahu është i kënaqur për robërit e Tij. Dhe në nisje, peygamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndroi për trembëdhjetë vite duke thirrur në realizimin e Teuhidit. Kjo është mirë e njohur nga historia e gjerë peygamberike.

Pra, ruajuni këtyre njerëzve që flasin rreth të drejtës së dijetarëve duke thënë se ata nuk dinë gjë jashtë bibliotekave të tyre. Dhe thonë se s'dinë tjetër veç përkushtimit ndaj librave, fletët e të cilave janë zverdhur dhe çfarëdo që i gjason kësaj nga thënie. Ky është mëkat i madh dhe një krim i madh për të cilin ata do të shpërblehen nëse nuk pendohen tek Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm, të kërkojnë falje prej Tij dhe t'i kthehen gjerësisë së diturisë, t'i njohin njerëzit e saj sipas mirësive të Allahut të Fuqishëm dhe të Lartësuar.

Metodat e këtyre aktivistëve në da'ue janë demonstratat, marshimet, vrasjet politike dhe organizatat sekrete

Gjithashtu pasuan ndihmësit e Islamit për të thirrurit në të, duke shpjeguar cilësitë e tija të mira dhe duke u shpjeguar njerëzve në çdo kohë dhe vend dhe në epokën tonë. Ne e lavdërojmë Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar për atë se në botën Islame ka shumë njerëz që thërrasin në menhexhin e Selefit, të cilët nuk përshkojnë shtegun e aktivistëve në da'uen e tyre që përfshin demonstrata, marshime, vrasje politike dhe organizata sekrete.⁷⁷

77. Deklaroi shejhu bujar, Abdul-Aziz Ibn Abdullah Ibn Baz [v. 1423H] – rahimehullah, "Metodat e mira janë ndër mënyrat më madhështore për t'u pranuar e vërteta, ndërsa metodat e këqija dhe të ashpra janë ndër metodat më të rrezikshme që e vërteta të refuzohet e të mos pranohet; dhe është nga mënyrat më të rrezikshme për të shkaktuar konflikt civil, armiqësi dhe trazirë. Ajo që ka të bëjë me këtë temë, është ajo që është bërë nga disa njerëz në demonstrata, të cilat janë shkaku i një të keqeje të madhe për thirrësit. Pra, marshimi në rrugë dhe demonstratat nuk janë rruga e korrigjimit dhe da'ues. Rruga e saktë është të vizituarit dhe të shkruarit me atë që është më e mirë. Kështu që presidenti, udhëheqësi apo plaku i fisit duhet të këshillohet sinqerisht nëpërmjet kësaj rruge, jo ashpërsi dhe demonstrata. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndroi në Meke për trembëdhjetë vite pa i përdorur demonstratat, marshimet, e as që u është kërcënuar njerëzve me sabotime të pasurisë së tyre dhe vrasje politike. S'ka dyshim që këto metoda e dëmtojnë thirrjen dhe thirrësin dhe pengojnë përhapjen e saj. Këto metoda bëjnë që udhëheqësit dhe të vjetrit të kenë urrejtje ndaj da'ues dhe ta kundërshtojnë atë më çdo gjë të mundshme. Ata dëshirojnë mirësi përmes këtyre metodave, mirëpo me këtë arrihet e kundërta. Edhe nëse zgjatë shumë, akoma është më mirë se të bërit atë që dëmton da'uen dhe e bën atë që të kufizohet apo të mbarojë plotësisht. Dhe nuk ka mundësi e as fuqi, përveç me Allahun." Referoju Muxhellethul-Buhuthul-Islamije [botimi nr. 38/p. 210]

Vrasjet politike nuk janë nga mënyrat e da'ues dhe dëshmia për këtë

Pra, këto metoda nuk e ndihmojnë Islamin dhe as nuk tregojnë cilësitë e mira dhe vitytet e tij. Kjo vetëm u mundëson armiqëve të tij që ta akuzojnë për vrazhdësi dhe gënjeshtëri. Por, çështja Islame është ashtu siç ka folur Allahu lidhur me të,

"Allahu nuk ju ka ngarkuar me ndonjë vështirësi në Fe, kjo është Feja e Ibrahimit."
[Haxh: 78]

Pra, thirrja e tij fisnike dhe qëllimi madhështor ka qenë siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm,

"Elif Lam Ra. Ky është libër që Ne ta shpallëm që t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirës në dritë." [Ibrahim: 1-2]

Domethënë që të nxirren dhe të largohen ata nga errësira e injorancës [xhehël], devijimit dhe Shirkut dhe të vendosen në dritën e Librit dhe Sunetit; në imanin e vërtetë, jo në vrasjet politike, demonstrata, marshime, vënie të eksplozivëve dhe tjetër nga ajo që kemi dëgjuar dhe lexuar në lidhje me atë që është e pranishme sot në shumë vende. Allahu i ktheftë ata në menhexhin e të thirrurit në Islam me një kthim të këndshëm. Qëllimi i menduar i Islamit dhe da'ues në Islam s'janë vrasjet e mosbesimtarëve dhe vrasjet e atyre që s'janë të dobishëm. Vërtet, kjo vetëm do të sjellë fatkeqësi dhe prishje, dhe nëse kërkoni dëshmi për këtë do të mjaftojë vetëm një fragment i dëshmisë. Dëshmia është që kur pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ishte duke thirrur në Meke, ai duroi të gjitha llojet e vuajtjes deri aty sa që ata edhe hodhën mbeturina mbi shpinën e tij ndërsa ai po falej. Pra, në atë kohë ai s'kishte me vete më shumë se shtatëdhjetë burra, të cilët qenë të gatshëm që të flijoheshin për Allahun. Po të ishin urdhëruar nga pejgamberi [salallahu

alejhi ue selam] që t'i kapin ata të shkatërruarit, ata do ta bënë këtë.

Thirrja në Islam në mënyrën e duhur

Pra po të kishin qenë vrasjet politike metoda të da'ues dhe nga synimet e da'ues, atëherë ai do t'u kishte thënë atyre, 'O ju shtatëdhjetë njerëz,' ashtu që secili nga ata të shkonte dhe të vriste një mosbesimtar ndër Kurejshitet. Udhëheqësit e guximshëm nga mesi i mosbesimtarëve Kurejshitet dhe pjesa tjetër e ndjekësve të tyre asokohe nuk e patën mbërritur këtë numër. Mirëpo, ai u tha atyre që të migrojnë për në Etiopi gjersa të përmbushet premtimi i Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm dhe që Allahu të krijonte ndonjë mundësi dhe dalje nga ajo situatë e vështirë.

Ekziston edhe një dëshmi tjetër që pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] i pat kushtuar rëndësi të madhe vuajtjes së njerëzve të tij dhe pat pësuar një pikëllim të madh. Kështu ai pat shkuar tek një grup njerëzish dhe pat thënë, "Nuk u ndala gjersa mbërrita në majë të eth-The'alib.⁷⁸ I ngrita sytë nga qielli dhe Xhibrili më thirri e më përshëndeti dhe tha, "O Muhamed! Vërtet, Allahu ka dëgjuar çfarë të thanë populli yt." Dhe ai më tha, "O Muhamed! Ky është engjëlli i kodrës. Po të përshëndet." Engjëlli i kodrës e thirri atë dhe e përshëndeti dhe tha, "Vërtet, Allahu ka dëgjuar çfarë të thanë populli yt dhe si të refuzuan ata. Nëse ti do, unë do ta hedh Exhsheban mbi ta." Exhsheban janë dy kodra të mëdha që e rrethojnë Meken. Dhe, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha, "Jo, meqë shpresojë që Allahu do të sjellë nga pasardhësit e tyre të atillë që do ta adhurojnë Allahun dhe s' do t'i shoqërojnë atij asgjë."⁷⁹

Po t'i kishte thënë atij që ta hedhë Exhsheban mbi ta, ata do të varroseshin nën gurë dhe shpirtrat e muwehidinëve do të qetësoheshin. Mirëpo, Allahu ka urtësi ndërsa pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ishte njeri i urtë në da'uen e tij. Ai nuk e donte vrasjen dhe agjësimin. Ai vetëm dëshoi që t'i largonte ata nga zjarri i mosbesimit për në vërtetësinë e parajsës dhe imanit.

Kështu që çkado që arrihet në fushëbetejë është thjesht vetëm me urdhërin e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Dhe, Allahu ka urdhëruar që Feja e Tij të përhapet. Pra, kushdo që bëhet pengesë për përhapjen e Fesë së Allahut, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka urdhëruar që ai të luftohet nga ushtarët e Allahut dhe engjëjt e er-Rahmanit së bashku me ndihmuesit e Allahut. Kjo ngase ata nuk i japin përparësi asgjëje, e as që vonojnë ndonjë gjë përveç për shkak të shpalljes nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar. Ata e bëjnë këtë në zbatim të thënies së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"O ju që besoni! Mos e vendosni vetveten përpara Allahut dhe të dërguarit të Tij, dhe kini frikë Allahun. Vërtet, Allahu dëgjon çdo gjë, di çdo gjë." [Huxhurat: 1]

Nuk do të pushojë së qeni një grup që është fitimtar në të vërtetën. Ata do ta përshkrijnë menhexhin e Selefus-Salih në thirrjen në Islam, duke i shpjeguar cilësitë e mira dhe virtytet e tij. Islami është një mrekulli ndër mrekullitë. Kur njerëzit thirren në të, atyre u shpjegohen cilësitë e mira dhe virtytet e tij në mënyrë të shëndoshë - njerëzit do ta pranojnë atë [Islamin] dhe do të hyjnë në të në grumbuj. A nuk e sheh se kur një njeri do që ta zgjerojë një shoqëri nga mesi i shoqërive, ai nuk e nis këtë me vepër të heshtur. Ai e zgjeron atë vetëm duke bërë pohime, kurse pohimet zakonisht nuk janë të vërteta, e as të sakta. Mirëpo, njerëzit e pranojnë këtë shoqëri ndërsa lexojnë rreth saj nëpërmjet mjeteve për informim dhe duke dëgjuar në lidhje me të. Pra, njerëzit e pranojnë atë si mënyrë për t'i përmbushur kërkesat e tyre dhe për t'i plotësuar nevojat. Kështu që tregtari fiton menjëherë.

78. Karnuth-The'alib: Vendtakim i njerëzve të Nexhdit gjatë ditës dhe natës kur ata vinin nga Meka. Po ashtu kjo quhet edhe Karnul-Menazil. Referoju en-Nihajeh [5/54].

79. Transmetuar nga el-Buhari [nr. 3231] dhe Muslim [nr. 1795].

Edhe Islami është i njëjtë. Kur të ketë ndihmues që i shpjegojnë cilësitë e mira të tij dhe e shpjegojnë lehtësinë dhe volinë e tij, synimet e lavdërueshme dhe thesarin e ithtarëve të tij, atëherë njerëzit do të dëshirojnë mirësi nga prirja e tyre natyrore.

“Këdo që Allahu dëshiron ta udhëzojë, Ai ia zgjeron gjoksin për pranimin e Islamit; këdo që Ai dëshiron ta humbë, Ai ia mbyll dhe ia shtrëngon gjoksin atij si të ngjitej lart në qiell.” [en-En'am: 125]

[3] Dituria e robit mbi peygamberin e tij

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Dhe peygamberin e Tij Muhamed [salallahu alejhi ue selam].”

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el Madkhali – hafidhahullah, “Përsa i përket peygamberit Muhamed [salallahu alejhi ue selam], do t'jua lexojë pjesën e mëhershme të njëres nga shkrimet tona,⁸⁰ të cilën e definuan njerëzit e diturisë derisa mbërrita thënien time,

“Përsa i përket atij, nëpërmjet të cilit i është dhënë fund porosisë – domethënë Muhamedit [salallahu alejhi ue selam] – nëpërmjet të cilit Allahu e plotësoi Fenë për ne dhe e plotësoi dhuntinë e Tij ndaj nesh. Ai u dërgua si një i dërguar gjithpërfshirës tek dy botrat. Askush s'është i lirë që ta lë porosinë e tij pasi që ai është dërguar. Jam duke iu referuar krijesës më bujare, udhëheqësit të thirrësve të drejtë që janë dobiprurës. Ai është i dërguari i Zotit të botrave, udhëheqësi dhe peygamberi ynë: Muhamed Ibn Abdullah, i singerti dhe besniku. Pra, lini mosbindjen e jetës nomade dhe folni rreth tij si

person dhe thirrjes së tij për tek Allahu me çkado që dëshironi nga vërtetësia, këshilla, sinqeriteti, vetëpërmbytja, durimi, urtësia, serioziteti, puna e mirë dhe mëshira. Vërtet, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] është dërguar ndërsa e gjithë bota ishte në errësirë. Kështu që ai mbolli farën e agut dhe drita e porosisë së tij vezulloi. Dielli filloi të ndriçojë me dritën e Zotit të vet dhe errësira u largua gjersa u bë dritë ndriçuese që ndriçoi shtegun për ata që e dëshiruan këtë shteg. Dëshmia u vendos kundër atyre që devijuan nga rruga e drejtë dhe humbën nga rruga e qartë. Vërtet, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] nisi da'uen e tij fshehurazi gjersa Allahu i shpalli atij,

“Deklaro botërisht atë me çfarë je urdhëruar.” [Hixhr: 94]

Kështu që ai nisi ta bëjë të ditur atë haptas në regjione të ndryshme të Mekes në të gjitha kohërat. Ai u thoshte idhujtarëve, ‘Unë jam paralajmërues për ju para një ndëshkimi të rëndë.’

80. Këtu autori i referohet librit të tij, el-Exhuibetus-Sedideh ela Es'iletir-Reshideh [1/50].

Kështu ata e hodhën poshtë atë nga ai me një refuzim turpërues. Ata e kundërshtonin atë në çdo mënyrë të mundshme. Ata pritnin që atë ta godasë ndonjë fatkeqësi apo mjerim. Ata edhe planifikonin që të liroheshin nga ai gjatë tërë ditës dhe natës me qëllim që ta lironin popullin nga thirrja e tij, siç pohonin ata.

Në lidhje me këtë, Zoti Fisnik tha,

“Përkujto kur mosbesimtarët komplotuan kundër teje; që të të burgosin, të të mbysin apo të të nxjerrin nga shtëpia. Ata komplotojnë por edhe Allahu komploton, ndërsa Ai është komplotuesi me i mirë.” [Enfal: 30]

Përkundër këtyre kurthave, tubimeve, kompleteve dhe kërcënimeve, pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndroi i paepur si një kodër madhështore. Madje, ai ishte thellësisht i rrënjësuar dhe s'ka dëshmi më të qartë se thëniet që janë ruajtur për ne në të kaluarën, “Pasha Allahun, o xhaxha, po të vendosej dielli në dorën time të djathtë dhe hëna në dorën time të majtë për të më bindur që ta lë këtë çështje, nuk do ta lija gjersa të bëhej e qartë nga Allahu se duhet vepruar ndryshe apo të shkatërrohesha.”⁸¹

O Allah! Çfarë pozite e shkëlqyeshme ishte kjo, dhe çfarë grade e lartë dhe menhexh i pamasë ishte ky për atë që dëshiron të jetë ndër udhëheqësit e da'ues për tek Allahu, në bindje ndaj Allahut – qoftë lartësuar çështja e Tij – dhe në bindje ndaj të dërguarit të Allahut [salallahu alejhi ue selam].

Nuk është çudi që pozita e pejgamberit bujar ka qenë e këtillë dhe më mdhështore se kjo. Pra, ai është – në të vërtetë – krijesa më guximtare dhe më e devotshme e Allahut dhe ai

është më i kujdesshmi ndër ta lidhur me ndalimet e Allahut. Allahu e shpërbleftë atë me mirësi nga ne dhe pjesa tjetër e Umetit, në mënyrën të cilën një peygamber e meriton prej Umetit të vet dhe ata nën kujdesin e tij. Vërtet, peygamberi [salallahu alejhi ue selam] qëndroi në Meke për trembëdhjetë vite pasi u dërgua. Kur'ani Fisnik i shpallej atij dhe ai e bartte atë që i shpallej prej Zotit të tij. Ai ishte i durueshëm ndaj çkado që e goditte. Vërtet, ai [alejhis-selatu ues-selam] u përpoq me ardhjen e tij gjatë sezonës së Haxhit [pelegrinazhit] duke i thirrur ata në Islam. Ata nuk e pranuan da'uen e tij të mirë dhe nisën grupe për ta dëmtuar atë.

Në një kohë, ai shkoi në et-Ta'if për t'i thirrur ata në ndihmë gjersa ua kumtoi atyre porosinë e Zotit të tij. Kështu ata i ftuan fëmijët dhe të marrët e tyre për ta futur atë në skaj të rrugës duke hedhur breshëri gurësh mbi të gjersa i rrodhi gjaku me tepri, që s'mund të shkonte më tutje. Kur Allahu dëshiron që të ndodhë diçka, Ai e ujdís shkakun e saj dhe i hap dyert e saja. Dhe pas kësaj në Medine erdhi një delegacion.

81. Sahi: Referoju Silsiletul-Ahadithid-Da'ifeh [nr. 909]. Dhe kjo është ardhë përmes një shtegu tjetër me formulimin, "Unë jam i paaftë që ta lë këtë për ju," me isnad sahi. Referoju es-Sahihe [1/194].

Kështu që tek ai erdhën shtatëdhjetë njerëz në atë sezon dhe i premtuan atij që s'do ta pengojnë më dhe ata i bënë betimin se do të dëgjojnë dhe do t'i binden atij në kohë të gjallërisë dhe avashllëkut, dhe të shpenzojnë në vështirësi dhe rehati, dhe të urdhërojnë në të mirën dhe të ndalojnë nga e keqja, dhe të mos i frikësohen fajësimit të atyre që fajësojnë në lidhje me Allahun, dhe që të shkaktojnë fitoren e vërtetë. Pra, parajsja u takon atyre dhe ata qenë fitimtarë.

Allahu e lejoi peygamberin e Vet që të bëjë hixhret [migrim] për në një vend më të mirë. Kështu ai u largua si një emigrant për hir të Allahut. Kur mbërriti në Medine, ai e ndërtoi xhaminë e tij dhe e themeloi shkollën e tij nga e cila u diplomuan muhaxhirët dhe ensarët. Ata ishin që e ndoqën atë në kohë të vështirë dhe ata që bënë xhihad në rrugë të Allahut për ta bërë fjalën e Allahut më të lartën. Pra, ata nuk u dobësuan, e as që pushuan. Aktiviteti nëpër fushëbeteja ishte i njëpasnjëshëm ndërsa beteja kishte sukseset dhe dështimet e veta mes grupit të er-Rahmanit, të cilët e ndoqën peygamberin [salallahu alejhi ue selam] dhe grupit të shejtanit, të cilët ndoqën udhëheqësit e tij të mosbesimit dhe ushtritë e mëdha të tija të së keqes, prishjes dhe shkeljes. Suneti i Allahut gjithmonë është i vazhdueshëm në mësymjen, shuarjen dhe mposhtjen e pavërtetësisë. Meqë Allahu refuzon përveç që drita e Tij të plotësohet, ndonëse mosbesimtarët e urrejnë këtë.

Dhe nga Suneti tepër i çmuar i hixhretit erdhi pushtimi i fundit dhe fitorja e qartë. Dhe njerëzit hynë në Fenë e Allahut në grumbuj, ndërsa Feja Islame u përhap kudo në hapësirat më të largëta.

“Këdo që Allahu dëshiron ta udhëzojë, Ai ia zgjeron gjoksin për pranimin e Islamit; këdo që Ai dëshiron ta humbë, Ai ia mbyll dhe ia shtrëngon gjoksin atij si të ngjitej lart në qiell.” [en-En’am: 125]

Në përfundim, çështja është se parimet fundamentale të Fesë – siç e ka përmendur autori dhe të tjerë pos tij ndër dijetarët bujarë – janë tre:

[1] Dituria mbi Zotin

[2] Dituria mbi Fenë Islame

[3] Dituria mbi pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] dhe atë me çka ai erdhi.

Vërtet, pejgamberi ynë [salallahu alejhi ue selam] ka thënë në përgëzimin që i bëri Umetit, “Kushdo që është i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si Fe dhe me Muhamedin si pejgamber dhe të dërguar, parajsja është e detyrueshme për të.”⁸²

Dhe paqja, përshëndetjet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi pejgamberin bujar, mbi familjen e tij dhe të gjithë Shoqëruesit.

82. Transmetuar nga Muslim [nr. 1884] dhe en-Nesa’i [nr. 439].

Mësimi i gjashtë

Lavdi i takon Allahut dhe paqja e përshëndetjet qofshin mbi të dërguarin e Allahut, familjen e tij, Shoqëruesit e tij dhe këdo që e përkrah atë. Më tej:

Dobia e të shkruarit me anë të pyetjeve dhe përgjigjeve

Në mësimin e mëparshëm ne folëm rreth tre parimeve fundamentale që janë të detyrueshme për të gjithë njerëzimin që t’i di në kuptimin e përgjithshëm. Pra, njeriu duhet t’i di ato deri diku në mënyrë të hollësishme. Këtu kemi një pyetje të parashtruar nga autori – rahimehullah – dhe ai përgjigjet në të në mënyrën që është përdor nga disa shkrimtarë – rahimehullah. Mendoj në metodologjinë e të shkruarit me anë të pyetjeve dhe përgjigjeve; kjo bëhet me qëllim që të lehtësohet mësimi përmendsh, shpjegimi dhe sqarimi, e të mos i përmendim çështjet e akides. Pra, ai bëri pyetjen në vijim dhe u përgjigj në të, ai tha,

Nëse ju pyeteni: Kush është Zoti juaj?

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Nëse ju pyeteni, ‘Kush është Zoti juaj?’ Thuaj, ‘Zoti im është Allahu, i cili më ka mirëmbajtur mua dhe të gjithë krijimin me bekimet e Tij.”

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Vërtet është bërë fjalë në mësimin e mëparshëm ku qëndronte se *terbije* [mirëmbajtja] e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm ndaj krijimit të Tij është dy llojesh:

[1] *Terbije* [mirëmbajtja] e përgjithshme

[2] *Terbije* e veçantë

Dallimi mes këtyre dyjave është se *terbije* e përgjithshme përfshin tërë krijimin në tokë dhe në qiej dhe çfarëdo që ka midis tyre. Pra, ajo përfshin të drejtin dhe mëkatarin, besimtarin dhe mosbesimtarin, personin që është i obliguar dhe atë që është i liruar nga çfarëdo detyrimi dhe tjetër pos kësaj nga krijimi i Allahut; çfarëdo që dimë dhe çfarëdo që nuk dimë.

Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm u ka dhuruar bekime me tepri robërve të Vet; bekime te Fesë dhe bekime të kësaj bote. Dhe më e mira nga ato është bekimi i Fesë Islame, të cilën Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ia dhuroi Umetit në ajete të shumta. Nga këto është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

“Sot përsosa Fenë tuaj dhe plotësova dhuntinë Time ndaj jush, dhe zgjodha Islamin si Fe tuajën.” [Ma’ide: 3]

Kjo përfshin bekimin Islam shprehur në detyrimet e tija, urdhërat, ndalimet dhe çfarëdo që përmban përbrenda nga lehtësimi dhe volia, dhe çfarëdo që gjendet brenda në të nga hejqa e prangave dhe detyrimeve nga ky Umet. Vërtet, këto gjëra gjithashtu kanë ekzistuar edhe për popujt e mëparshëm. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm e sqaroi këtë lehtësim me thënien e Tij,

“Ju nuk jeni ngarkuar me ndonjë vështirësi në Fe.” [Haxh: 78]

Domethënë s’është zbritur ndonjë vështirësi për robërit shprehur në urdhëra, përveç se Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar të ketë bërë rrugëdalje nga vështirësia në këtë Kur’an dhe në Sheriatin e Tij të pastër. Kjo është e qartë dhe e dukshme në detyrimet siç është namazi, i cili është akti më madhështor i adhurimit pas *shahadetejn* [dy dëshmitë]. Qëndrimi në të [namaz] dhe përkulja janë shtyllat e tija, po ashtu edhe të bërit sexhde me shtatë gjymtyrët është shtyllë e tij. Mirëpo, nëse ndodh të ketë ndonjë vështirësi në qëndrimin [në namaz], atëherë ju mund të faleni në çfarëdo gjendje dhe namazi juaj do të jetë korrekt, siç qëndron në hadithin që është vërtetuar nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ku ka thënë, “Faluni duke qëndruar në këmbë, por nëse s’jeni të aftë për

këtë, atëherë bëjeni këtë ulur, e nëse s'jeni të aftë as për këtë, atëherë bëjeni këtë të shtrirë anash në krah.”⁸³ Pra, vështirësia është menjëherë. Njëllor, ka edhe shlyerje [keffarat] për betimin në Allahun dhe për *dhihar*,⁸⁴ si dhe shlyerje për mbytjen gabimisht të dikujt. Ka një lëshim për shkurtimin e namazit dhe lëshim për ndërprerjen e agjërimit për atë që ndërmerret ndonjë udhëtim që ai e konsideron të jetë i vështirë. Prandaj, s'është e mundur të ketë ndonjë vështirësi për personin në adhurimin e tij, përveç se Allahu ka ofruar shans dhe rrugëdalje për të menjëherë atë vështirësi dhe për të realizuar thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

“Ju nuk jeni ngarkuar me ndonjë vështirësi në Fe.” [Haxh: 78]

Prandaj, bekimi i Fesë Islame përfshin lehtësim dhe voli në urdhërat e saj si dhe mbarëvajtje në ndalimet dhe çështjet e paligjshme të saj, nga që shpirti dëliret nëpërmjet kësaj. Pra, çështjet e paligjshme menjëherë; shpirti pastrohet nga mëkatet; zemrat ndriçohen; gjymtyrëve u jepet energji ndërsa fytyrat ndriçohen. Dhe mu e kundërta ndodh kur personi dëmtohet nga mëkatet, kështu që ai kryen lloje të ndryshme të veprave të këqija dhe humbet ndër njerëzit e bidatit [rasisë]. Fytyra ndërron, zemra sëmuret ndërsa shpirti turpërohet nga që mosbindja është tirani ndaj zemrave, gjoksave dhe zemrave, dhe ligështim i trupave. Kurse dëgjueshmëria është dritë, jetë dhe etje, në dukje dhe në të fshehtë. Pra s'është e çuditshme për Fenë Islame që të jetë bekimi dhe dhurata më e madhe me të cilën Allahu e ka fisnikëruar Umetin e Muhamedit [salallahu alejhi ue selam]. Përsa i përket bekimit të kësaj bote, kjo s'mund të numërohet e as të përkufizohet.

83. Transmetuar nga el-Buhari [nr.117] nga Imran Ibn Husain [radiallahu anhu], Ahmed [4/426], et-Tirmidhi [nr.372] dhe Ibn Maxheh [nr.1231].

84. Shënim: Ky është term për divorc ku burri i thotë gruas së vet, 'Ti më je sikur shpina e nënës sime.'

Ekziston një bekim i krijimit dhe i riprodhimit, dhe bekimi i formës së qenieve njerëzore që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar e përmend në thënien e Tij,

“Vërtet, Allahu e ka krijuar njeriun në formën më të mirë.” [Tin: 4]

Dhe thënia e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar,

“Vërtet, Allahu i fisnikëroi fëmijët e Ademit dhe i barti ata në tokë dhe det. Dhe Ne i furnizuam ata më gjëra të mira dhe i bëmë të dalluar mbi shumë nga krijesat me një përparësi të dukshme.” [Isra: 70]

Ngjashëm ata qenë fisnikëruar me mbrojtjen e nderit të tyre, pasurisë dhe gjakut të tyre. E gjithë kjo është nga nderimi i Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar me të cilin është nderuar Umeti Islam.

Gjithashtu është edhe lehtësimi i furnizimit, siguria, stabiliteti, jeta shoqërore dhe ekonomike dhe tjetër pos kësaj nga bekimet për të cilat ka folur Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm,

“Po të provosh të njehsosh bekimet e Allahut, ti s’do të jesh në gjendje ta bësh këtë.”
[Nahl: 18]

Ndërsa bekimet vijnë vetëm prej Allahut,

“Çkado që keni nga bekimet [të mirat], kjo është nga Allahu.” [Nahl: 53]

Çfarëdo të mire që njeriu i dhuron njeriut, kjo është e kufizuar në aftësinë e tij. Mirëpo, Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e ka ndihmuar këtë duke bërë njeriun shkak për arritjen e këtij bekimi. Përsa i përket dhuruesit të vërtetë të bekimeve [el-Mun’imul-Hakk] që përmbush nevojat, ndihmon në vështirësi dhe lehtëson çështjet, ky është Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar, siç përmendet në thënien e Tij,

“Çkado që keni nga bekimet, kjo është nga Allahu.” [Nahl: 53]

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Ai është perëndia im [me’bud] dhe unë s’kam ndonjë perëndi përveç Tij.”

Komentoi el-Allame Zejd ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Kjo është e vërteta. Dhe kjo është kredoja e saktë, që të adhuronit Allahun dhe të mos adhuronit tjetërkënd përveç Tij. Kjo shprehje është marrë nga thënia juaj, *‘La ilahe ilallah.’*

Pra, ‘ai është perëndia im’ përmban pohim që adhurimi është për Allahun. ‘Unë s’kam ndonjë perëndi tjetër përveç Tij’ përmban mohim të të kushtuarit e adhurimit tjetërkujt pos Allahut, mu ashtu siç *‘La ilahe [s’ka perëndi që meriton të adhurohet]’* vërteton adhurimin për Allahun e jo për ndokënd përveç Tij.

Vërtet, vendimet vërtetohen me dëshmitë e tyre, ndërsa dëshmitë Sheriatike përmbajnë plotësim për njerëzit e imanit dhe Islamit që besojnë në dëshmitë Sheriatike nga Libri i Allahut dhe Suneti i pejgamberit [salallahu alejhi ue selam].”

Shpjegim i thënies së Allahut të Lartësuar: Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botrave

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Dëshmi është thënia e Allahut të lartësuar,

“Falënderimi i takon Allahut, Zotit të Botrave.” [Fatiha: 2]

Çdo gjë përveç Allahut është botë ndërsa unë jam pjesë e botës.”

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Autori provon *terbijen* e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm për krijimin e Tij, dhe provon që Allahu është perëndi e vërtetë, dhe se çdokush veç Allahut nuk meriton gjësend nga adhurimi. Ai provoi se me thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

“Falënderimi i takon Allahut, Zotit të Botrave.” [Fatiha: 2]

ku ‘*el*’ në ‘*el-hamd*’ paraqet totalitetin dhe domethënë që falënderimi pakufishëm i takon vetëm Allahut, nga që Ai është që bekon dhe e bën krijimin e Tij të përparojë. Kështu që Ai e meriton të falënderohet me një falënderim të pakufishëm dhe domethënia e *el-hamd* është falënderim për Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar me atë që e meriton. Kjo i referohet falënderimit që është i lidhur me madhështinë dhe epërsinë e Allahut. Në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, ‘*lilah*’ ka dëshmi për Teuhidul-Uluhije, gjë e cila dëshmon për fjalën e madhësisë, nga që fjala e madhësisë, ‘Allah’ do të thotë ai që hyznizohet; domethënë ai që është i denjë për adhurim, ndërsa ‘*er-rabb*’ është një cilësi e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm.

Kurse ‘*el-alemin*’ është shumësi i *alem* [bota] dhe s’është në njëjës. Pra, kjo përmban gjithçka veç Allahut nga krijimi i Tij prej gjërave të ndryshme të krijuara. Kështu që kjo përmbledh të gjitha *auelim*. Dhe *auelim* janë llojet e ndryshme të botrave: bota e njerëzve, bota e Xhinëve, bota e djajve, bota e engjëjve, bota e shpezëve, bota e shtazëve të egra dhe tjetër pos kësaj nga *auelim* që Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar i ka bekuar nëpërmjet krijimit, riprodhimit, të bërit e dikujt që të përparojë më shumë se të tjerët dhe të bërit e secilës botë në pajtim me atë që Ai ka caktuar nga urtësia e Tij.

Kështu që bota e engjëjve, për shembull, është një botë prirja natyrore e se cilës lidhet me dëgjueshmëri. Nuk ka mundësi fare që ata [engjëjt] të kundërshtojnë, nga që Allahu i ka pastruar ata me thënien e Tij,

“Ata nuk kundërshtojnë asnjë urdhër të Allahut.” [Tahrim: 6]

Kurse bota e djajve [shejatin] është një botë prirja natyrore e së cilës lidhet me mosbindje. Pra, s’ka mundësi fare që ata të bëjnë ndonjë akt dëgjueshmërie. Kjo është urtësi dhe drejtësi nga ana e Allahut dhe Ai s’duhet të pyetet në lidhje me atë çfarë bën.

Bota e njerëzve dhe bota e Xhinëve janë dy botra që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i ka obliguar me dëgjueshmëri ndaj urdhërave të Tij dhe të qëndrojnë larg nga ndalimet e Tij. Dhe Ai ka vendosur dëshmi në këto dy botra duke zbritur libra dhe duke dërguar lajmëtarë. Ai i dha secilit individ ndër individët e tyre aftësi dhe vullnet të lirë për të kryer akte dëgjueshmërie për t’ia afruar më shumë Allahut, dhe për ta lënë mosbindjen për shkak të ndalimeve të Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Pra, i dëgjueshmi bindet me anë të epërsisë së Allahut dhe mëshirës së Tij, pastaj me veprat e veta, arrijen

dhe vullnetin e lirë. Kurse i pabinduri kundërshton me anë të drejtësisë së Allahut dhe urtësisë së Tij, pastaj me veprat e veta. Dhe ai do të pyetet në lidhje me këtë dhe do të merret në përgjegjësi.”

Pyetja e dytë: Si e njeh Zotin tënd?

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, ‘Nëse pyetesh, ‘Si e njeh Zotin tënd?’ Thuaj, ‘Nëpërmjet ajeteve [shenjave] dhe krijimit të Tij.’”

Komentoi el-Allame Zejd ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Pyetja është, “Si e njeh Zotin tënd?” Autori tegoi se nga gjërat që konsiderohen shenja që çojnë për në diturinë mbi Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar janë ajetet dhe krijesat.

Domethënia e shenjave të Allahut

‘Nëse pyetesh, ‘Si e njeh Zotin tënd?’ Thuaj, ‘Me anë të ajeteve [shenjave] të Tija dhe krijimit të Tij.’ Prandaj, ajetet ndahen në tre kategori:

el-Ajetul-Kauniye [shenjat e përgjithshme]: Që nënkupton këtë botë me qiejt e vet, tokën e saj dhe çkado që gjindet midis tyre.

el-Ajetul-Burhaniye [shenjat dëshmuese]: Këto janë mrekullitë që u kanë ndodhur të dërguarve dhe pejgamberëve, siç janë mrekullitë që i ndodhën Musait [alejhi-selam] përfshirë këtu shenjat e qarta. Ndër ato është ndarja e detit, pastaj Shkopi, pastaj gjaku, bretkocat, morrat dhe karkalecat për të cilët Allahu na informoi në kaptinën A’raf; të gjitha këto janë mrekulli. Po ashtu ringjallja e të vdekurit me lejen e Allahut është mrekulli, dhe çfarëdo që buron nga pejgamberi ynë Muhamed [salallahu alejhi ue selam] nga mrekullitë e shumta, siç është ndarja e Hënës, lavdërimi nga ana e guralecave në prani të tij, derdhja e ujit me vrull, nënshtrimi i dy drunjëve ndaj tij, guri që përshëndeste atë dhe tjetër nga çkado që është transmetuar nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] nga mrekullitë.

el-Ajetul-Kur’anije [shenjat Kur’anore]: Këto janë çkado që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar u ka zbritur të dërguarve të Tij nga të folurit. Nga kjo është Tora [Teurati], Psalmet, Furkani [Kur’ani] dhe shkrimet e shenja të Ibrahimit dhe Musait dhe tjetër nga ajo çfarë Allahu ka zbritur prej diturisë së Tij. E gjithë kjo hyn në frazën, ‘ajetet e Tij.’ Domethënë, pastaj thuaj, ‘Me anë të shenjave të përgjithshme të Tij.’ Prandaj, soditja e universit provon madhësitinë e këtij krijimi. Pra s’është e mundshme që ky univers u shfaq befas, as që është e mundshme se ai është prodhuar nga ndonjë prej qenieve të krijuara, e as që është e mundshme që krijimi të ketë krijuar vetveten. E gjithë kjo është një vetëmashtrim. Prandaj, mundësia e vetme që mbetet është që universi i cili shihet

dhe i cili është nga shenjat e mëdha, në të vërtetë është dëshmi për ekzistencën e el-Khalik [Krijuesit] të Lavdëruar dhe të Lartësuar. Dhe Krijuesi është vetëm Allahu.

Njëlloj, të gjitha gjërat e krijuara së bashku me ndryshesat në lloje dhe kategori janë dëshmi për ekzistencën e Krijuesit dhe janë dëshmi për aftësinë e Tij. Pas kësaj, ato janë dëshmi që vetëm Ai meriton të adhurohet dhe askush tjetër s'është i denjë për këtë."

Tha shejhul Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Nga shenjat e Tija janë nata, dita, Dielli dhe Hëna. Nga krijesat e Tija janë edhe shtatë qiejt dhe shtatë tokët dhe çkado që ka në ato dhe çkado që gjindet midis tyre."

Arsyeja përse njerëzimi nuk i merr në konsideratë natën dhe ditën

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Këto janë nga shenjat më të dukshme që ne mund t'i shohim në çdo moment. Më pas ai përmendi shenjat e përgjithshme. Nata vjen me hijen e saj, pastaj kthjellohet. Pastaj vjen dita me dritën e saj, kurse nata e vijon atë. Kështu që në këto dy periudha kohore ka mësim dhe në to ka dëshmi për mundësinë [kudreh] e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, i cili e futë natën në ditë dhe e futë ditën në natë. Mirëpo, për shkak të përsëritjes së vazhdueshme për disa ditë dhe netë, njerëzimi bëhet i shkujdesur përse i përket mësimi që gjindet në këtë. Dhe njerëzimi është bërë i shkujdesur në lidhje me punën madhështore të Allahut të Lavdëruar që i ka bërë këto të lehta për njeriun. Nga dobitë më të mëdha të kësaj bote dhe epërsitë në ditën dhe natën, është ajo në çka robërit udhëzohen prej akteve të dëgjueshmërisë, detyrimeve dhe *mustahibat* [veprat e rekomanduara] si dhe prirja ndaj gjërave që afrojnë më shumë të Allahu dhe të qëndruarit larg nga ajo që Ai ka ndaluar. Kjo është domethënia që Allahu ka nxjerr në pah kur Ai tha,

"Ai është i cili bëri që dita dhe nata ta arrijnë njëra-tjetrën, për ata që dëshirojnë të përkujtojnë apo të jenë falënderues." [Furkan: 62]

Domethënë, kjo e arrin atë. Dhe këto të dyja s'do të përfundojnë gjersa të vijë dita e njohur [Çasti Përfundimtar]. Kjo do të shkëmbejë tokën me qiejt dhe do t'u bëhet e qartë të gjithëve që Allahu është Një, i Papërballueshmi.

Dobitë e Diellit dhe Hënës

Dielli, Hëna dhe çkado që gjindet midis tyre nga dobitë dhe epërsitë janë të njëjta. Kështu Dielli e ndriçon universin kur ai ngritet. Pra, në këtë ka dobi për trupat, drunjtë, shtazët dhe tokën në përgjithësi. Këto dobi janë të qarta dhe u janë të njohura atyre që sodisin. Po të qëndronte nata për një periudhë të gjatë kohore pa kurrfarë drite, do të

kishte çrregullime të mëdha në tokë, në trupa, në furnizim, në të korra dhe tjetër pos këtyre. Dhe po të kishte mbetur ditë për një periudhë të vazhdueshme kohore pa muzg, kjo do të rezultonte në një vështirësi të madhe dhe çështjet do të ndryshonin nga gjendjet e tyre fillestare. Për shkak të kësaj, Allahu ia ka përmendur këtë bekim Umetit në Kur'an. Që do të thotë ndërrimi i ditës dhe natës dhe rendi i tyre i vijuar ashtu siç shihet dhe është e njohur. Allahu i Lavdëruar,

"Thuaj, "Pa më thoni! Nëse Allahu do ta kishte bërë natën të vazhdueshme deri në Ditën e Ringjalljes, kush është *ilah* [perëndi] veç Tij që do të mund t'ju sillte dritë? A s'do të dëgjoni?" Thuaj: Pa më thoni! Nëse Allahu do ta bënte ditën të vazhdueshme deri në Ditën e Ringjalljes, kush është *ilah* [perëndi] veç Tij që do të mund të t'ju sillte natën për të pushuar në të? A s'do të dëgjoni? [Kasas: 71-72]

Vërtet, në bekimet e shumta të Allahut ka përkujtim dhe soditje për Umetin, të cilat askush nga krijesat e Allahut s'mund t'i shpejtojë apo t'i vonojë.

Kështu qëndron puna edhe me Hënën, së bashku më çkado që ka në të nga epërsitë dhe dobitë, siç është drita, nga që realizimi i shumë dritave artificiale paraqet vështirësi. Dhe s'është e mundshme për tërë krijimin që të përfitojnë nga kjo. Pra, njerëzit kanë gjendje të ndryshme. Kështu që njëri nga ata udhëton nëpër tokë dhe nuk gjen ndonjë dritë artificiale për të ndriçuar errësirën e natës. Kurse Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm ka krijuar Hënën dhe e ka bërë llambë në qiej për banorët e tokës.

Allahu e ka përmendur dritën e saj kur Ai tha,

"Ai bëri dritë me Hënën dhe e bëri Diellin ndriçues." [Nuh: 16]

Këto dyja janë nga shenjat më të mëdha, në të cilat nëse intelektualët nga mesi i njerëzve do të reflektonin, ato do të ishin dëshmi për mundësinë e Allahut dhe origjinalitetin e krijimit të Tij. Pas kësaj, kjo dëshmon se Ai është i denjë për adhurim, nga që Ai duhet të dëgjohet e jo të kundërshtohet. Ai duhet të përkujtohet e të mos harrohet, dhe Ai duhet të falënderohet e jo të mohohet.

Ai përmendi krijesat e mëdha që provojnë mundësinë e Allahut dhe po ashtu atë që vetëm Ai meriton të adhurohet në përjashtim të të gjithë të tjerëve. Shtatë qiejtë dhe shtatë tokët dhe çkado që gjindet midis tyre janë nga krijesat e mëdha, siç janë retë, shiu dhe çkado që gjindet në qiej nga engjëjt fisnikë, pejgamberët madhështorë, shpirtrat e besimtarëve dhe çkado që gjindet brenda tyre nga çështjet."

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Allahu ka thënë,

"Nga shenjat e Tija janë nata dhe dita si dhe Dielli dhe Hëna. Mos i adhroni Diellin dhe Hënën por adhurojeni Allahun i cili i krijoji ato, nëse ju vërtet e adhroni Atë." [Fusilet: 37]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm qëndron,

"Nga shenjat e Tija janë nata dhe dita si dhe Dielli dhe Hëna. Mos i adhuroni Diellin dhe Hënën por adhurojeni Allahun i cili i krijoi ato, nëse ju vërtet e adhuroni Atë."

[Fusilet: 37]

Ai përmendi që ndonëse këto gjëra të krijuara janë madhështore në krijimin e tyre, ato përkundër kësaj nuk meritojnë çfarëdoqoftë nga adhurimi. Pavarësisht se sa madhështore janë krijesat dhe sa shumë ka dobi prej tyre, ato mëgjithkëtë nuk e meritojnë që t'u drejtohet ndonjë akt adhurimi. Dhe asgjë nga bekimet s'mund të lidhet me ato. Vërtet është detyrim që adhurimi t'i kushtohet atij që ka krijuar këto krijesa, dhe kushtimi i adhurimit ndaj tjetërkujt pos Tij është që të vendosësh diçka aty ku nuk e ka vendin. Kjo është shoqërim [ishrak] i dikujt me Allahun, dhe kjo përbën mëkatën më të madh.

Pra, shumica e qenieve të krijuara adhurojnë perëndi të ndryshme, dhe ndër këta adhurues të perëndive të rrejshme janë ata që adhurojnë Diellin dhe Hënën. Domethënë ka njerëz që adhurojnë trupa qiellorë, kurse nga këta trupa qiellorë janë Hëna dhe Dielli. Pra, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka ndaluar kushtimin e çfarëdo akti të adhurimit këtyre qenieve dhe tjetër pos tyre për arsytet e njëjta. Allahu ka urdhëruar që vetëm Ai të adhurohet, nga që Ai është krijuesi; Ai është që i shpërndaui ata nga asgjëja; Ai është që krijoi, furnizoi, dha jetë, dha vdekje dhe rregulloi të gjitha çështjet; Ai është që meriton të adhurohet dhe askush tjetër nuk meriton çfarëdoqoftë nga adhurimi. Kështu që kushdo që vërtet është besimtar, atij i takon që ta veçojë Zotin e tij me adhurim, dhe askush nuk e veçon Atë me adhurim përveç besimtarëve.

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Allahu ka thënë,

"Vërtet, Zoti yt është Allahu, i cili krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë dhe hipi [istiu] mbi Fronin. Ai e sjell natën si mbulesë mbi ditën, që me të shpejtë e kërkon atë, dhe Dielli, Hëna dhe yjet i janë nënshtruar urdhërit të Tij. Padyshim që i Tij është Krijimi dhe Urdhëri. I Bekuar qoftë Allahu, Zoti i botrave." [A'raf: 54]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Autori e vijoi këtë dëshmi me dëshmi tjera, siç është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Vërtet, Zoti yt është Allahu, i cili krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë dhe hipi [istiu] mbi Fronin. Ai e sjell natën si mbulesë mbi ditën, që me të shpejtë e kërkon atë, dhe Dielli, Hëna dhe yjet i janë nënshtruar urdhërit të Tij. Padyshim që i Tij është Krijimi dhe Urdhëri. I Bekuar qoftë Allahu, Zoti i botrave." [A'raf: 54]

Dobitë e ajetit: Vërtet, Zoti yt është Allahu i cili krijoi...

Përbrenda këtij ajeti gjinden një mori dobish, ndër ato:

Përmbledhja e thënieve rreth kohëzgjatjes së krijimit të qiejve dhe tokës

[1] Zoti është ai që meriton të adhurohet. Ai është që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë. Këto gjashtë ditë janë sqaruar nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm në kaptinën Fusilet ku Allahu i Lavdëruar thotë,

"Thuaj, "A vërtet e mohoni Atë që krijoi tokën për dy Ditë kurse ju i bëni rivalë Atij?" Ai është Zoti i botrave. Ai vendosi në të [tokë] kodra dhe e bekoji atë, dhe mati furnizimin e saj [për banorët e saj] për katër ditë të barabarta; për të gjithë ata që pyesin. Pastaj ai u ngrit mbi [istiu] qiellin kur ai ishte tym dhe i tha atij dhe tokës, "Nënshtrohuni me dëshirë ose pa dëshirë!" Ato të dyja thanë, "Po nënshtrohem me dëshirë." Pastaj Ai i plotësoi dhe i përfundoi nga krijimi i tyre shtatë qiej për dy ditë dhe në secilin qiell rregulloi çështjet e tija. Dhe Ne stolisëm qiellin më të afërt me llamba [yje] që të jenë stoli si edhe të ruajmë atë [nga djajt, duke i përdorur ata si predhë kundër djajve]. I këtillë është vendimi i Tij, të Gjithfuqishmit, të Gjithdijshmit." [Fusilet: 12]

Kështu Allahu sqaroi hollësisht këto gjashtë ditë. Katër ditë nga këto janë harxhuar në krijimin e tokës. Ai e krijoi atë për dy ditë pa e shtrirë atë. Pastaj pas këtyre dy ditëve, Ai krijoi tokën dhe përcaktoi çështjet për secilin qiell. Pastaj pas kësaj, Ai shtriu tokën për dy ditë. Pra, të gjitha këto ditë që Allahu i ka përmendur këtu përbëjnë gjashtë ditët. Pastaj Ai hipi mbi Fronin. Kështu krijimi i tokës pa e shtrirë atë pati përparësi ndaj krijimit të qiejve. Pas kësaj, qiejt u krijuan tërësisht. Dhe pas kësaj toka u shtri për dy ditë. Pra, domethënia e shtrirjes [dehw] së tokës është siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm,

"Dhe pas kësaj Ai shtriu tokën dhe nxorri prej saj ujin dhe kullosat e saj. Dhe Ai nguliti në mënyrë të qëndrueshme kodrat, që të jenë furnizim dhe dobi për ju dhe bagëtitë tuaja." [Nazi'at: 30-33]

Urtësia pas krijimit të qiejve dhe tokës për gjashtë ditë

[2] Dobia e dytë është urtësia në krijimin e qiejve dhe tokës për gjashtë ditë. Kjo është përkundër faktit që Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e ka përshkruar Vetën në mënyrën që kur Ai dëshiron ndonjë gjë, Ai vetëm thotë, "Bëhu!" dhe ajo bëhet. Kështu dijetarët e tefsirit [komentimit] kanë thënë, "Kjo është që robi të mësojë zhvillimin gradual të çështjeve." ⁸⁵ Dhe se Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm s'është i paafte që

t'i duhet një periudhë e gjatë kohore si kjo. Më saktë, Ai posedon përsosuri dhe aftësi të përsosur.

"Vërtet, çështja e Tij është që kur të dojë ndonjë gjë, Ai thjesht thotë, 'Bëhu!' dhe ajo bëhet." [Ja Sin: 82]

Besimi në Istiua mbi Fronin

[3] Dobia e tretë është që të kihet iman [besim] në istiua [ngritje/hipje] mbi Fronin, dhe të pohohet ky atribut në mënyrën e Ehlu-Suneh uel-Xhema'a. Allahu e ka krijuar Fronin, kështu që ai është pjesë e krijimit të Tij. Më saktë, ai [Froni] është krijesa më e lartë e Tij, dhe Ai ka hipur mbi të me një ngritje [istiua] që i ka hije Madhështisë së Tij; pa *tesbih* [antropomorfizëm], *temthil* [gjasim], *te'til* [mohim], *tehrif* [shtrembërim], dhe *te'uil* [shpjegim figurativ]. Më saktë, kjo pohohet sipas thënies së Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Asgjë s'është sikur Ai, Ai dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë." [Shura: 11]

85. Referoju Fet'hul-Kadir [2/219] të esh-Sheukanit.

Kjo është nga Cilësitë të cilat i kanë mohuar Mu'atiletul-Xhehmije, Mu'tezileh i kanë mohuar ato po ashtu ndërsa Esha'ireh, Kullabije⁸⁶ dhe Maturidije⁸⁷ i kanë shpjeguar figurativisht [te'uil].

[4] Dobia e katërt është se të gjitha këto krijesa madhështore i nënshtrohen urdhërit të Allahut,

"Ai [krijimi] drejtohet me anë të urdhërit të Tij." [Enbija: 81]

Allahu ka vënë kufij për të. Ai ia përcaktoi përmasat dhe i bëri yjet me të cilët funksionon në pajtim të plotë me urdhërin e Allahut, të cilin Ai e ka paracaktuar për të. Për shkak të kësaj, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë,

"As Dielli s'mund ta kalojë Hënën, e as nata s'mund ta kalojë ditën. Ato të gjitha pluskojnë, secila në orbitën e vet." [Ja Sin: 40]

Kështu qëndron puna edhe me yjet; ato që orbitojnë dhe ato që janë të ndalura; ato që ngrihen dhe ato që perëndojnë. Dhe vendet e tyre i janë nënshtuar urdhërit të Allahut dhe janë nën kontrollin e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, gjersa të përfundojë çështja e tyre me kalimin e kësaj jete.

[5] Dobia e pestë është se urdhëri dhe krijimi i takojnë Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Ai urdhëron për çfarë të dojë, dhe gjëja më e madhe që Ai ka urdhëruar është dëgjueshmëria ndaj Tij. Dhe akti më i mirë dhe më fisnik i dëgjueshmërisë është pohimi i Teuhidit [njësisë] së Tij. Pra, urdhëri i takon vetëm Allahut, pakufishëm. Ai urdhëron për çfarë të dojë dhe ndalon çfarë të dojë. E gjithë kjo është mëshirë ndaj robërve dhe pastrim dhe shlyerje për shpirtrat dhe zemrat e tyre dhe një sprovë. Është siç ka thënë Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar,

"Që Ne të provojmë se cili prej jush është më i miri në bërjen e veprave të mira."

[Tebarek: 2]

Domethënë, cili prej jush e ka veprën më të mirë dhe më të saktë.

86. el-Kullabije: Ata janë ndjekësit e Abdullah Ibn Kullab [v.240H]. Ai dhe sekti i tij janë të vetmit që thonë se Allahu s'ka të folur që mund të dëgjohet. Dhe ata pohojnë që Xhibrili s'ka dëgjuar gjë nga Allahu nga ajo që i është zbritur të dërguarve [alehimus-selam], por kjo ishte vetëm një frymëzim me të cilin është frymëzuar pa pasur të folur të vërtetë. Referoju Aka'iduth-Thelath ues-Seb'in Firkeh [1/279], deri diku e përshtatur.

87. el-Maturidije: Kjo është identifikim me Muhamed Ibn Muhamed Ibn Mahmud, përgjithësisht i njohur si Ebi Mensur el-Maturidi es-Semerkandi. Ai vdiq në vitin 333H. Ata ishin një grup që pajtoheshin me Esha'ireh në disa çështje ndërsa i kundërshtonin në disa të tjera. Ky grup përfshinte një numër juristësh nga Hanefitë. Udhëheqësi i këtij grupi nuk pat pasur ndjekës në fazën e parë të çështjes së tij. Vërtet, medhhebi i tij qe rigjallëruar nga ndjekësit e tij një kohë të gjatë pas vdekjes së tij, gjersa kjo u përhap. Referoju librit: el-Maturidije Dirasten ue Tekuimen [f.93-104]

"Dhe Ne do t'ju provojmë me vështirësi dhe kënaqësi dhe ju do të ktheheni tek Ne."

[Enbija: 35]

Prandaj, Allahu është Ai që veçohet me aktin e krijimit. Pra, Ai krijoi krijimin pa ndonjë ndihmës. Dhe Ai furnizoi të gjithë krijimin pa ndonjë ndihmës. I tërë pushteti është i Tij. Ai urdhëron për çfarë të dojë dhe e gjykon kë të dojë. Ai nuk ka trashëgimtar në gjykimin e Tij, dhe Ai është i shpejtë në vlerësim."

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Allahu ka thënë,

"I bekuar është Allahu, Zoti i botrave." [A'raf: 54]

Ai është që meriton adhurimin, dhe dëshmi është thënia e Allahut të Lartësuar,

"O ju që besoni! Adhurojeni Zotin tuaj që ju krijoi juve dhe ata qe erdhën para jush, ndoshta do të bëheni të devotshëm. Ai është që e ka bërë tokën vendpushim për ju, qiellin si kupë dhe Ai ka zbritur ujë nga qielli." [Bekare: 31-32]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Nga fundi i këtij ajeti, Allahu e ka lavdëruar Vetveten dhe e ka pastruar Vetveten nga çdo e metë me thënien e Tij,

“I bekuar është Allahu, Zoti i botrave.” [A’raf: 54]

Domethënë, Ai është i pastër nga çdo e metë, i Madhërishmi, i pasur në mirësinë dhe bekimin e Tij, nga që Ai është Zoti i botrave, Krijuesi i botrave, Pronari i botrave dhe çdo gjëje në botë dhe në qiej, dhe bota e tokës është nën kontrollin e Tij pakufishëm. Dhe Allahu i Lavdëruar e drejton të gjithë krijimin e Tij me çkado që të dojë dhe këdo që të dojë.

Autori i vijoi dëshmitë duke demonstruar që krijesat e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm janë dëshmi për ekzistencën e Tij me faktin se kjo tregon që Ai meriton të adhurohet. Pra, duhet të adhurohet vetëm Allahu. Allahu ka thënë,

“O ju që besoni! Adhurojeni Zotin tuaj që ju krijoi juve dhe ata që erdhën para jush, ndoshta do të bëheni të devotshëm. Ai është që e ka bërë tokën vendpushim për ju, qiellin si kupë dhe Ai ka zbritur ujë nga qielli.” [Bekare: 31-32]

Thirrja këtu i adresohet të gjithë njerëzimit, “O njerëz!” Kjo është nga dëshmitë e gjithpërfshirjes dhe përgjithësisë së porosisë së pejgamberit tonë Muhamed [salallahu alejhi ue salam]. Kështu që çdonjëri nga njerëzimi hyn në domethënien e fjalës ‘naas,’ qofshin ata Arabë apo jo-Arabë, mashkull apo femër; të gjithë këtyre u drejtohet në këtë të folur gjithpërfshirës dhe të përgjithshëm, që ata t’ia kushtojnë të gjithë adhurimin vetëm Allahut pa i bërë ortak.

Kështu Ai i urdhëroi ata në adhurim dhe përmendi arsyen për detyrimin e tij [adhurimit] dhe arsyen për këtë nevojë. Allahu tha,

“Adhurojeni Zotin tuaj që ju krijoi juve dhe ata që erdhën para jush.” [Bekare: 31]

Domethënë, Ai krijoi ata që qenë para jush. Kështu që ju s’jeni gjë tjetër veçse një popull ndër popujt që kanë kaluar. Është vërtetuar në Sunen [traditën] që pejgamberi [salallahu alejhi ue salam] ka thënë, “Ju keni ardhur pas shtatëdhjetë popujve. Ju jeni më të mirët dhe më bujarët ndër ta para Allahut.”⁸⁸

Pra në thënien e Tij, “Ai është që ju krijoi,” pas urdhërit që të adhurohet vetëm Ai, është një sqarim që ai i cili krijoi dhe furnizoi është ai që meriton të adhurohet. Ai po ashtu sqaroi që ai i cili s’ka krijuar gjë, e as nuk ka furnizuar gjë, dhe jeta e vdekja nuk janë në duart e tij, ai s’meriton fare t’i bëhet adhurim. Kjo është çfarë është bërë nga idhujtarët në llojet e tyre të ndryshme. Kështu Çifutët adhuruan një trini; të Krishterët vepruan njëlloj. Dhe idhujtarët kanë ‘perëndi’ që s’mund të caktohen me numër, siç janë drunjtë, gurët, idhujt e modeluar, Dielli, Hëna, yjet dhe qeniet e krijuara, të cilat s’mund të

përkufizohen. Vërtet, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm i ka qortuar me thënien e Tij,

“A i merrni në konsideratë el-Lat dhe el-Uza dhe të tretin e tyre, Menatin? A mos juve u takojnë mashkujt, e Atij femrat? Vërtet, kjo është ndarja më e padrejtë!”

[Nexhm: 19-22]

88. Sahi: Transmetuar nga Ahmedî [5/2,5]; është transmetuar nga el-Hakim [nr.3001] me tjetër formulim, Ibn Maxheh [nr.4287-4288], ed-Darimi [2/404] dhe el-Bejheki [nr.17717].

89. Shënim: Përsa i përket el-Lat, Ibn Xherir ka transmetuar në Tefsirin e tij [27/58-59], “Ata e derivuan emrin e tij [el-Lat] nga emri i Allahut, kështu që thanë, ‘el-Lat,’ duke u munduar ta femërojnë, e Allahu është i Lartë dhe i pastër nga thënia e tyre.” Imam el-Buhari transmetoi në Sahi-në e tij [6/361]: nga Muslim Ibn Ibrahim i cili na e transmetoi që Ebul-Esheb na e transmetoi, që Ebul-Xheuzha na e transmetoi nga Ibn Abas [radiallahu anhumâ] në lidhje me thënien e Allahut, “A i merrni në konsideratë el-Lat dhe el-Uza?” [Nexhm: 19], “el-Lat ka qenë një njeri që bënte supë për pelegrinët.” Përsa i përket el-Uza, atëherë en-Nesai transmeton në Sunenin e tij [2/357] që kur i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] pushtoi Meken, ai dërgoi Halid Ibnul-Uelid [radiallahu anhu] tek ai [el-Uza]. Ai gjeti që ai ishte ndërtuar rreth tre drunjëve, kështu që ai i preu ata dhe e shkatërroi ndërtesën. Pastaj ai shkoi tek pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] dhe e informoi atë, por ai tha, “Kthehu, ngase s’ke bërë gjë.” Kështu ai u kthye dhe gjeti kujdestarët e idhullit duke ikur, duke thënë, “O Uza!” Halidi u afrua dhe pa një grua me flokë të shprishur, duke hedhur pluhur në kokën e saj. Kështu ai e goditi me shpatë dhe e mbyti atë, e më pas u kthye tek pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] dhe e informoi atë. E ai tha, “Ajo ishte el-Uza.”

Kjo ngase ata thonin që Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm ka vajza. Dhe sipas Arabëve, pasja e vajzave ka qenë e dënueshme.

“Dhe kur ndonjëri nga ata pranon lajmin për lindjen e vajzës, fytyra e tij nxihet dhe ai mbushet mlllef!” [Nahl: 58]

Ai [babai] do të dëshironte një mashkull, kështu që ai mlllefosej, ankohej dhe merrte armën dhe dilte për ta mposhtur armikun. Përsa i përket gruas [nënës], ata do ta keqtrajtonin dhe ofendonin atë, dhe çështja përfundonte me mbytjen e saj.

“Dhe kur të pyetet foshnja femër që është varrosur e gjallë, për çfarë mëkati është mbytur ajo?” [Tekuir: 8-9]

Kështu Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i përmendi ata me këtë dhe i qortoi për këtë, gjë e cila u përshkruhet atyre për sa i përket vajzave. Dhe Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm përmendi disa lajme në thënien e Tij,

“Ata i bënë femra engjëjt që janë robër të Mëshirshmit. A mos ishin të pranishëm ata gjatë krijimi të tyre? Dëshmia e tyre do të regjistrohet dhe ata do të merren në pyetje.”

[Zuhruf: 39]

Pra, Allahu i qortoi ata me thënien e Tij,

“Apo mos Allahu ka vetëm vajza ndërsa ju keni djem?” [Tur: 39]

Dhe Ai i qortoi ata me thënien e Tij,

“Ata kanë shpikur lidhje familiare mes Atij dhe Xhinëve, por Xhinët e dinë mirë se ata do të jenë të pranishëm.” [Saffat: 158]

Xhinët këtu janë engjëjt, ndërsa lidhja familjare [neseb] është thënia e tyre [idhujtarëve] që engjëjt janë vajzat e Allahut. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm e ka pastruar veten nga çfarëdo bashkëshorte apo bir. Pra, Ai është që krijoi, dhe Ai është që krijoi tërë krijimin e Tij në botën e tokës dhe botën e qiejve.

Më pas ai përmendi arsyen në thënien e Tij, “Që ju të bëheni të devotshëm,” ndaj Allahut duke iu bindur urdhërave të Tij dhe duke qëndruar larg nga ndalimet e Tij. Pra, për shkak të kësaj, Ai ju ka urdhëruar që ta adhuronit Atë.

Ai ju përkujton për bekimet e Tij ashtu që ju të zhvilloni *takua* [frikë] ndaj Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm duke iu bindur urdhërave të Tij, duke qëndruar larg nga ndalimet e Tij dhe duke qëndruar në këtë përderisa të jeni përbrenda fushës së veprimit. Dhe Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm i përkujtoi me diçka që mund ta njohin, e kjo është toka dhe çkado që gjindet në të nga dobitë e ndryshme. Dhe Ai shtriu tokën ashtu që njerëzit të shpërndahen nëpër të dhe që ata të mund të përmbushin nevojat e tyre me lehtësi dhe voli.

“Ai zbriti ujë nga qielli.” [Bekare: 32]

Kjo është shkak për furnizimin që është përmendur në thënien e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

“Në qiell gjindet furnizimi juaj dhe ajo që ju është premtuar.” [Dharijat: 22]

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Allahu ka thënë,

“Ai ju siguroi fruta si furnizim për ju, kështu që mos i bëni rivalë [që luten nga njerëzit] Allahut.” [Bekare: 22]

Tha Ibn Kethir [v.774H] – rahimehullahu te’ala, ‘Krijuesi i këtyre gjërave është Ai që meriton të adhurohet.’”

Komentime rreth fjalëve të Ibn Kethirit

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Kjo është një fjali e shkurtër që përmban një domethënie madhështore. Prandaj, kjo përmbledh hollësitë e çdo gjëje që ka paraprirë. Kështu që ai i cili ka krijuar këto gjëra, të cilat janë të plota në riprodhimin dhe regjistrimin e tyre këtu, Ai është që meriton adhurimin në përjashtim të të gjithë të tjerëve. Dhe Allahu e di më së miri. Paqja qoftë mbi Muhamedin, familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij.”

Mësimi i shtatë

Falënderimi i takon Allahut, dhe paqja e përshëdetjet qofshin mbi të dërguarin e Allahut.

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Llojet e adhurimit në të cilat na ka urdhëruar Allahu janë Islami, imani, dhe *ihساني*.”

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Autori – rahimehullah – përmendi ‘llojet e adhurimit.’ Kështu që ibadeti [adhurimi] është një emërtim i përgjithshëm që i referohet çdo gjëje që Allahu do dhe është i kënaqur me të nga veprat e dukshme dhe të fshehta. Në këtë definicion përfshihet çdo akt i adhurimit që të obliguarit e veprojnë nga ajo që është e detyrueshme t’i drejtohet vetëm Allahut. Autori përmendi disa lloje të adhurimit si shembull dhe model. Kështu që ai tha, ‘Islami, imani, dhe *ihساني*.’

Islami, imani, dhe *ihساني* janë shkallë të Fesë, siç gjindet në hadithin e njohur të Xhibrilit, hadithit të Umer Ibnul-Hatab [radiallahu anhu] i cili tha në të, ‘Ne ishim ulur me të dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ue selam] një ditë kur erdhi një njeri që kishte veshje skajshmërisht të bardhë dhe flokë skajshmërisht të zeza. Në të nuk shiheshin shenja të udhëtimit e as që e njihte ndokush prej nesh. Ai u ul përpara pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], i mbështeti gjunjë e tij në gjunjë e pejgamberit dhe i vendosi pëllëmbët e duarve të tij në kofshët e pejgamberit dhe tha, ‘O Muhamed! Më trego se ç’është Islami.’ Ai tha, ‘Islam është që të dëshmosh se s’ka të adhuruar me meritë pos Allahut dhe që Muhamedi është i dërguar i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin [lëmshën e detyrueshme], të agjërosh Ramazanin, të bësh Haxhin [pelegrinazhin] nëse ke mundësi për këtë.’ Ai tha, ‘Të vërtetën e ke thënë.’ Transmetuesi tha, ‘Ne habiteshim me të që ai e pyeste atë e më pas dëshmonte për vërtetësinë e tij.’ Ai tha, ‘Pra, më trego ç’është imani.’ Ai tha, ‘Kjo është që të besosh në Allahun, engjëjt e Tij, të dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit dhe të besosh në Kader [paracaktimin hyjnor] të mirën dhe të keqen e tij.’ Ai tha, ‘Të vërtetën e ke thënë.’ Ai tha, ‘Pra, më trego ç’është *ihساني*.’ Ai tha, ‘Kjo është që të besosh në Allahun sikur ta shohësh Atë. Dhe meqenëse ju nuk e shihni Atë,

vërtet, Ai ju sheh juve.’ Ai tha, ‘Më trego për Çastin.’ Ai tha, ‘Ai që është pyetur për të nuk di më shumë se pyetësi.’ Ai tha, ‘Më trego për shenjat e tij.’ Ai tha, “Robëresha do të lindë zonjën e saj. Dhe ju do të shihni barinj të zbatuar, të zhveshur e varfnjakë duke garuar në ndërtimin e ndërtesave të larta.” Dhe në fund, ai shkoi. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha, “O Umer, e a di se kush ishte pyetësi?” Unë thashë, “Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri.” Ai tha, ‘Ky ishte Xhibrili. Erdhi që t’jua mësojë Fenë tuaj.’⁹⁰

90. Transmetuar nga Muslim [1/36], et-Tirmidhi [nr.2610], Ibn Maxheh [1024] dhe Ahmed [1/7, 25, 27, 53].

Ç’është adhurimi dhe kush është i ngarkuar me të?

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] i konsideroi këto tre shkallë: Islamin, imanin, dhe *ihsanin* të jenë shkallë të Fesë pasi ato përfshijnë tërë Fenë. Dhe pa dyshim që këto shkallë kërkojnë elaborim të mëtejshëm: shpjegim të shtyllave të Islamit, shpjegim të shtyllave të imanit dhe shpjegim të shtyllave të *ihsanit*. Kështu që shkrova lidhur me këto një libër të qartë e konciz me anë të pyetje-përgjigjeve. Kjo përfshihet në studimet e Silsiletul-Exhuibetus-Sedideh, dhe kjo është pyetja e dytë, “Ç’është el-ibadeh [adhurim] dhe kush është i obliguar me të?

Adhurimi [el-ibadeh] është një emërtim i përgjithshëm për çdo gjë që Allahu do dhe është i kënaqur me të nga thëniet, qofshin ato të bëra haptas apo fshehurazi. Dhe ai që është i ngarkuar me bërjen e ibadetit me anë të detyrimit [wuxhub] apo parapëlqimit [istihbab] në pajtim me urdhërin hyjnor, është ai që është mukallif [i ngarkuar] i arsyeshëm nga bota e njerëzimit dhe Xhinëve, siç thotë Allahu i Lartësuar,

“Ata s’qenë të urdhëruar përveç që ta adhurojnë Allahun duke e praktikuar Fenë sinqerisht vetëm për Të, duke falur namazin dhe duke dhënë zekatin [lëmoshën e detyruar], se kjo është Feja e drejtë.” [Bejjine: 5]

Dhe kjo është pasuar me pyetjen e tretë dhe është siç vijon:

Çka është Teuhidi, cilat janë kategoritë e tij dhe cili është shpërblimi i atij që e praktikon atë në këtë jetë dhe në Jetën e Përtejme?

Çka është Teuhidi, cilat janë kategoritë e tij dhe cili është shpërblimi për atë që e praktikon atë në jetën e kësaj bote dhe në Jetën e Përtejme?

Teuhid është që të veçohet Allahu me adhurim dhe të mos i bëhet Shirk Atij, në format e vogla dhe të mëdha, qoftë ai i bërë pakë apo me tepri. Dhe, kjo përfshin distancimin e vetvetes nga njerëzit e Shirkut, siç ka thënë Allahu i Lavdëruar,

“Thuaj: Vërtet, namazi im, sakrifica [kurbani] ime, jetesa ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botrave. Ai s’ka ortakë, dhe me këtë unë jam urdhëruar dhe unë jam i pari nga muslimanët.” [En’am: 162-163]

Përsa u përket kategorive të Teuhidit, ato janë tre:

E para: Teuhidul-Uluhije [Njësia e hyjnisë së Allahut]

E dyta: Teuhidur-Rububije [Njësia e zotërimit të Allahut]

E treta: Teuhidul-Esma ues-Sifat [Njësia e Emrave dhe Cilësive të Allahut]

Teuhidul-Uluhije është që të veçohet Allahu me të gjitha llojet e adhurimit dhe atë që shpjeguesi i përmendi si shembuj të kësaj.⁹¹

Teuhidur-Rububije është që të pohosh se Allahu është er-Razik [Furnizuesi], el-Muhji [i Përrjetshmi], el-Mumit [Prurës i Vdekjes], rregullues i të gjitha çështjeve dhe ai që kontrollon gjithçka në univers. Ai nuk pyetet për atë çfarë bën, por ata do të pyeten. Teuhidul-Esma ues-Sifat është besimi i fortë e i patundur [itikad] që Allahu ka Emra dhe Cilësi Fisnike. Dhe, këta Emra duhet të pohohen pa *tehrif* [shtrembërim], pa *te’til* [mohim], pa *teshbih* [ngjasim], pa *tekjif* [të pyeturit si], dhe pa *temthil* [krahasim]. Më saktë, ne themi ashtu siç ka thënë Allahu i Lartësuar,

“Asgjë s’është si Ai, Ai është që dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.” [Shura: 11]

Përsa i përket shpërblimit të Teuhidit në këtë jetë, kjo është ruajtja e gjakut, pasurisë, nderit dhe jeta e sigurt si dhe paqja e shpirtit [tame’nineh]. Përsa i përket shpërblimit të *muwehidinëve* [ata që pohojnë Teuhidin] në Jetën e Përtejme, kjo do të jetë kenaqësia e Allahut, parajsa dhe shpëtimi nga neveria dhe Zjarri i Tij. Kurse shumë më e mirë se kjo do të jetë kenaqësia e shikimit të Fytyrës Fisnike të Allahut. Kjo është arritja më e madhe.⁹²

Shkalla e parë: Islami

Ne jemi duke diskutuar atë çfarë autori – rahimehullah – ka përmendur nga shkallët e fesë. Pra, ai përmendi shkallën e parë, e kjo është Islami. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] shpjegoi shtyllat e Islamit në hadithin e Xhibrilit [alehijs-selam]. Student i diturisë ka nevojë që t’i njohë hollësisht shtyllat e Islamit, shtyllat e imanit dhe shtyllat e *ihsanit*, së bashku me dëshmitë që sqarojnë secilën shtyllë. Pra, ja ku është pyetja në lidhje me shtyllat e Islamit, domethënien e secilës shtyllë nga ato dhe përmendja e disa nga frytet e saj. Përgjigja është siç qëndron në hadithin për shtyllat e Islamit. Pra, ato janë pesë: [i] të

dëshmuarit që askush s' meriton të adhurohet pos Allahut dhe që Muhamedi është i dërguari i Allahut; [ii] falja e namazit; [iii] dhënia e zekatit; [iv] agjërimi në Ramazan; [v] dhe pelegrinazhi [Haxhi] në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut për këdo që ka mundësi për këtë.

Përsa i përket domethënies së dëshmisë se askush s' meriton të adhurohet pos Allahut, kjo mohon çdo gjë që adhurohet përveç Allahut ndërsa pohon të gjitha format e adhurimit për Allahun. Pra, këto dy domethënie janë dy shtyllat e 'La ilahe ilallah'; mohimi [en-nefi] dhe pohimi [el-itibat].

91. Siç është *du'aja* [lutja], *kheuf* [frika], *rexha* [shpresa], *teukul* [mbështetja], *regbeh* [dëshira e zjarrtë], *rehbeh* [tmerri], *khushu* [nënshtrimi], *kheshjeh* [frikë e përzier me nderim], *inabeh* [kthimi me pendim], *isti'aneh* [kërkimi i ndihmës], *isti'adheh* [kërkimi i mbrojtjes], *istighatheh* [kërkimi i përkrahjes], *dhebh* [sakrifica], *nedhr* [betimet] dhe tjetër pos kësaj nga llojet e adhurimit në të cilat na ka urdhëruar Allahu.

92. Referoju el-Exhuibetus-Sedideh [1/7-9] të autorit.

Mohimi është marrë nga thënia e juaj, '*la ilahe* [askush s' meriton të adhurohet],' ndërsa pohimi është marrë nga thënia e juaj, '*ilallah* [përveç Allahut].' Përsa i përket domethënies së dëshmisë që Muhamedi është i dërguari i Allahut, kjo është që ai të dëgjohet për çkado që urdhëron dhe të vërtetohen të gjitha çështjet për të cilat ai na ka informuar. Pra, *mutabe'eh* [ndjekja] e pejgamberit fisnik [salallahu alejhi ue selam] është e kufizuar në atë që Allahu na ka urdhëruar në thënien e Tij,

"Bindjuni Allahut dhe bindjuni të dërguarit. E nëse ju ia ktheni shpinën, atëherë e vetmja gjë që i takon të dërguarit është bartja e porosisë." [Teghabun: 12]

Njëlloj, Allahu i Lavdëruar na ka urdhëruar që ta ndjekim atë në çdo çështje. Dhe për këtë është e lidhur udhëzimi dhe suksesi. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm ka thënë,

"Ndjekeni atë që të udhëzoheni." [A'raf: 158]

Frytet e shtyllës së parë – të dëshmuarit që askush s' meriton të adhurohet përveç Allahut dhe që Muhamedi është i dërguar i Allahut

Së pari: Nga frytet e kësaj shtylle madhështore, që është të dëshmuarit që askush s' meriton të adhurohet përveç Allahut dhe që Muhamedi është i dërguari i Allahut, është çlirimi i zemrës dhe shpirtit nga të qenit i lidhur me krijimin dhe mbështetja në ta për sjelljen e të mirave dhe largimin e të këqijave.

Së dyti: Lumturia në *darejn* [jetën e kësaj bote dhe Jetën e Përtejme]. Prandaj, s’ mund të ketë lumturi për qenien njerëzore në këtë jetë, berzekhun e tij [gjendje ekzistence mes jetës së tanishme dhe Jetës së Përtejme] dhe Jetës së Përtejme, përveç nëse ai e praktikon Islamin në mënyrën e dëshiruar nga Allahu, mënyrë e cila është shpjeguar nga i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam].

Domethënia e es-salat [namazit] në gjuhën Arabe dhe në Sheriat

Përsa i përket domethënies së namazit [es-salat] në gjuhën Arabe, ajo është ed-du’a [lutja], siç ka thënë Allahu,

“Dhe lutu [sal-li] për ta.” [Teube: 103]

Domethënë, lutu [ud’u] për ta. Ndërsa në Sheriat: kjo është që të adhurosh Allahun me veprimin fizik të namazit të shoqëruar me qëllim të pastër në mënyrën e sqaruar nga i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam], nëpërmjet veprave dhe thënieve të tij kur ai tha, “Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur.”⁹³ Pra, kjo është një grupazh thëniesh, veprash dhe punësh që nisin me tekbirin [të thënit Allahu Ekber] dhe mbarojnë me teslim [të dhënit selam]. Dhe kjo është shtylla më madhështore e Islamit pas shehadetejn. Kjo ka edhe fryte, ndër to:

Frytet e shtyllës së dytë – es-Salat

Së pari: Zgjerimi i gjoksit, siç gjindet në thënien e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], “O Bilal, na qetëso me namaz.”⁹⁴

Së dyti: Kjo ka qenë qetësim për pejgamberin [salallahu alejhi ue selam] dhe për të gjithë ndjekësit e tij për shkak të dëshmisë së thënies së pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], “Në namaz unë qetësohem.”⁹⁵ dhe ngjashëm, nga frytet dhe dobitë e tij është që ai e largon njeriun nga gjërat e turpshme [fehsha] dhe e keqja, siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm,

“Vërtet, namazi e largon njeriun nga gjërat e turpshme dhe nga e keqja.” [Ankebut: 45]

Domethënia e ez-zekat në gjuhën Arabe dhe në Sheriat

Përsa i përket domethënies së zekatit [lëmoshës së detyrueshme], e kjo është shtylla e tretë dhe e shoqëron namazin shprehur në gjuhën Arabe: kjo është shtim dhe pastrim. Ndërsa sipas Sheriatit: Kjo është që të adhurosh Allahun duke nxjerr një sasi të caktuar

të pasurisë dhe një pjesë të caktuar të pasurisë për një grup të veçantë që është kufizuar nga Ligjvënësi i Urtë. Ndër frytet e imanit në këtë shtyllë janë:

Frytet e shtyllës së tretë – ez-zekat

Së pari: Pastrimi i shpirtit nga vesi i koprracisë dhe lakmisë. Prandaj, këto janë karakteristika të qortuara sipas çdo Sheriati ndër *Shera'i* [shumësi i Sheriatit] të Allahut.

Së dyti: Shtim në pasurinë e pastruar. Pra, pasuria nuk shteret për shkak të sadakasë [lëmoshës]. Madje, ajo shtohet.

93. Transmetuar nga el-Buhari [nr. 631, 6007] dhe ed-Darimi [nr.1253]

94. Transmetuar nga Ahmed në el-Musned [5/364, 371], dhe diçka e ngjashme është transmetuar nga et-Teberani në el-Kebir [6/276-277] dhe në Mexhme'uz-Zeua'id [1/145].

95. Hasan: Transmetuar nga Ahmed [3/123, 128, 199, 285], en-Nisa'i [nr. 8887-8888] nga Enes [radiallahu anhu]. Është shpallur Hasan nga Imam el-Albani në Mishkatul-Mesabih [nr.5261].

Domethënia e es-seum në gjuhën Arabe dhe në Sheriat

Përsa i përket domethënies së agjërimit në gjuhën Arabe: kjo është të përmbahesh nga një gjë e caktuar. Ndërsa sipas Sheriatit: kjo është të përmbahesh nga gjërat që e ndërpresin agjërimin gjatë ditëve të Ramazanit si adhërim i Allahut dhe në pajtim me urdhërat e Tij.

Frytet e shtyllës së katërt: es-seum

Kjo ka fryte madhështore dhe njëherit është përgatitje e trupit për të lënë gjërat e dashura dhe të zakonshme, duke kërkuar me këtë kënaqësinë e Allahut dhe pasja e qëllimit për kërkimin shpërblimit për këtë në Ditën e Gjykimit.

Domethënia e Haxhit në gjuhën Arabe dhe në Sheriat

Përsa i përket haxhit [pelegrinazhit] sipas gjuhës Arabe: kjo është të ndërmarrësh një udhëtim. Ndërsa në Sheriat: kjo është të udhëtohet për në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut për të kryer ritualet e Haxhit dhe për të zbatuar të gjitha shenjat e jashtme të tij. Kjo ka fryte të ndryshme, ndër to:

Frytet e shtyllës së pestë – el-haxh

Së pari: Përgatitja e shpirtit për t'u përpjekur me pasurinë e vet në rrugë të Allahut, nga që haxhi është nga rrugët e Allahut.

Së dyti: Sakrifica e shpirtit me të gjitha aktet e bindjes ndaj Allahut.

Për më tepër, zbatimi fizik i këtyre bazave [usul] të mëdha në ditët e sotme përbën të gjithë korrigjimin dhe suksesin e Umetit të Muhamedit në të gjitha çështjet e Fesë dhe Jetës së Përtejme. Pra, le t'i frikësohet robi Zotit të Tij dhe t'i praktikojë ato. Këto janë bazat e Fesë, dhe këto garantojnë ruajtjen e gjakut, pasurisë dhe nderit. Dhe, këto e përbëjnë çelësin kryesor për hyrje në mbrojtjen e nderit, siç është nderi i qiejve dhe tokës, i cili është përgatitur për ata që besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij [salallahu alejhi ue selam]. Kjo është mirësi e Allahut; Ai ja jep atë kujt të dojë, dhe Allahu është Posedues i të mirave të mëdha.⁹⁶

Shkalla e dytë – el-iman

Autori – rahimehullah – përmendi që imani është nga llojet e ndryshme të adhurimit. Imani është një shkallë madhështore ndër shkallët e Fesë.

96. Referoju el-Exhuibetus-Sedide [1/10-13] nga autori.

Imani ka gjashtë shtylla, siç është përmedur nga peygamberi [salallahu alejhi ue selam] në hadithin e njohur të Xhibrilit [alejhis-selam], e kjo është, “Të besosh në Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe që të besosh në el-Kader [paracaktimin hyjnor], që e mira dhe e keqja e saj janë nga Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar.”⁹⁷

Shtylla e parë – imani në Allahun, domethënia dhe frytet e kësaj

Pra secila shtyllë nga këto gjashtë shtylla ka një domethënie që duhet kuptuar. Kështu që përsa i përket domethënies së imanit [besimit] në Allahun e Fuqishëm dhe të Madhërisëm, kjo është që të dëshmosh për ekzistencën e Tij, të pohosh qartë Rububijetin [zotërimin] e Tij dhe të pranosh haptas dhe në të fshehtën Uluhijetin [hyjninë] e Tij. Kjo po ashtu është që të kesh iman në mënyrën e duhur në Emrat dhe Cilësitë e Tij fisnike, dhe të zbatohet kjo me një zbatim të bazuar në dituri në jetën e sotme, siç do Allahu dhe siç e ka ligjëruar i dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam]. Kjo është siç ka thënë Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërisëm,

“I tillë është Allahu, Zoti juaj. Askush s’meriton të adhurohet përveç Tij, Krijuesi i çdo gjëje. Pra, adhurojeni Atë; Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi.” [En’am: 102]

Allahu i Lavdëruar ka thënë,

“Zoti juaj është një Zot. Askush s’meriton të adhurohet përveç Tij, Mëshirëploti, Dhuruesi i Mëshirës.” [Shura: 11]

Nga frytet e imanit në Allahun është: Çlirimi i shpirtit nga robërimi ndaj të tjerëve pos Allahut ndër perënditë e rrejtme së bashku me llojet e ndryshme të tyre dhe adhurimi i sinqertë ndaj Allahut në përjashtim të të tjerëve.

Shtylla e dytë – imani në engjëjt, domethënia dhe frytet e kësaj

Përsa i përket domethënies së imanit në engjëjt [mela’ikeh], që është shtylla e dytë nga shtyllat e imanit, kjo është që të dëshmosh për ekzistencën e tyre. Po ashtu kjo është që të dëshmosh se ata janë ndër krijesat më madhështore të Allahut. Allahu i ka krijuar ata dhe i ka bërë të anojnë nga bindja ndaj Tij. Pra, nuk ka mundësi për ta që ta kundërshtojnë urdhërin e Tij. Vërtet, Allahu i ka lënë ata përgjegjës për detyra të rëndësishme, të cilat s’mund të zbatohen përveç nga ata. Kështu që ndër ta është ai që e zbret shpalljen.

97. Transmetuar nga Muslim [1/36], et-Tirmidhi [nr.2610], Ibn Maxheh [1/24] dhe Ahmed [1/7, 25, 28, 53]

Ndër ta po ashtu është edhe ai që e zbret shiun dhe i bën bimët të mbijnë. Ndër ta është ai që mbron fëmijët e Ademit [alejhisselam] nga çështjet e këqija e të neveritura, dhe tjetër pos kësaj nga ajo që na është e njohur dhe nga ajo që nuk e njohim.

“Dhe askush nuk di për ushtrinë e Zotit tënd, përveç Tij.” [Mudeththir: 31]

“Ata s’janë veçse robër të ndershëm. Ata nuk i paraprijnë Atij në të folur dhe ata veprojnë në pajtim me urdhërat e Tij.” [Enbija: 26-27]

Imani në këtë shtyllë ka fryte madhështore, ndër to:

[1] Dituria mbi Madhëstsinë e Krijuesit, të Lavdëruarit, fuqinë e Tij, ndikimin dhe pushtetin kur Ai krijoi krijimin e Tij, gjë që s’mund të vlerësohet apo numërohet nga njerëzimi. E, këta janë engjëjt.

[2] Falënderimi i robit ndaj Zotit të tij për atë që Ai i ka dhuruar nga *terbijetul-ameh* [mirëmbajtja e përgjithshme] dhe *terbijetul-khaseh* [mirëmbajtja e veçantë] si dhe

interesimin përshirës. Vërtet, Ai ka rregulluar çkado që është në qiell dhe çkado që është në tokë, dhe pjesë e kësaj janë engjëjt së bashku me detyrat e ndryshme të rëndësishme të tyre dhe shkallët e larta. Pra, ata [engjëjt] e mbrojnë robin nga çdo çështje e keqe dhe e neveritur. Ata kërkojnë falje për njerëzit e imanit dhe i shkruajnë veprat, të mirat dhe tjerat pos këtyre nga detyrimet me të cilat i ka ngarkuar Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar.

[3] Detyrimi i dashjes së Engjëjve, nga që ata janë ndër krijesat më të sinqerta të Allahut, siç ka thënë në lidhje me ta Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar,

“Ata që mbajnë Fronin dhe ata përreth tij e lavdërojnë Zotin e tyre dhe ata që besojnë në Të dhe kërkojnë falje për ata që besojnë, “Zoti ynë! Ti përfshin çdo gjë në mëshirë dhe dituri, pra fali ata që pendohen dhe që ndjekun rrugën Tënde, dhe shpëtoji ata nga tortura e Zjarrit që flakëron!” “Zoti ynë, futi ata në kopshtet e Adnit, të cilat janë përgatitur për ta dhe këdo që është i drejtë ndër etërit e tyre, bashkëshortë[e]t e tyre dhe fëmijët e tyre. Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi, i Urti. “Dhe shpëtoji ata nga mëkatet, dhe atë që Ti e shpëton nga mëkatet në atë ditë, atij i është dhuruar mëshirë.” E ky është sukcesi më i madh.” [Gafir: 7-9]

Shtylla e tretë – imani në Librat dhe domethënia e kësaj

Përsa i përket domethënies së imanit në Librat, kjo është besimi i patundur që ato janë shpallur nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar. Ai i foli ato si një thënie, dhe ua shpalli ato të dërguarve të Tij si shpallje, dhe për ato dëshmuar ata që patën iman të vërtetë në të dërguarit e Tij. Vërtet, Allahu ka urdhëruar tërë Umetin e Muhamedit që haptas të tregojnë imanin e tyre – së jashtmi dhe së brendshmi – në çkado që Ai u shpalli pejgamberëve të Tij të mëhershëm kur Allahu i Lavdëruar ka thënë,

“Thuaj, Ne besojmë në Allahun, atë që na është zbritur neve dhe atë që i është zbritur Ibrahimit, Isma’ilit, Is’hakut, Jakubit, dhe *el-Esbet* [dymbëdhjetë bijve të Jakubit], dhe në atë që i është dhënë Musait dhe Isait, dhe në atë që u është dhënë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë dallim mes tyre, dhe Atij i jemi nënshtruar.” [Bekare: 136]

Shtylla e katërt – imani në të dërguarit, domethënia dhe frytet e kësaj

Përsa i përket domethënies së imanit në të dërguarit, kjo është besimi që s’ka dyshim se Allahu dërgoi lajmëtarë si prurës të lajmeve të mira dhe si paralajmërues, që njerëzit të mos kenë argument kundër Allahut pas të dërguarve. I pari ndër ta ishte Nuhu [alejhislam] kurse i fundit ishte Muhamedi [salallahu alejhi ue selam]. Kështu që kushdo që i merr ata si shembull dhe i përgjigjet thirrjes së tyre, ai është i udhëzuar; ndërsa kushdo

që e refuzon porosinë e tyre dhe i mohon ata, ai është i devijuar dhe i humbur, siç ka thënë Allahu i Lartësuar,

“Ata që besuan në Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe nuk bënë dallim mes tyre, këta janë ata që do të shpërblehen. Allahu është Falës, Dhurues i Mëshirës.” [Nisa: 152]

Imani në të dërguarit ka dobi të mëdha dhe fryte madhështore, ndër to:

[1] Njohuri bindëse mbi mëshirën e Allahut, të Gjithfuqishmit, Dhuruesit të Mëshirës, i cili nuk i ka lënë krijimin që të varen vetëm në intelektet e tyre. Madje, Ai u dërgoi lajmëtarë dhe u shpalli Libra atyre.

[2] Konsiderimi i porosive të tyre si bekime të mëdha që Allahu u ka dhuruar robërve të Tij në çdo kohë dhe vend.

[3] Dashuri ndaj këtyre të dërguarve bujarë, njerëzve të këshillës së mirë, singëritetit, besnikërisë dhe vërtetësisë.

Shtylla e pestë – imani në Ditën e Fundit, domethënia dhe frytet e kësaj

Përsa i përket domethënies së imanit në Ditën e Fundit, ky është vërtetim i ndërtuar mbi dituri e cila nxjerret nga Libri i Zotit tonë dhe Suneti i pejgamberit tonë Muhamed [salallahu alejhi ue selam] që Allahu do ta ringjallë krijimin pas vdekjes së tyre. Pastaj, Ai do t'i mbledhë ata së bashku për një ditë për të cilën s'ka dyshim [që do të vijë]. Dhe çdonjërit do t'i jepet shpërblimi për veprat e tij.

“Kushdo që bën mirë sa grimca do ta sheh atë; kushdo që bën keq sa grimca do ta sheh atë.” [Zelzeleh: 7-8]

Dhe kushdo që e mohon këtë ditë, apo ndonjë gjë që do të ndodhë përbrenda saj nga *Sirat* [Ura], *Mizan* [Peshorja], *Haud* [Pellgu], Parajsa, Zjarri, shpërblimi për veprat e njeriut dhe tjetër pos kësaj nga çkado që dihet nga Sheriati me doemos, ai ka devijuar nga Rruga e Drejtë, nga Suneti dhe *ixhma* [marrëveshja e përgjithshme] e muslimanëve. Imani në këtë i ka dobitë e veta, ndër to:

[1] Garimi në bërjen e veprave të mira dhe dëshira për të arritur veprat e mira nga thënie, veprat dhe besimet. Dhe përse ky garim, përveç nga që bërësi shpreson për një shpërblim, i cili i është premtuar atij në shpalljen e qartë e të urtë [mushkemut-tenzilil-hakim] dhe Suneti i pastër.

[2] Përmbajtja nga mosbindja në thënie dhe vepra, qofshin ato të bëra publikisht apo në të fshehtë. Prandaj, kur të ndodhë mosbindja, kjo bëhet shkak për dënimin e Allahut me të cilin janë kërcënuar mëkatarët e pabindur. Ata janë që kanë shkelur kufijtë e Allahut dhe ata që i kanë lënë pas dore detyrat ndaj Tij dhe ata që e kthyen shpinën nga ajo që u soll nga të dërguarit. Pra, mu në këtë gjindet sukcesi po që se ata besojnë dhe mbesin të

qëndrueshëm në të.

Shtylla e gjashtë – Imani në el-Kader, domethënia dhe frytet e kësaj

Përsa i përket imanit në Kader, kjo është besimi i patundur që i gjithë universi, pjesët e sipërme dhe të ulta të tij, pjesët e plota dhe të pjesshme të tij, krijesat e tija folëse dhe të heshtura, krijesat e tija lëvizëse dhe të qëndrueshme të gjitha drejtohen nga Kaderi i Allahut. Allahu i përfshin ato në fazat e tyre të paraekzistencës. Dhe ato do të ndodhin në kohërat dhe vendet e tyre të kufizuara dhe me cilësi të veçanta në pajtim me atë që është caktuar për ta në përjetësi. Imani në Kader ka katër shkallë:

Shkallët e besimit në el-Kader

E para: Imani [besimi] që dituria e Allahut përfshin çdo gjë.

E dyta: Imani në Librin [dmth el-Leuhul-Mehfudh, Pllaka e Ruajtur] e Allahut e cila nuk ka lënë asgjë jashtë [pa shënuar].

E treta: Imani në dëshirën zbatuese të Allahut dhe fuqinë e Tij gjithpërfshirëse. Kështu që çkado që Allahu dëshiron të ekzistojë, kjo pashmangshëm do të ekzistojë me fuqinë e Tij.

E katërta: Imani që Allahu ka krijuar çdo gjë.⁹⁸

Dëshmitë për pasjen e imanit në këtë shtyllë madhështore janë të shumta në Libër dhe Sunet. Askush nuk i mohon këto, përveç mosbesimtarit, dhe askush nuk i shpjegon ato pa shpjegim të saktë, përveç të paditurit apo atij që pretendon të jetë i paditur. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishtëm ka thënë,

“Ai ka krijuar çdo gjë dhe e ka matur atë saktësisht sipas matjeve përkatëse.” [Furkan: 2]

Është vërtetuar në Sahi Muslim⁹⁹ nga Abdullah Ibn Amr Ibnul-As¹⁰⁰ [radiallahu anhu] të ketë thënë, ‘Kam dëgjuar të dërguarin e Allahut [salallahu alejhi ue selam] duke thënë, ‘Vërtet, Allahu shkroi vendimet e krijimit pesëdhjetë mijë vite para se t’i ketë krijuar qiejt dhe tokën.’¹⁰¹ Dhe ka edhe shumë transmetime tjera të ngjashme.

Pra, nga këto tekste të qarta, besimtarit që është i vërtetë në imanin e tij i bëhet e dukshme që çdo lëvizje e vullnetshme dhe e pavullnetshme e krijimit nuk ndodh jashtë vullnetit [iradeh] të Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Më saktë, çdo gjë që ndodh në pjesën e epërme apo të ulët të tokës nga jeta, vdekja, shëndeti, sëmundja, skamja, pasuritë, jetëgjatësitë e shkurta apo të gjata të gjitha janë për një afat të caktuar. Ndërsa koha e tyre, vendi, shkaku, fatkeqësia, lumturia, shpresa, ashpërsia, vështirësia, lehtësia, mosbesimi, imani, mirësia dhe e keqja të gjitha i nështrohen tekdirimit [paracaktimit] të

përjetshëm të Allahut. Kjo është regjistruar nga *Kalemi* [Pena] të cilën e krijoi Allahu dhe e urdhëroi që të shkruajë vendimin e çdo gjëje gjer në Ditën e Kijametit. Kështu që s'ka çështje ndër çështjet, e as ngjarje ndër ngjarjet, përveç të ketë kaluar nëpërmjet Penës [Kalem] në atë kohë, gjer në ndodhjen e Çastit. Kjo nuk kërkon që robërit të mbështetën në çkado që është shkruar e ta lënë bërjen e veprave pasi kjo do të nënkuptonte paaftësi dhe devijim nga direktivat Kur'anore dhe këshilla e të dërguarit të sinqertë e besnik. Pra, nuk ka ikje nga të vepruarit dhe përpjekja për të arritur të mirën e tokës dhe qiejve, dhe kjo do të jetë shkak i fortë për hyrje në kopshtet e parajsës dhe ndenjësën në një nga gradat më të larta dhe më të bukura.

98. Referoju librit el-Hejat fi Dhilil-Akidetil-Islamije [f.64] nga autori.

99. Ai është Ebul-Hasan Muslim Ibnu-Hexhaxh el-Jushejri en-Nejsaburi, autor i Sahi-së dhe një nga Imamët e mbamendjes. Ai ishte një nga muhadithinët më të shquar. Ai u lind në vitin 260H, dhe vdiq në vitin 315H në moshën pesëdhjetë e pesë vjeçare. Referoju Tekribut-Tehdhib [2/178].

100. Ai është Abdullah Ibn Amr Ibnul-As Ibn Ua'il Ibn Hashim Ibn Se'id, me *tesghir* [diminutivin] Ibn Se'd, Ibn Sehm es-Sehmi, Ebu Muhamed. Është thënë që ai ishte Ebu Abdur-Rahman. Ai ishte një nga Shoqëruesit e hershëm, i cili mësoi përmendsh shumë transmetime dhe ishte një ndër *fukahatë* nga *Abadileh*. Ai vdiq gjatë një nga netët e Dhul-Hixheh në el-Hurreh, apo më saktë në et-Ta'if. Referoju Tekribut-Tehdhib [1/517].

101. Transmetuar nga Muslim [nr.2653]

Vërtet, në hadithin që transmetohet nga Ahmed dhe të tjerët, nga Umer Ibnul-Hatab [radiallahu anhu], qëndron se ai i ka thënë pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], "A nuk sheh që veprat bëhen kot, apo a urdhëron që ato të bëhen?" Ai tha, "Ato nuk bëhen kot." Kështu që Umer [radiallahu anhu] tha, "Atëherë, a nuk duhet që ne të mbështetemi?" Ai tha, "Punoni, O Ibnul-Hatab! Se çdo gjë do të jetë e lehtë. Përsa i përket atij që është ndër njerëzit e lumturisë, ai do të bëjë vepra që çojnë në lumturi; dhe kushdo që është ndër njerëzit e pafatë, ai do të bëjë vepra të njerëzve të pafatë." **102** Në një tjetër transmetim qëndron që Umer ka thënë, "Tash do të përpiqemi shumë, O i dërguar i Allahut!"

Frytet e imanit në el-Kader

Dhe nga frytet e imanit në el-Kader, të mirën dhe të keqen e saj, të ëmbëlën dhe të hidhurën e saj, janë këto në vijim:

[1] Mbështetja në Allahun dhe dorëzimi i të gjitha çështjeve Atij, nga që Ai është dhurues i jetës, përmbushës i nevojave, heqës i shqetësimit dhe Ai është që kontrollon të gjithë krijimin e Tij me çkado që Ai dëshiron dhe si të dojë.

[2] Qëndrimi larg dhe të qenit i paralajmëruar ndaj mahnitjes me atë që mund të arrihet nga qenia njerëzore në lidhje me nevojat e Fesë dhe jetës së kësaj bote. Kështu që personi s'duhet t'i përkushtohet arritjes së të gjitha gjërave të dashura dhe largimit të çdo të

keqeje. Kjo është vetëm një bekim nga paracaktimi i Zotit që është i Urtë dhe Mirinformuar. Pra, le ta lavdërojë rob i Allahun për gjithë këtë.

Shkalla e tretë – *el-ihsan*

Shkalla e fundit ndër shkallët e Fesë, me të cilën ne do ta përfundojmë mësimin tonë, është shkalla e *el-ihsan* e cila është shpjeguar nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] nëpërmjet thënies së qartë, “*Ihsan* është që të adhurosh Allahun sikur ta shohësh Atë. Dhe meqenëse ju nuk e shihni Atë, vërtet, Ai ju sheh juve.’

Domethënia e kësaj është që ju të adhuronit Zotin tuaj ndërsa jeni në prani të madhësisë së Tij dhe Ai është afër jush. Dhe, ju duhet që të reflektoni për Të në çdo gjendje. Kjo është çfarë e bën të domosdoshme frikë-respektin [keshjeh] dhe zmadhimin [te’dhim] e Zotit tuaj. Në këtë pikë, ju s’do të leni gjë mangut në dëgjueshmëri e as që do të bëni ndonjë mosbindje nga madhërimi që i bëni Allahut – qoftë i lavdëruar Ai në lartësinë e Tij – dhe frika nga Ai. Dëshmi për këtë është thënia e vërtetë e Allahut të Lavdëruar,

“Dhe bëni mirë. Vërtet, Allahu i do bëmirsit.” [Bekare: 195]

Po ashtu në një thënie të pejgamberit [salallahu alejhi ue selam] qëndron “Vërtet, Allahu shkroi përsosuri [ihsan] për çdo gjë.”¹⁰³

Paqja dhe përsëritjet e Allahut qofshin mbi pejgamberin tonë Muhamed, mbi familjen e tij dhe mbi Shoqëruesit e tij.

102. Hasan Sahih: Transmetuar nga Ahmed [nr.441] dhe et-Tirmidhi [nr.2135-2136]. Në hadith i ngjashëm është transmetuar nga el-Buhari [nr.6217].103. Hasan Sahih: Transmetuar nga Ahmed [4/123-125], et-Tirmidhi [nr.1409] dhe ai tha se është hasan sahih. Kjo po ashtu është transmetuar nga en-Nisa’i [nr.4494], Ibn Maxheh [nr.3170] dhe ed-Darimi [nr.1970].

Mësimi i tetë

Falënderimi i takon Allahut dhe paqja e mëshira qofshin mbi të dërguarin e Allahut. Më tej:

Llojet e adhurimit

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, “Ndër këto është *ed-du’a* [lutja], *el-kheuf* [frika], *er-rexha* [shpresa], *et-teuekul* [mbështetja], *er-regbeh* [dëshira e zjarrtë], *er-rehbeh* [tmerri], *el-khushu* [nënshtrimi], *el-kheshjeh* [përlulja], *el-inabeh* [kthimi me pendim], *el-isti’aneh* [kërkimi ndihme], *el-isti’adhe* [kërkimi strehimi], *el-istigatheh* [kërkimi shpëtimi], *edh-dhebh* [sakrifica] dhe *en-nedhr* [bërja e betimit].”

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, “Vërtet, ai e përmendi në mësimin e mëhershëm hadithin në lidhje me përcaktimin e Islamit së bashku me pesë shtyllat e tija, përcaktimin e imanit së bashku me gjashtë shtylla e tija dhe përcaktimin e *ihsanit* së bashku me shtyllën e tij të vetme. Krahas kësaj ne shpjeguam disa nga dëshmitë, të cilat përmenden në Libër dhe Sunet, që shpjegojnë shtyllat e Islamit, imanit dhe *ihsanit*.

Autori – rahimehullah – përmendi këtu disa shembuj nga llojet e adhurimit që në të vërtetë konsiderohen të jenë pjesë të adhurimit në Islam, gjë që përshin të gjitha llojet e ndryshme të adhurimit. Është sikurse ka thënë Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar,

“Vërtet, Feja e pranuar te Allahu është Islami.” [Ali-Imran: 19]

Ai e vijoi këtë me iman dhe *ihsan*. Këto janë tre shkallët që përbëjnë tërësinë e Fesë siç është përmendur më herët. Nuk ka ndonjë lloj ndër llojet e ndryshme të adhurimit që përjashtohet nga këto tre shkallë, e as që ka ndonjë çështje ndër çështjet e Fesë që përjashtohet nga këto. Më saktë, çdo akt i adhurimit dhe çdo çështje ndër çështjet e ndryshme të Fesë Islame hyn në Islam, iman dhe *ihsan*.

Autori elaboroi duke dhënë shembuj për aktet e adhurimit. Këta shembuj u shpjeguan hollësisht pasi u përmendën përgjithësisht. Kështu që nga llojet e ndryshme të adhurimit që ai përmendi ishte: *ed-du’a* [lutja].

ed-Du’a

ed-Du’a është e ndarë në dy kategori: [i] *du’aja* e adhurimit dhe [ii] *du’aja* e lutjes/kërkimit. Dhe të dyja këto hyjnë në thelbin e adhurimit.

[1] Pra, *dua’ja* e adhurimit është që t’ia drejtosh çdo akt të adhurimit, qoftë kjo e lidhur me pasurinë personale apo trupin apo të dyja këto së bashku, vetëm Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Kjo duhet të bëhet në mënyrën e cila është në pajtim me Sheriatin e pastër të Allahut dhe urdhërat e Tij të drejtë. Në nisje të këtij lloji të adhurimit është Teuhidi i Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, siç është dëshmuar nga thënia e vërtetë,

“Unë nuk i kam krijuar Xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”

[Dharijat: 56]

Domethënë që ata të më veçojnë Mua me diturinë se Teuhidi i robit s'mund të plotësohet, përveç duke e liruar veten nga Shirku, që është e kundërta e Teuhidit. Kjo ngase kur ne ta njohim Teuhidin me kuptimin Sheriatik të tij, ne themi, 'Kjo është që të veçosh Allahun me adhurim dhe ta shfajësosh Atë nga Shirku, që të jesh i distancuar nga ai dhe njerëzit e tij, qoftë kjo e bërë në sasi të paktë apo me tepri dhe qoftë kjo [Shirk] i vogël apo i madh.' Pra, Teuhidi s'mund të plotësohet, përveç pasi të arrihet liri e plotë nga Shirku dhe njerëzit e tij dhe nga të gjitha format dhe manifestimet e tij. Për shkak të kësaj, dijetarët kanë thënë, "Nuk ka *uela* [besnikëri], përveç me *bera* [armiqësi]." **104**

[2] *ed-du'aul-mes'eleh* [lutjet e kërkimit]: *du'aul-mes'eleh* është që të kërkosh gjësend nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar me qëllim të arritjes së ndonjë dobie të kësaj bote apo të Fesë dhe për të larguar dëmin. Kështu që kërkesa në këtë mënyrë është formë e adhurimit. S'është e lejueshme që t'i drejtohet kjo dikujt tjetër pos Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Vërtet, dijetarët e kanë ndarë *du'aul-mes'eleh* në kategori të ndryshme. Ndër to është ajo që s'është e lejueshme të kërkohet nga ndokush përveç Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Kështu që kushdo që ia drejton ndonjë gjë nga kjo dikujt tjetër pos Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, ai ka bërë Shirk të madh ndaj Allahut. Kjo është sikur ai që lutë të tjerë përveç Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar për atë që askush s'është i aftë ta japë përveç Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, nga sjellja e dobisë apo largimi i dëmit. Përsa i përket kërkimit të diçkaje nga krijimi, të cilën ata kanë mundësi ta japin, në lidhje me këtë s'ka ndalim.

el-Kheuf

el-Kheuf: Ndër llojet e adhurimit është edhe *el-kheuf* [frika] prej Allahut. Frika prej Allahut është pozita më e mirë në fe dhe më fisnikja ndër to. Vërtet, Allahu i Lavdëruar ka urdhëruar që të kihet *el-ihlas* [sinqeritet] në këtë ndaj Tij. Kështu që Ai tha,

"Mos kini frikë nga ata, por kini frikë nga Unë nëse jeni besimtarë të vërtetë." [Ali-Imran: 175]

104. Kjo është nga thëniet e Ehlus-Suneh uel-Xhema'a në lidhje me kredon. Domethënë që nuk ka *uela* [besnikëri] për muslimanët, përveç përmes *bera* [armiqësisë] ndaj mosbesimtarëve. Pra, kjo është thënie e vërtetë me të cilën dëshirohet e vërteta. Dhe, kjo është nga thëniet e Shi'itëve në lidhje me kredon. Domethënë, s'ka *uela* ndaj familjes së peygamberit [salallahu alejhi ue selam], përveç përmes *bera* ndaj dy shejhëve: Ebu Bekr dhe Umer [radiallahu anhum]. Kështu që në rastin e Rafidhave [shi'itëve] kjo është bërë thënie e vërtetë me të cilën dëshirohet pavërtetësia. Referoju en-Nedha'ir [f.302] dhe Hexhrul-Mubtedi' [f.18]

Është me vend që kjo të vendoset krahas *er-rexha* [shpresa] dhe *el-mehebbah* [dashuria]. Vërtet, dijetarët kanë përmendur që *kheuf* i ka tre kategori:

E para: *Kheufush-Shirk* [frika që përmban Shirk]. Kjo është kur njeriu frikësohet prej dikujt tjetër pos Allahut nga idhujt apo perënditë e rrejshme apo nga ndokush i vdekur apo që mungon ndër Xhinët e njerëzimit, dhe ai frikësohet se kjo gjë do ta godasë atë me atë që nuk e pëlqen. Ky është rasti sot ndër adhuruesit e varreve në disa pjesë të botës. Ata kanë frikë nga varret dhe përpiqen të fusin frikën në njerëzit e Teuhidit. Pra, kjo *kheuf* [frikë] e mohon Teuhidin.

E dyta: që personi ta lë atë që është e detyrueshme për të nga frika prej njerëzve. Pra, kjo është e ndaluar, dhe është *Shirkul-Asghar* [Shirk i vogël] dhe është e detyrueshme që të paralajmërohet kundër tij.

E treta: *el-Kheufut-Tebi'i* [frika e natyrshme]. Kjo është që të kihet frikë prej armikut apo shtazës grabitçare apo tjetër pos kësaj. Personi që posedon këtë s' duhet të qortohet.

er-Rexha

er-Rexha: *er-rexha* [shpresa] është një cilësi e besimtarëve dhe qëllimi i menduar për këtë është dëshira për atë që posedon Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm nga epërsia dhe mirësia ndër mirësitë e jetës së kësaj bote dhe Jetës së Përtejme, së bashku me bërjen e shkaqeve. *el-kheuf* [frika] dhe *er-rexha* [shpresa] shkojnë së bashku. Kështu që është e pashmangshme që njëra nga këto të shkojë me tjetrën. Pra, robi duhet të ketë frikë prej Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, të ketë frikë prej dënimit të Tij dhe të ketë shpresë për mëshirën e Tij.

Vërtet, dijetarët – rahimuhullah – kanë përmendur që shpresa duhet ta mund frikën në çastin e vdekjes, kështu që frika të mos jetë e shoqëruar me dëshpërim dhe humbje të mëshirës së Allahut ndërsa personi është duke ndërruar jetë.

Vërtet, në hadithin e vërtetë qëndron, “Le të mos vdesë ndokush prej jush, përveç duke pasur mendim të mirë për Zotin e vet.”¹⁰⁵ Njëlloj, ana shpirtërore që ka *takua* [frikë, nderim ndaj Allahut] duhet ta mund anën tjetër që përbëhet nga epshet trupore, apo lakmi për pasuri të paligjshme, apo neglizhencë ndaj bërjes së akteve të dëgjueshmërisë dhe pranimin e nënshtimit. Këtu, është me vend që frika të mbizotërojë, që kjo të jetë mjekim për shpirtin. Kjo është lloji i xhihadit. Nga llojet e adhurimit është edhe *et-Teuekul* [mbështetja].

105. Transmetuar nga Ahmed në el-Musned [3/293, 325, 390], Muslim [nr.2877], Ebu Daud [nr.3113] dhe Ibn Maxheh [nr.4167]

et-Teuekul, er-Regbeh dhe er-Rehbeh

et-Teuekul: Domethënia e *et-Teuekul* është që të mbështetemi në Allahun në çdo çështje dhe t'i drejtohen të gjitha çështjet vetëm Allahut në përjashtim të të tjerëve, siç qëndron në ajetin fisnik,

“Mbështetuni në Allahun nëse jeni besimtarë të vërtetë.” [Nisa: 23]

Prandaj, *et-teuekul* me këtë kuptim është që t'ia drejtosh të gjitha çështjet Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm dhe të mbështetesh në Të në sjelljen e dobisë dhe largimin e të gjitha të këqijave nga ajo të cilën askush s'ka mundësi të japë përveç Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Ky është akt adhurimi. Kushdo që ia drejton këtë tjetërkujt përveç Allahut, ai ka bërë Shirk të madh.

Përsa i përket asaj që është mbështetje e kushtëzuar në tjerët ndër të gjallët, kjo ndodh në lidhje me atë për çka ata janë të aftë nga shkaqet e lejueshme. Ata mund të jenë në gjendje të përmbushin ndonjë nevojë, apo të largojnë ndonjë vështirësi apo ta lehtësojë ndonjë brengë apo mërzi brenda kufijve të asaj për çka njerëzimi ka mundësi. Pra, s'ka ndalim në lidhje me këtë. Është e lejueshme që t'u drejtohet të tjerëve përveç Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm në lidhje me këtë së bashku me besimin që tjerët përveç Allahut janë një shkak nga shkaqet për përmbushjen e nevojave dhe largimn e vështirësive. Nga llojet e adhurimit është edhe *er-regbeh*:

er-Regbeh: Qëllimi i menduar i kësaj është të qenit i kënaqur me atë që na është dhënë nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar me mirësi në jetën e kësaj bote dhe në Jetën e Përtejme, që shoqërohet me përpjekjen me mënyrat për arritjen e faljes, mëshirës dhe kënaqësisë së Allahut.

er-Rehbeh: Kjo është formë e rëndë frike prej dënimit të Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, qoftë nëse kjo ndodh në këtë jetë apo në Jetën e Përtejme. Pra, kushdo që ia drejton ndonjëren nga këto dyja [*er-regbeh* dhe *er-rehbeh*] tjetërkujt përveç Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, ai ka mohuar apo ka bërë Shirk, nga që Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar s'është i kënaqur kur robërit ia drejtojnë këto akte fisnike të adhurimit tjetërkujt përveç Tij. Vërtet, Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i ka lavdëruar të dërguarit dhe pejgamberët e Tij në kaptinën Enbija, ku Ai nis t'i përmend ata me Ibrahimin [alejhis-selam] dhe nga fundi i tregimit, Ai tha,

“Vërtet, ata ngarendnin për të bërë vepra të mira dhe na drejtoheshin me dëshirë të zjarrtë dhe me frikë të madhe; dhe ata ishin të bindur ndaj Nesh.” [Enbija: 90]

Vendi i *er-regbeh* [dëshira e zjarrtë] dhe *er-rehbeh* [tmerri] është zemra, domethënë në zemrat e robërve. Ndër llojet e adhurimit janë edhe *el-khushu* [nënshtimi] dhe *kheshjeh* [përujja].

el-Khushu dhe el-Khashijeh

el-Khushu dhe *el-Khashijeh*: Të dyja këto nënkuptojnë përujje të plotë përpara Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm dhe nënshtim absolut ndaj Tij, haptas dhe në të fshehtë. Kjo vjen së bashku me dashurinë e përsosur ndaj Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Për këtë shkak, dijetarët kanë bërë dallim mes *el-kheshjeh* [tmerrit] dhe *el-kheuf* [frikës]. Ata kanë thënë, “Vërtet, *el-kheshjeh* është frikë e shoqëruar me lavdërim, ndërsa *el-kheuf* mund të shoqërohet me lavdërim mirëpo kjo mund të ndodhë edhe pa lavdërim.” Kjo është e vërtetë, pasi një person mund t’i frikësohet një armiku. Mirëpo, frika e tij ndaj armikut nuk do të thotë që ai e lavdëron atë. Dhe ai mund t’i frikësohet ndonjë shtaze grabitçare, por frika e tij ndaj asaj shtaze nuk do të thotë që ai e lavdëron atë. Sidoqoftë, *el-kheshjeh* s’mund të zbatohet po që se nuk është e shoqëruar me lavdërim. Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë,

“Ata qëndrojnë të frikësuar [dhe në nder] ndaj Tij.” [Enbija: 28]

Njëlluj, Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë për dijetarët, të cilët janë krijesat më të mira,

“Vërtet, ata midis krijimit që më së shumti i frikësohen Allahut janë dijetarët.” [Fatir: 28]

Domethënë, dijetarët e Sheriatit, dijetarët e Librit të Allahut dhe Sunetit të peygamberit të Tij [alejhis-salatu ues-selam] të cilët veprojnë sipas diturisë që kanë. Kështu që kushdo që zbaton këtë *kheshijeh* për tjetërkënd pos Allahut, ai ka bërë Shirk. Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ka paralajmëruar kundër kësaj në thënien e Tij,

“Mos kini frikë prej tyre, por kini frikë nga Unë.” [Bekareh: 150]

Nga llojet e adhurimit është edhe *el-inabeh* [kthimi me pendim].

el-Inabeh

el-Inabeh: Domethënia e *el-inabeh* është që të kthehesh me pendim te Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm në çdo moment të jetës, nga që besimtari nuk e sheh veten ndryshe veçse si një që është neglizhent. Kështu ai e sheh veten përderisa përpiqet në bindje ndaj Allahut, për shkak të madhësisë dhe sasisë së shumtë të të mirave që Allahu i ka

dhuruar atij. Kështu që ai përherë e sheh veten si neglizhent ndaj kësaj, me çkado që fjala *teksir* [neglizhencë] nënkupton. Kështu ai e sheh veten përderisa përpigjet me përkulje [ruku], sexhde, arritje të njohurive dhe përderisa ai të jetë i angazhuar në përkujtimin [dhikr] e parashkuar. Pra, Allahu është ai që ndanë bërësin e veprave të mira dhe armikun e tij, i cili gjithmonë është në kundërshtim me të dhe përpigjet ta largojë atë nga bindja dhe ta bëjë të veprojë akte të mosbindjes.

Për shkak të gjithë kësaj, robi duhet t'i kthehet me pendim Allahut në çdo moment të jetëgjatësisë së tij; veçanërisht kur të jetë i ndikuar nga shkujdesja. Po ashtu kur ai bën ndonjë vepër të mosbindjes dhe kur lë mangut në aktet e bindjes. Pra, në këto kohëra, ai duhet ta fajësojë vetveten dhe të orvatet ta ringjallë zemrën e tij. Kështu për shkak të kësaj, ai i kthehet Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm, duke e përlurur veten plotësisht përpara Tij, duke kërkuar falje nga Ai, dhe ndjen keqardhje për të ndërruar atë të keqe në dobi. Ai synon që ta ndërrojë shkujdesjen me syçeltësi, dhe dëshiron ta përtërijë jetën e tij ashtu që ajo të jetë një jetë e veprave të mira e shoqëruar me pikëpamje të saktë, sinqeritet dhe këdo të shëndoshë.

Pra, në të vërtetë *el-inabeh* është *teubeh*, nga që kjo përfshin kushtet për *teubeh* [pendim], siç është lënia e mosbindjes, lënia e mangësisë dhe largimi i shkujdesjes, dhe vendimi i qëndrueshëm për të bërë akte të dëgjueshmërisë. Ndër llojet e adhurimit është edhe *el-isti'aneh* [kërkimi i ndihmës dhe përkrahjes].

el-Istianeh: *isti'aneh* që s'është e lejueshme është ajo që i drejtohet tjetërkujt pos Allahut. Kjo është *isti'aneh* ndaj krijimit në atë të cilën askush s'mund ta japë përveç Allahut; si ai që i lutet krijimit për ndihmë dhe përkrahje, qofshin ata të vdekur apo të gjallë, për një fëmijë të edukuar mirë, apo për furnizim, për largimin e sëmundjes, për dhënien e sigurisë atij që jeton në frikë, për përmbushjen e nevojave dhe tjetër pos kësaj nga ajo të cilën askush s'mund ta japë përveç Allahut. Kjo është bërë nga idhujtarët, ndonëse ata jetonin midis muslimanëve. Pra, ky është Shirk i madh.

Për shkak të madhësisë së çështjes së Tij, Allahu i Lavdëruar dhe i Lartësuar e llogariti këtë në drejtimin e robërve të Vetvetja në thënien e Tij,

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të lutemi për ndihmë dhe përkrahje.” [Fatiha: 5]

Domethënë, ne nuk adhurojmë askë përveç Teje [Allah], dhe ne nuk kërkojmë ndihmë nga askush përveç Teje. Ky është një premtim nga robërit e Allahut dhe një marrëveshje që është vërtetuar mes tij dhe Zotit të tij. Kështu që kushdo që përmbush detyrimet, ai do të ketë shpërblimin më të mirë dhe kushdo që e then marrëveshjen, ai i bën keq vetvetes.

Përsa i përket *isti'anes* ndaj krijimit që janë të gjallë në lidhje me atë që krijimi kanë mundësi ta japin, pavarësisht që zemrat mbesin të lidhura për Allahun e Fuqishëm dhe

të Madhërishëm dhe duke e konsideruar ndihmuesin vetëm si një shkak, atëherë, për këtë nuk ka ndalim. Shembulli për këtë është kur ndonjë person ju jep pasuri, apo ju ofron një nga gjërat e nevojshme për jetë, apo jua ndërton një ndërtesë dhe të ngjashme me këtë nga çështjet në të cilat njeriu bën të kërkojë ndihmë nga ndokush përveç Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, nga që këto nuk janë manifestime të Shirkut. Dhe, këto nuk janë nga shembujt e Shirkut. Nga llojet e adhurimit është edhe *el-isti'adheh* [kërkimi strehimi]

el-Isti'adheh

el-Istiadheh: Domethënia e *el-isti'adheh* është që t'i kërkohet ndihmë Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Kjo është kur robi thotë, 'Kërkoj ndihmë te Allahu nga esh-shejtan, i Përrjashtuari.' Pra, domethënia është që të kërkohet ndihmë te Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm dhe të kërkohet strehim te Ai nga shejtani, të cilin e ka larguar dhe e ka poshtëruar Allahu. Prandaj, kërkimi i strehimit dhe i shpëtimit është vepër e zemrës që shprehet në gjuhë. Kjo s'mund të jetë për tjetërkënd përveç për Allahun e Bekuar dhe të Lartësuar, nga që Ai është që e bën të mirën dhe e paracakton atë. Dhe Ai është, në Dorën e të Cilit gjindet kontrolli absolut i botrave të qiejve dhe botës së tokës.

"Vërtet, çështja e Tij është që nëse dëshiron gjësend, Ai thjesht thotë, 'Bëhu,' dhe ajo bëhet." [Ja Sin: 82]

Kështu që kushdo që kërkon ndihmë nga tjetërkush përveç Allahut, kërkon mbrotje dhe strehim me këtë në atë që askush s'mund ta japë përveç Allahut, ai ka bërë Shirk të madh ndaj Allahut që e përjashton njeriun nga Feja. Nga llojet e adhurimit është edhe *el-istighathe* [kërkim shpëtimi]

el-Istighathe

el-Istighathe: Dhe *el-istighathe*, sikurse pararendësi i vet, është që të kërkohet ndihmë. S'është e lejueshme që të kërkohet ndihmë në ndonjë çështje për të cilën askush s'mund të ofrojë ndihmë përveç Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm në sjelljen e së mirës dhe largimin e dëmit. Çështjet në të cilat askush s'mund të ofrojë ndihmë përveç Allahut të Lavdëruar, siç është shërimi i të sëmurit, të kthyerit e atij që mungon, të lindurit e fëmijëve të edukuar mirë, largimi i vështirësive, bollëku në furnizim dhe zbritja e shiut; askush përveç Allahut s'mund të ofrojë ndihmë në këto çështje. Pra, nëse ndokush kërkon shpëtim në diçka nga këto çështje me tjetërkënd përveç Allahut, ai ka bërë mosbesim apo Shirk.

Vërtet, është vërtetuar nga pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] t'u ketë thënë Shoqëruesve të tij në një mëngjes, duke e transmetuar thënien e Allahut, "Robi Im do

‘më besojë dhe do t’ më mohojë. Përsa i përket atij që thotë, ‘Shiu zbret nga mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij,’ ky më beson ndërsa mohon yjet; përsa i përket atij që thotë, ‘Shiu zbret për shkak të këtij apo atij ylli.’¹⁰⁶ ai më ka mohuar dhe ka besuar në yll.”¹⁰⁷

Pra, lidhja mes bekimeve dhe kërkimit të ndihmës nga tjetër përveç Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar, është nga llojet e mëdha të Shirkut kundër të cilit është bërë paralajmërim në Kur’anin Fisnik dhe nga peygamberi [salallahu alejhi ue selam] në Sunetin e tij. Nga llojet e adhurimit është edhe *edh-Dhebh* [sakrifica].

edh-Dhebh

Qëllimi i menduar i *edh-dhebh* është që të sakrifikosh për t’u afruar më shumë ndaj Allahut. Në këtë hyn tërë gjaku që është derdhur për t’i afruar Allahut më shumë nga dhuratat, lëmosha, therja dhe tjetër pos kësaj nga sakrifica e ligjruar me Sheriat. S’është e lejueshme për robin që të t’ia drejtojë ndonjë nga këto tjetërkujt përveç Allahut. Kështu që nëse ai sakrifikon kurban për tjetërkënd pos Allahut, apo për t’u afruar më shumë te Allahu me shpresë se do të ndihmohet nga të tjerët në sjelljen e dobisë apo largimin e dëmit, ai ia ka drejtuar këtë akt fisnik të adhurimit tjetërkujt pos Allahut. Me këtë ai bëhet *mushrikun kafir* [idhujtar mosbesimtar]. Përsa i përket asaj që është e lidhur me atë që theret si adet, apo ajo që theret në shenjë mikëpritjeje apo nderi, për këtë nuk ka ndalim, përderisa të zbatohen rregullat Sheriatike në lidhje me këtë.

Vërtet, peygamberi [salallahu alejhi ue selam] ka urdhëruar që të nderohet mysafiri në thënien e tij, “Kushdo që beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, le ta nderojë mysafirin e tij.”¹⁰⁸ Pjesë e nderimit të mysafirit është ta nderosh atë dhe ta rigjallërosh Sunetin, siç na ka informuar Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm në lidhje me Ibrahimin [alejhis-salatu ues-selam],

“Ai u kthye te familja e tij dhe solli një viç të pjekur.” [Dharijat: 26]

Për këtë shkak, dijetarët kanë thënë se kjo është e detyrueshme për atë që ka mundësi ta nderojë mysafirin e tij duke ther ndonjë kafshë për të. Kjo nëse ai ka mundësi për këtë. Përsa i përket asaj që theret si adhurim, kjo s’bën t’i drejtohet tjetërkujt pos Allahut. Dhe kushdo që e bën këtë për tjetërkënd pos Allahut, ai ka ka bërë Shirk. Nga llojet e adhurimit është edhe *en-nedhr* [bërja e betimit].

106. Ka thënë Imam esh-Shafi’i [v.204H] – rahimehullah, “Kushdo që thotë, ‘Shiu bjen për shkak të këtij apo atij ylli,’ në mënyrën që e mendonin njerëzit e *xhahilijetit* [periudha para-Islamike] kur ia atribuonin rënien e shiut ndonjë ylli të caktuar, kjo është mohim siç ka thënë dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam], nga që ai yll shfaqej në kohë të caktuar. Ndërsa koha është diçka e krijuar, ajo nuk e kontrollon vetveten e as ndonjë gjë tjetër. Dhe, kushdo që thotë, ‘Shiu bjen për shkak të këtij apo atij ylli,’ me kuptimin që, ‘Shiu bjen në këtë apo atë kohë,’ kjo s’është mosbesim. Mirëpo, diçka tjetër nga fjalët pos këtyre janë më të dashura për mua se këto.” Referoju el-Umm [1/202].

107. Transmetuar nga el-Buhari [nr.1038] dhe Muslim [nr.125].

108. Transmetuar nga el-Buhari [nr.1/68]

en-Nedhr

en-Nedhr: Kjo është që të bësh çfarëdo betimi, qoftë nëse kjo ka të bëjë me bërjen e betimit për të agjëruar, apo për të bërë haxh, apo nëse kemi të bëjmë me para. Pavarësisht se për çka bëhet betimi, kjo është adhurim dhe s'është e lejueshme që t'i drejtohet tjetërkujt pos Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm. Shembull i kësaj është kur njeriu thotë, 'Kam bërë be në Allahun që do të agjërojë tre ditë,' për t'u afruar më shumë te Allahu. Kjo duhet të jetë betim i pakufizuar, jo i kufizuar. Kjo ngase betimi i kufizuar nuk pëlqehet [mekruh]. Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] ka thënë në lidhje me të, "Vërtet, betimi nuk sjell ndonjë të mirë. Kjo vetëm bën që njeriu koprrac të shpenzojë diçka nga pasuria e tij." **109** Kjo është sikurse thotë ndokush, 'Nëse Allahu më shëron nga kjo sëmundje, unë do të veproj kështu e kështu për hir të Allahut,' siç është të dhënit e një sasive të caktuar të pasurisë, apo diçka të ngjashme nga agjërimi, apo të bërit haxh apo *umreh* apo çkado që i gjason kësaj. Kjo është kundër të cilës ka paralajmëruar pejgamberi [salallahu alejhi ue selam], dhe kjo konsiderohet betim i kufizuar. Kështu që kjo bëhet detyrim për të që ta zbatojë atë.

Shembull i betimit të pakufizuar është kur njeriu bën be, dhe këtë e përdor si mënyrë për t'iu afruar më shumë Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar. Nuk bëhet për ndonjë shkak të veçantë. Kështu që njeriu bën be se do të agjërojë tre ditë, për shembull, apo ai bën be që do të ther një kafshë dhe ta shpërndajë atë midis varfnjakëve dhe të ngratëve. Pra, nuk ekziston një tjetër motiv pas kësaj përveç shpresës për falje nga Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm.

Kjo është sikur shembulli që e përmendi autori – rahimehullah – më herët. Dhe çdo gjë që hyn në të njëjtin vendim si të veprave të sipërpërmendura konsiderohet vepër adhurimi. Pas kësaj, ai solli dëshmi të lidhura më këto lloje."

Dëshmitë për llojet e adhurimit

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Dëshmi është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Xhamitë janë për Allahun, pra mos lutni tjetërkënd pos Tij." [Xhin: 18]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Në thënien e Allahut qëndron,

"Xhamitë janë për Allahun, pra mos lutni tjetërkënd pos Tij." [Xhin: 18]

109. Transmetuar nga el-Buhari [nr. 6608-6609] dhe Muslim [3/1621] dhe formulimi i fjalëve është nga ai.

Domethënë, vendet e sexhdes dhe gjymtyrët që bëjnë sexhde - këto janë vetëm për Allahun, ngase Ai është që veçohet me atë se i ka krijuar ato, i ka rritur dhe i ka fuqizuar ato. Kështu që mos i bëni sexhde me këto gjymtyrë ndokujt përveç Allahut; as ndonjë statujë, as ndonjë qenie njerëzore, e as ndonjë perëndie tjetër në fetë e ndryshme të idhujtarëve, Çifutëve, të Krishterëve, Mexhusëve [adhuruesit e zjarrit] dhe tjerë pos këtyre nga llojet e ndryshme të idhujtarëve."

Tha shejhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab – rahimehullah, "Pra, kushdo ia drejton ndonjë gjë nga kjo tjetërkujt pos Allahut, ai është mosbesimtar. Dëshmi është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Kushdo që lutë tjetër perëndi përveç Allahut, ai për këtë nuk ka dëshmi. Vërtet, ai do të llogaritet te Zoti i tij, e mosbesimtarët nuk do të shpëtojnë." [Mu'minun: 117]

Në një hadith qëndron, "Lutja është thelbi i adhurimit." Dëshmi për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Zoti juaj ka thënë: Më lutni Mua, Unë do t'ju përgjigjem. Vërtet, ata që nuk më adhurojnë nga mendjemadhësia do të hyjnë të poshtëruar në Zjarr." [Gafir: 60]

Dëshmi për *el-kheuf* është dëshmia e Allahut të Lartësuar,

"Mos kini frikë nga ata, por kini frikë nga Unë nëse jeni besimtarë të vërtetë." [Ali-Imran: 175]

Dëshmi për *er-rexha* është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Kushdo që shpreson ta takojë Zotin e tij, le të bëjë vepra të mira dhe të mos shoqërojë gjësend në adhurimin ndaj Allahut." [Kehf: 110]

Dëshmi për *et-teuekul* është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Përgjigjuni Allahut nëse vërtet besoni." [Ma'ide: 23]

Dëshmi për *er-regbeh*, *er-rehbeh* dhe *el-khushu* është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Vërtet, ata ngarendnin për të bërë vepra të mira dhe na drejtoheshin me dëshirë të zjarrtë dhe me frikë të madhe; dhe ata ishin të bindur ndaj Nesh." [Enbija: 90]

Dëshmi për *el-inabeh* është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Kthehu te Zoti yt me pendim dhe nënshtroju Atij." [Zumer: 54]

Dëshmi për *en-nedhr* është thënia e Allahut të Lartësuar,

"Ata i zbatojnë betimet e tyre dhe i frikësohen një dite, e keqja e së cilës do të jetë me përmasa të mëdha." [Insan: 7]

Komentoi el-Allame Zejd Ibn Muhamed Ibn Hadi el-Madkhali – hafidhahullah, "Në hadith qëndron, "Lutja është thelbi i adhurimit."¹¹⁰ Pra, ndonëse isnadi i këtij hadithi është i dobët, kjo dëshmohet me një hadith të vërtetë që ka domethënie të njëjtë; kjo është thënia e pejgamberit [salallahu alejhi ue selam], "Lutja është adhurim."¹¹¹ Kjo është sikur *du'aja* me llojet e saja të ndryshme, *du'aul-ibadeh* dhe *du'aul-mes'eleh*, është baza e Fesë. Në thënien e Allahut qëndron,

"Më lutni Mua, Unë do t'ju përgjigjem." [Gafir: 60]

Ky është urdhër i qartë që e drejton njeriun të bëjë *du'aul-ibadeh* [lutje adhurimi] dhe *du'aul-mes'eleh* vetëm për Allahun. Ai është që premtoi se do të përgjigjet, dhe Ai nuk e then premtimin e Vet.

Dhe, Ai paralajmëroi kundër lënies së adhurimit nga mendjemadhësia në thënien e Tij,

"Vërtet, ata që nuk më adhurojnë nga mendjemadhësia do të hyjnë të poshtëruar në Zjarr." [Gafir: 60]

Kërcënimi i ashpër që përmendet këtu do të thotë ndalim nga adhurimi i tjetërkujt pos Allahut dhe të qenit mendjemadh për të adhuruar Allahun. Kushdo që ia drejton ndonjë nga llojet e ndryshme të adhurimit tjetërkujt pos Allahut, ai është mustekbir [mendjemadh dhe arrogant]. Dhe kushdo që e lenë adhurimin ndaj Allahut, pavarësisht se a adhuron ai tjetërkënd pos Allahut apo jo, ai është ndër ata që hyn në këtë kërcënim të ashpër. Pra, le të dihet se askush nuk e lë adhurimin ndaj Allahut, përveç se të anojë nga adhurimi i diçkaje tjetër pos Allahut.

Vërtet, ai mund të mos i adhurojë idhujt dhe statujat, apo të mos e adhurojë Diellin dhe Hënën. Mirëpo, ai e adhuron dëshirën e vet, e cila ka lëshuar rrënjë në zemrën e tij gjersa ajo e largoi atë nga adhurimi ndaj Allahut.

110. Transmetuar nga et-Tirmidhi [nr.3371]; është përmendur nga Imam el-Albani në el-Mishkatul-Mesabih [nr.2331], ku ai tha, "Isnadi i tij është i dobët, në të gjindet Lehi'eh dhe ai e ka mbamendjen e dobët."

111. Hasan Sahih: Transmetuar nga et-Tirmidhi [nr.3327]; dhe Imam el-Albani tha në lidhje me të në el-Mishketul-Mesabih [nr.2230], "Hadithi është Hasan Sahih." Ai po ashtu e shpalli atë të vërtetë në Sahi Sunen

Ibn Maxheh [nr.3086].

Allahu i Fuqishëm dhe i Madhërishëm ka thënë,

"Mos kini frikë nga ata, por kini frikë nga Unë nëse jeni besimtarë të vërtetë." [Ali-Imran: 175]

Kjo është paralajmërim për njerëzit e imanit që të mos kenë frikë nga krijimi. Ata s'duhet të besojnë që krijimi mund t'i dëmtojë ata, e as që krijimi mund t'u sjellë ndonjë dobi atyre. Kjo ngase e gjithë kjo është në Dorën e Allahut të Lartësuar.

Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar ka thënë,

"Kushdo që shpreson ta takojë Zotin e tij, le të bëjë vepra të mira dhe të mos shoqërojë gjësend në adhurimin ndaj Allahut." [Kehf: 110]

Në këtë ajet fisnik ka një thirrje nga Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar për në ihlas [sinqeritet] dhe korrigjim të veprave. Këto janë dy kushtet bazë për pranimin e veprave. Vepra nuk konsiderohet e drejtë po s'që korrekte [seuab] dhe po s'u bë me sinqeritet [ihlas]. Bërësi i veprës duhet të jetë i pastër nga të gjitha llojet e Shirkut. I njëllojtë është rasti edhe me pjesën tjetër të ajeteve që u përmendën si shembuj për këto lloje të adhurimit.

Për shembull, është thënia e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Mbështetuni në Allahun në qoftë se vërtet jeni besimtarë." [Ma'ide: 23]

Dhe, thënia e Allahut,

"Vërtet, ata ngarendnin për të bërë vepra të mira dhe na drejtoheshin me dëshirë të zjarrtë dhe me frikë të madhe; dhe ata ishin të bindur ndaj Nesh." [Enbija: 90]

Thënia tjetër e Allahut të Fuqishëm dhe të Madhërishëm,

"Kthehu te Zoti yt me pendim dhe nënshtroju Atij." [Zumer: 54]

Pastaj ai e përfundoi me thënien e Allahut të Bekuar dhe të Lartësuar në lidhje me çështjen e sakrificës [en-nedhr],

"Ata i zbatojnë betimet e tyre dhe i frikësohen një dite, e keqja e së cilës do të jetë me përmasa të mëdha." [Insan: 7]

Paqja dhe përshëndetjet qofshin mbi pejgamberin tonë Muhamed, mbi familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij."